

1 E mërkurë, 22 shtator 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 seancës, ju lutem, paraqisni çështjen.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
8 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi
11 të gjithëve.

12 Vërej që të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e
13 gjyqit sot.

14 Të fillojmë sot me dëshminë e dëshmitarit të Thaçit, të
15 Mbrojtjes së Thaçit 1DW-006. Gjykatësi Mettraux do të na
16 ndjekë sot përmes videolidhjes.

17 Së pari dua t'ju rikujtoj që në dokumentin F03468 Trupi
18 Gjykues autorizoi disa masa sipas rregullës 107 për këtë
19 dëshmitar, përfshirë se deklaratat e dëshmitarit 006 janë baza
20 për dëshminë që ka ai dhe fushëveprimin e kundërpyetjeve të
21 dëshmitarit duhet të kufizohen në fushëveprimin e pyetjeve nga
22 pala thirrëse si dhe në çështjet që lidhen me besueshmërinë.
23 Dëshmia e dëshmitarit duhet të kalojë në seancë private nëse
24 ekziston rreziku që të nxirret informacioni i klasifikuar apo
25 i ndjeshëm, delikat. Dhe dëshmitari mund të refuzojë t'i

1 përgjigjet pyetjeve për shkak të konfidencialitetit.

2 Dhe Trupi Gjykses nuk do të lejojë pyetje që nuk janë të
3 lidhura qartë me çështjet që lidhen me ofruesin e
4 informacionit sipas rregullës 107 dhe që janë relevante për
5 çështjen gjyqësore.

6 Kur të bëhen pyetje lidhur me këtë pikë, pala thirrëse do
7 të jetë gati ta shpjegojë se si linja e pyetjeve është objekt
8 i rregullës 107.

9 Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

10 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
12 Dëshmitar.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja e
15 seancës do t'ju japë betimin solemn të cilin duhet ta bëni në
16 bazë të rregullës së procedurës së provave. Ju lutemi, lexoni
17 tekstin me zë të lartë.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
19 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
20 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
21 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të
22 cilën kam dijeni.

23 DËSHMITARI: JOHN DUNCAN

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
25 Tani mund të uleni.

1 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që
2 mendohet se do të zgjasë dy ose tri ditë maksimumi. Sikurse
3 mund ta dini, fillimisht do t'jua bëjë pyetjet Mbrojtja e
4 Thaçit e më pas ekipet e tjetra të Mbrojtjes. Pasi të
5 përfundojë Mbrojtja, ZPS-ja ka të drejtë po ashtu t'ju bëjë
6 pyetje, por edhe anëtarë të Trupit Gjykses mund të kenë pyetje
7 për ju.

8 Mbrojtja e Thaçit ka parashikuar 4 orë e gjysmë për
9 pyetjet e veta. Ekipet e tjera të Mbrojtjes së bashku kanë
10 kërkuar 2 orë e gjysmë. ZPS-ja parashikon se do t'i nevojiten
11 katër orë. Inkurajoj palët të jenë sa më të kujdesshëm në
12 shfrytëzimin e kohës kur të bëjmë pyetje. Trupi Gjykses mund
13 të lejojë pyetje plotësuese nëse përmbushen kushtet.

14 Dëshmitar, përpikuni të përgjigjeni qartë me fjali të
15 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkon që të
16 pyetja të përsëritet, ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që
17 pyetja të sqarohet. Gjithashtu mos harroni të na thoni ku e
18 bazoni njohurinë për faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju
19 bëjmë pyetje.

20 Flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara se
21 të përgjigjeni, si dhe flisni ngadalë në mënyrë që t'ju
22 ndjekin përkthyesit.

23 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në këtë Gjykatë, nuk
24 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
25 jashtë sallës së gjyqit. Nëse dikush ju bën pyetje jashtë

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 4

1 sallës së gjyqit lidhur me dëshminë tuaj, ju lutem na thoni
2 menjëherë.

3 Ju lutem, ndërprisni fjalën nëse ua kërkoj unë, si dhe
4 ndërprisni fjalën nëse më shihni që unë po ngre dorën, sepse
5 kjo do të thotë që unë do t'ju jap një udhëzim.
6 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, apo doni të thoni
7 diçka, na vini në dijeni dhe do të bëjmë organizimin përkatës.
8 Do të fillojmë me pyetjet nga ekipet e Mbrojtjes së Thaçit. Ju
9 lutemi dëgjojini me vëmendje.

10 Znj. Tavakoli, fjala është për ju.

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Përpara se të
12 fillojmë, është në dijeni dëshmitari që një nga Gjykatësit po
13 na ndjek përmes videolidhjes?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 [Përkthim] Mund ta shihni përmes ekranit Gjykatësin
16 tjetër, jo tani. Kur të flasë do ju shfaqet në ekran.

17 Dëshmitar ËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

18 Pyetje nga znj. Tavakoli:

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

20 PY. Mirëmëngjes z. Duncan.

21 PË. Mirëmëngjesi.

22 PY. Jemi takuar më herët, jam Nina Tavakoli dhe jam
23 bashkëmbrojtësja e z. Thaçi. Ju lutem, mund t'i jepni emrin e
24 plotë Gjykatësit?

25 PË. Jam John Stuart Duncan.

1 PY. A mund të na thoni datëlindjen?

2 PË. 17 prill 1958.

3 PY. Më falni, e di që duhet të ngadalësoj. Duhet të
4 ngadalësoj. Flasim të dy anglisht, edhe bëhet përkthimi
5 simultan. Çfarë shtetësie keni?

6 PË. Franceze dhe britanike.

7 PY. Çfarë profesioni keni?

8 PË. Tani jam në pension. Kam qenë diplomat për 38 vite, dhe
9 kam qenë ish-ambasador britanik edhe guvernator i territorit.

10 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues diçka lidhur me
11 përvojën tuaj, profesionin tuaj, për shembull, çfarë pozitash
12 keni pasur, në këto 38 vite ku keni qëndruar nga pikëpamja
13 gjeografike, që ta kuptojmë më mirë ekspertizën tuaj.

14 PË. Patjetër, në fakt lista është shumë e gjatë, kështu që
15 unë do të përpiqem të jem sa më shkurt.

16 Kam punuar jashtë vendit në Paris dy herë, në Khartum, në
17 Shqipëri, në Bruksel dy herë, në Ishujt Falkland kam qenë
18 shkurtimisht guvernator dhe për ishujt në Karaibe. Po ashtu
19 kam trajtuar shumë aspekte ushtarake, kam qenë shumë i
20 përfshirë. Pra, kam qenë në delegacionin e NATO-s në 1993 dhe
21 jam marrë me dislokimet e forcave policore evropiane në
22 Mostar. Kam punuar po ashtu me Komunitetin Evropian për
23 kufirin shqiptaro-kosovar, me policinë.

24 Pra, lista është shumë e gjatë. Edhe karrierën e
25 përfundova si ambasador për çarmatimin, e Kombeve të Bashkuara

1 në Gjenevë dhe në Nju-Jork. Lista është shumë e gjatë, mund
2 t'ju thoja më shumë.

3 PY. Kur thoni çështje politike ushtarake çfarë nënkupton kjo?

4 PË. Në shërbimin diplomatik kemi specializime të caktuara.

5 Pra, unë kam qenë kryesisht i fokusuar në këtë fushë sepse
6 kam, jam diplomuar në fakt për çështje strategjike,
7 teorikisht. Kam ndjekur teorinë e çështjeve strategjike dhe
8 ushtarake. Dhe kur fillova të punoja në shërbimin diplomatik,
9 u fokusova kryesisht në këtë fushë. Pra, është fusha ku punon
10 me ushtrinë, por nga aspekti politik ndikimet që kanë
11 përgatitjet ushtarake operacionet ushtarake dhe strategjitë
12 ushtarake.

13 Pra, kam qenë zëvendësshefi i departamentit të politikave
14 të sigurisë në 1998-n. Pra për të parë për çfarë kanë nevojë
15 forcat. Po ashtu kam punuar edhe në aspektin operativ kur kam
16 punuar si këshilltar politik për komandantin e lartë të
17 forcave aleate të NATO-s nga 1998 deri në 2002 [Sipas
18 përkthimit].

19 PY. Në këtë përvojën tuaj, keni pasur përvojë me vendet e
20 Ballkanit, Ballkanit perëndimor? Dhe nëse po, ku?

21 PË. Po, kam qenë gjerësisht në Ballkan, ju thashë kam qenë i
22 përfshirë me aspektet e dislokimit të policisë në Mostar. Po
23 ashtu kam qenë diplomati i parë britanik që kam shkuar në
24 Shqipëri pas 46 viteve komunizëm, dhe kam krijuar misionin
25 britanik atje në vitin 1992. Dhe po ashtu kur kam qenë në

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 7

1 Londër, kam punuar në departamentin e politikave të sigurisë
2 dhe kam qenë në të gjitha takimet që kishin lidhje me luftën e
3 Bosnjës. Pra, kam përvojë të konsiderueshme me Shqipërinë, por
4 dhe me problemet e Ballkanit në përgjithësi.

5 PY. Cilat vite keni punuar në departamentin e politikave të
6 sigurisë?

7 PË. Kjo ka qenë menjëherë përpara punës me NATO-n, kështu që
8 i takon në 1998.

9 PY. Gjatë përvojës suaj, gjatë karrierës suaj, keni marrë
10 ndonjë shpërblim për punën tuaj, ndonjë çmim për punën tuaj?

11 PË. Po. Kam marrë Çmimin e Perandorisë Britanike për punën
12 time në Shqipëri, dhe kam marrë medaljen e NATO-s për Kosovën,
13 pra dhe për punën që kam kryer në Kosovë.

14 PY. Kalojmë pak tek arsimi. Në cilin fakultet apo universitet
15 jeni diplomuar?

16 PË. Unë jam diplomuar për marrëdhënie ndërkombëtare të
17 fokusuara në çështjet strategjike, të drejtën ndërkombëtare,
18 të drejtën e BE-së, evropiane. Gjithashtu kam studiuar në
19 Universitetin Sorbonne në Paris dhe kam punuar në Kolegjin e
20 NATO-s për Mbrojtjen në vitin 1992. Pra është një kolegji
21 apostafat i NATO-s.

22 PY. Sa kohë keni studiuar në NATO?

23 PË. Gjashtë muaj.

24 PY. Pse morët pjesë në këtë, pse i ndoqët këto studime?

25 PË. M'u kërkua në fakt, m'u kërkua që t'i ndiqja këto studime

1 sepse isha duke shkuar për të punuar në Bruksel dhe kam qenë
2 një nga pak civilët që e kanë ndjekur këtë kurs, këto studime,
3 dhe kam qenë kryesisht atje me kolonelë dhe nënkolonelë të
4 cilët përgatiteshin për të marrë gradat. Më pranuan, edhe
5 ishte në përgatitje shumë e mirë për karrierën time të
6 mëpasshme.

7 PY. Pse mendove se do të ndihmonte kjo në karrierën tuaj?

8 PË. Sepse do të kisha një fokus praktik, do të kuptoja më
9 shumë nga pikëpamja praktike dhe gjashtë muaj të punoja me
10 oficerë ushtarakë të nivelit të lartë të cilët në të ardhmen
11 do të kishin poste shumë të larta e të mësoja përvojën e tyre
12 dhe t'i njihja si individë, jo thjesht si persona nga
13 pikëpamja teorike. Por unë do të doja të kuptoja çfarë do të
14 bënin këta persona, çfarë kishin bërë në të shkuarën. Dhe
15 përvoja që do të mësoja për mua do të ishte unike.

16 PY. Duke mbajtur parasysh përvojën tuaj profesionale, dhe
17 studimet tuaja në kolegjin e NATO-s, a mund të na thoni tani
18 që ju e kuptoni si funksionojnë ushtritë dhe konceptet
19 ushtarake?

20 PË. Po.

21 PY. Tani doja t'ju bëj një pyetje tjetër. Çfarë keni -- ku
22 keni punuar nga gushti 1998 deri në dhjetor të 2001?

23 PË. Kam qenë këshilltari politik britanik për komandantin e
24 lartë Wesley Clark të NATO-s dhe Sir Rupert Smith që ishte
25 zëvendësi i tij. Ka qenë një pozitë që ishte INTERAF [Sipas

1 përkthimit] njëhej akronimi. Është departamenti ushtarak
2 ndërkombëtar pra, ne njiheshim si POLADS, ta keni parasysh
3 shkurtimin. Ishte shumë normale të kishte pozita të tilla në
4 Luftën e Dytë Botërore. Vetëm Shtetet e Bashkuara vazhduan të
5 kishin këto pozita në komandat e larta ushtarake. Pas Luftës
6 së Dytë Botërore, britanikët e ndërprejnë këtë lloj pozite dhe
7 e rikrijuan për luftën në Ballkan. Dhe unë kam qenë personi i
8 dytë që e kam ushtruar këtë funksion pra, në selinë e forcave
9 aleate.

10 PY. Shtetet e Bashkuara kanë pasur këshilltar politik?

11 PË. Po, Michael Durkee ka qenë eprori im i drejtpërdrejtë.

12 PY. Shkurtimisht, çfarë detyrash kishit ju?

13 PË. Detyrat e mia kryesisht ishin të jepja këshilla
14 komandantëve ushtarakë lidhur me aspektet diplomatike dhe
15 politike që mund të kenë ndikim në aspektin ushtarak në
16 operacionet ushtarake, por gjithashtu t'u jepja informacione
17 të rregullta lidhur me ato çka ndodhnin në kontekstin rajonal
18 ndërkombëtar dhe t'i këshilloja lidhur me mënyrën se si duhet
19 të reagonin dhe se si mund të ndikonte kjo tek operacionet
20 përkatëse.

21 Gjithashtu, roli ynë përfshinte edhe dhënien e
22 informacioneve nëse kishte takime të drejtuesve politikë,
23 sidomos në konfliktin e Kosovës kishte takime të shpeshta, dhe
24 unë jepja informacion lidhur me aspektet që mbuloja unë,
25 merrja shënime, në fakt, përgjithësisht unë isha personi që i

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 10

1 merrja shënimet, mbaja procesverbalin e takimit, dhe
2 përgatisja versionin e parë të raportit dhe ia shpërndaja
3 pastaj Sekretarit të Përgjithshëm.
4 PY. Në cilat fusha keni qenë përgjegjës në Kosovë?
5 PË. Më falni, duhet të flas më ngadalë. Duke mbajtur parasysh
6 përvojën time me Shqipërinë, unë mbuloja aspektet e Kosovës.
7 Kolegu im Michael Durkee që kishte qenë atje përpara meje,
8 kishte vite. Po ashtu ai i njihte shumë mirë aspektet serbe,
9 çështjen e Serbisë, kështu që ne e kishim ndarë. Unë mbuloja
10 Kosovën dhe ai mbulonte Serbinë. Kemi punuar dhe më
11 gjerësisht, kemi marrë pjesë në takime. Shkoja me Gjeneralët
12 kur shkonin për shembull në Bosnje, dhe kjo bëhej rregullisht,
13 takoheshin rregullisht me komandantët atje, apo në Portugali,
14 me forcat aleate të NATO-s, merrja pjesë. Ishim të ndarë për
15 shtete të caktuara, shtete të ndryshme, bazuar në përvojën që
16 kishim ne.
17 PY. Kur thoni keni mbuluar aspektet e Kosovës, më konkretisht
18 çfarë doni të thoni?
19 PË. Pak a shumë të gjitha. Unë e kisha, kisha një panoramë se
20 si funksiononte shoqëria shqiptare. Ishte detyra ime në
21 Shqipëri ta kuptoja këtë, dhe isha dhe shumë i interesuar për
22 ta kuptuar. Ky ishte një shtet i mbyllur për 46 vite, edhe unë
23 isha vërtet i interesuar ta kuptoja si funksiononte shoqëria,
24 sepse është pjesa themelore e detyrës tonë si diplomat.
25 Ne duhet t'u shpjegojmë eprorëve tanë si funksionon shoqëria,

1 çfarë ndodh në këtë shoqëri, si funksionojnë pushtetet, si
2 mund të ndikosh tek ata. Pse mund të jenë ndonjëherë të
3 vështirë. Kjo është puna e një diplomati, t'u shpjegosh të
4 gjitha aspektet e një shoqërie eprorëve përkatës. Kështu që
5 unë u mbështeta shumë në këtë përvojë.

6 Por sigurisht ka pasur dhe një aspekt tjetër që besoj se
7 ju e kuptoni, ideja e Shqipërisë së Madhe, e shqetësonte
8 komunitetin ndërkombëtar dhe kjo kishte kohë. Dhe kur doli
9 Shqipëria nga komunizmi, ky ishte një nga shqetësimet. Ata
10 donin të kuptonin si ishte marrëdhënia mes Shqipërisë edhe
11 Kosovës, shqiptarëve të Kosovës. Kështu që unë duhet të isha i
12 fokusuar në këtë aspekt, të bisedoja me personat, ta kuptoja
13 dhe t'ua shpjegoja eprorëve të mi. A ishte ky një realitet, a
14 mund të bëhej realitet, a mund të ndodhte kjo? A ka dallime
15 mes Shqiptarëve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të Kosovës? Dhe
16 si e konceptojnë ata, si e perceptojnë ata?

17 PY. Sipas jush çfarë mendonin shqiptarët e Kosovës?

18 PË. Qartazi, shqiptarët e Kosovës kanë qenë pjesë e një
19 aparteidi gjatë kohës së Millosheviqit, kanë qenë të
20 përjashtuar nga pjesëmarrja në qeverisje, shërbimet publike,
21 dhe gradualisht e gjitha kjo solli pastaj spastrimin etnik që
22 kemi parë të gjithë. Por ishin të ndryshëm nga shqiptarët e
23 Shqipërisë. Të paktën sipas mendimit tim, nuk është se kishin
24 humbur afeksionin për njëri-tjetrin, ishin ende të lidhur me
25 njëri-tjetrin. Po spekuloj, ju lutem më mirëkuptoni. Është

1 thjesht mendimi im. Shqiptarët e Shqipërisë janë të ndarë
2 kryesisht në tri zona: veriu, që ka gjakmarrje, ka klane, edhe
3 kjo është pjesa dominuese e historisë dhe e kulturës së
4 Shqipërisë. Shqipëria e mesme, është disi më ndryshe, është e
5 përzier, edhe Shqipëria e jugut është shumë e ndikuar nga
6 Greqia. Ka dhe pakica greke në atë zonë. Nuk mund të thuash se
7 Shqipëria është shtet homogjen, apo një shoqëri homogjene.

8 Ama, pjesa kosovare kryesisht vijnë nga Shqipëria e
9 veriut. Pra koncepti i nderit, i besës, nuk di si ta shpjegoj.
10 Gjakmarrja, kanuni kanë qenë baza e shoqërisë. Është mënyra se
11 si ata e perceptonin shoqërinë. Për shembull, unë jam skocez.
12 Gjëja e parë që bëjmë ne, ne kur takohemi me të tjerët, ne
13 përpiqemi të zbulojmë të mësojmë prej nga e ke familjen. A
14 kemi lidhje me njëri-tjetrin. Kështu mendojnë dhe ata atje.
15 Është një mënyrë shumë e ngjashme të menduari. Nuk do të thotë
16 që ne kemi domosdoshmërisht lidhje historike, por është pjesë
17 e trashëgimisë tonë. Dhe kjo është diçka që unë e kam parë
18 shumë, kam parë mishërime të këtij procesi.

19 Kur shoqëria kërcënohet, këto trysni, këto lidhje, bëhen më të
20 forta. Dhe këtë mund ta shihje, mund ta kenë -- në fakt kjo ka
21 ndodhur edhe në Mbretërinë e Bashkuar kur kanë pasur probleme.
22 Dhe themi s'bëhet gjaku ujë. Të gjithë jemi familjarë. Kam
23 besim te ky person se është pjesë e imja, është pjesë e
24 familjes time. Është kjo mënyrë të menduari, ka qenë krejt e
25 zakonshme dhe unë e kam parë vetë, nuk e di nëse iu përgjigja

1 pyetjes suaj.

2 PY. Po, në fakt iu përgjigjët. T'i kthehemi specializimit
3 tuaj lidhur me Kosovën. Keni mbuluar edhe Ushtrinë Çlirimtare
4 të Kosovës dhe Qeverinë e Përkohshme të Kosovës gjatë punës
5 suaj atje?

6 PË. Po.

7 PY. Për të dhënë këshilla, Gjeneralin Wesley Clark dhe
8 komandantët e tjerë, çfarë burimesh përdornit ju, ku
9 bazoheshit për të dhënë këshilla?

10 PË. Në një larmishmëri burimesh. Nëse më lejoni, do t'ju jap
11 një shembull si ishte një ditë e zakonshme gjatë konfliktit,
12 se mbase mund t'ua pasqyroj se si ka funksionuar.

13 PY. Patjetër.

14 PË. Për mua një ditë e zakonshme ishte kështu. Fokusohesha në
15 informimet, informoja Gjeneralin Wesley Clark në 7.30 të
16 mëngjesit. Më duheshin 45 minuta të vozisja drejt vendit ku
17 qëndronte ai. Zakonisht unë zgjohesha, shkoja hyja në
18 internet, lexoja të gjitha informatat që mund të gjeja në
19 internet, çka kishte ndodhur nga pikëpamja politike dhe
20 operative 24 orët e fundit.

21 PY. Lidhur me Kosovën?

22 PË. Po, po. Lidhur me Kosovën.

23 Më pas dëgjoja lajmet e 24 orëve të fundit, hipja në
24 automjet, vozisja, dëgjoja BBC-në gjatë rrugës që vozisja. Kur
25 shkoja në zyrë, lexoja të gjitha kabllogramet diplomatike që

1 kishin, ishin shkëmbyer gjatë natës, lexoja shërbimet e
2 monitorimit që mund të kishin konstatuar elementë që nuk ishin
3 konstatuar nga lajmet, lexoja të gjitha vlerësimet e shërbimit
4 informativ.

5 Hyja në takim, informoja Gjeneralin Clark, së bashku
6 pastaj shkonim dhe informonim përmes videolidhjes komandantët
7 operativë në terren. Më pas, gjatë ditës lexoja kabllogramet
8 nëse vinin, bisedoja me personat që njihja, qofshin këta
9 shqiptarët nga koha ime në Shqipëri me gazetarë, me OJQ, me
10 organizata të ndryshme *think-tank*, me persona të ndryshëm që
11 të merrja sa më shumë informacion që të ishte e mundur në
12 mënyrë që të formoja mozaikun. Unë jam disleksik, kështu që
13 unë kam, unë mundohem, i vizualizoj gjërat. Pra, unë
14 përpiqesha që të krijoja një mozaik, një panoramë, çfarë po
15 ndodhte, cilat ishin dinamikat, cilat janë gjërat më të
16 rëndësishme që kanë ndodhur në 24 orët e fundit. Dhe unë
17 mbështeteshja në këto -- mos të harroj të them një gjë, ne --
18 Mike Durkee dhe unë ne e ndanim informacionin para se të
19 takoheshim me Gjeneralin Clark. Ai kishte informacionin nga
20 pjesa e SHBA-së, dhe unë kisha informacionin nga burimet
21 britanike, dhe i kopsisnim bashkë në mënyrë që të jepnim
22 panoramë të plotë: kjo po ndodh, në këtë moment duhet të
23 reagojmë, këto janë vështirësitë që ju duhet të keni parasysh,
24 kufizimet. Ky ishte procesi gjatë ditës, unë përpiqesha të
25 kisha sa më shumë kontakte, të mblidhja sa më shumë

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 15

1 informacion për të kuptuar se si po zhvillohej situata nga
2 pikëpamja ushtarake dhe politike.

3 PY. Keni pasur persona të brendshëm në terren?

4 PË. Më vjen keq, kjo është një pyetje që nuk mund t'i
5 përgjigjem.

6 PY. Faleminderit. Mënyra se si e keni kuptuar ju kulturën e
7 shqiptarëve të Kosovës, a ndikoi për mënyrën se si konceptuat
8 dhe UÇK-në apo për të kuptuar më mirë UÇK-në?

9 PË. Po.

10 PY. Në ç'formë?

11 PË. Në disa forma, në disa mënyra. Po flasim në vija të
12 përgjithshme tani, jo konkretisht. Në vija të përgjithshme
13 vihej re që i kishte lidhje të forta familjare, klane
14 familjare. Për shembull e shikoje ndikimin që kishte Jashari,
15 kishin Jasharët.

16 PY. Çfarë doni të thoni me këtë?

17 PË. Personat kryesorë, sidomos ditët e hershme, po flas për
18 gushtin 1998, kishin lidhje familjare qofshin këto apo për
19 shkak të pozicioneve gjeografike, kishin lidhje me Jasharët.
20 Kjo dukej, ishte e dukshme. Kur bëje një analizë të profilit
21 të personave kryesorë, dilte mbiemri i Jasharëve gjithandej.
22 Domethënë, ka qenë një pjesë e rëndësishme.

23 Por kanë qenë një grup heterogjen personash, shumë
24 heterogjenë, dhe ndryshuan.

25 PY. Çfarë doni të thoni me këtë ju "ishin shumë heterogjenë"?

1 PË. Përbërja e aktorëve kryesorë, e personave kryesorë,
2 veçanërisht kur filloi të përshkallëzohej spastrimi etnik,
3 kishte disa shtresa. Po jap një shembull konkret. Kishit pas
4 persona që kishin qenë ushtarë në armatën jugosllave, juristë,
5 mjekë, persona që kishin qenë gazetarë, të tjerë të cilëve u
6 ishin vrarë familjet, apo keqtrajtuar familjet. Kështu që
7 motivi i tyre për të rrëmbyer armët ishte i ndryshëm
8 ndonjëherë.

9 PY. A kishte gra në UÇK-?

10 PË. Kishte, po. Shpesh kishte gra të cilat ishin abuzuar
11 seksualisht, dhunuar seksualisht. Që të abuzohet seksualisht
12 një femër shqiptare është e tmerrshme. Duhet të keni parasysh
13 ne i themi shoqëri myslimane, por nuk është shoqëri aq
14 myslimane. Shqiptarët më kanë thënë që në fakt ata janë
15 myslimanë që bëjnë kryqin kur kalojnë para kishës. Nuk është
16 shoqëri islamike, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, siç
17 kuptojmë ne lindjen e mesme.

18 Çështja e nderit, ka qenë shumë e rëndësishme dhe është
19 ende shumë e rëndësishme në fakt për shqiptarët, dhe që të
20 çnderohet një femër në atë mënyrë, është e papranueshme, është
21 e paimagjinueshme. Pra, ç'të ardhme do kishte kjo femër? Dhe
22 unë kam takuar shumë syresh, shumë nga këto gra, dhe kanë qenë
23 persona shumë mbresëlënëse.

24 PY. Kur keni punuar me KFOR-in si jeni ndier, Dëshmitar, që
25 komuniteti ndërkombëtar ose kolegët e komunitetit ndërkombëtar

1 pa i vënë emra, si e kanë kuptuar ata dallimin ndërmjet
2 kulturës së shqiptarëve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të
3 Kosovës?
4 PË. Thuhet që çdo armatë, çdo ushtri, duhet që të luftojë çdo
5 betejë të fundit. Dhe kjo në fakt është situata që unë kam
6 parë në terren. Në shumë raste unë kam parë dhe kam dëgjuar në
7 fakt edhe një ministër që i ka thënë Gjeneralit Clark që "Kjo
8 është njësoj si Bosnja, apo jo?". Por ideja ishte që situata
9 ishte tërësisht e ndryshme dhe konflikti ishte i ndryshëm nga
10 Bosnja. Lufta nuk ishte si në rastin e boshnjakëve dhe të
11 kroatëve, që luftonin ndërmjet njëri-tjetrit, por bëhej fjalë
12 për një luftë ku populli luftonte kundër atyre që i kishin
13 dhunuar. Pra situata ishte tërësisht e ndryshme.

14 Një tjetër problem që ndoshta do ta shtjellojmë pak më
15 vonë, kishte të bënte me faktin që komuniteti ndërkombëtar,
16 opinionin publik, media, komentatorë të ndryshëm, ushtarakët,
17 diplomatët, në të vërtetë nuk e kuptonin tërësisht
18 kompleksitetin e shoqërisë shqiptare. Ata i mendonin
19 shqiptarët për ta thënë në një mënyrë shabllone, që ata i
20 mendonin shqiptarët si një grup kriminelësh, dhe sipas
21 mendimit tim ky ishte një konceptim shumë i rrezikshëm dhe jo
22 i vërtetë. Por, gjithsesi, kjo në thelb krijoi një situata
23 shumë dramatike.

24 Sipas përvojës time me shqiptarët, shqiptarët janë njerëz
25 shumë burimorë, janë shumë kreativë, dhe janë të pavarur.

1 Ndërkohë që komuniteti ndërkombëtar nuk e kuptonte këtë lloj
2 sipërmarrjeje, ose karakter dallues sipërmarrës ose të marrjes
3 së jetës së tyre në duart e veta nga shqiptarët. Dhe ndërkohë,
4 shqiptarët ishin shumë kreativë, dhe fakti që shqiptarët janë
5 shumë kriminelë efektivë në qoftë se bëhet fjalë për
6 kriminelë, nuk është çuditës në vetvete sepse ka të bëjë me
7 një prej tipareve kryesore, pra të gjetjes së mënyrave për të
8 shprehur atë çfarë ndjejnë në mënyrë më protektive.

9 Dhe në fakt kjo është diçka të cilën ne e kemi parë ndër
10 vite që shqiptarët bëhen biznesmenë shumë të mirë, persona me
11 emër në fushat përkatëse.

12 Domethënë, sikurse e kam shpjeguar, komuniteti
13 ndërkombëtar e kishte shumë të vështirë që të kuptonte deri në
14 detaj se cilat ishin tiparet e shqiptarëve, domethënë kishin
15 një vlerësim shumë larg nga e vërteta lidhur me tiparet,
16 karakteristikat e shqiptarëve. Dhe kjo nuk të ndihmon shumë në
17 qoftë se ti duhet të trajtosh personat të cilët thjesht
18 mundoheshin të mbronin veten.

19 PY. Kur po diskutoni tani, e kishit fjalën për shqiptarët e
20 Shqipërisë apo e keni fjalën për shqiptarët e Kosovës?

21 PË. Unë po shpjegoja tiparet dominuese ose kryesore të
22 shqiptarëve etnikë, nuk është e rëndësishme të bëhet dallimi
23 këtu mes shqiptarëve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të Kosovës.

24 PY. E përmendët pak më herët kanunin, e përmendët, apo jo?

25 PË. Po, po, e përmenda.

PY. A mund të na e shpjegoni shkurtimisht se çfarë është kanuni edhe a mund të na thoni se si e kuptonte UÇK-ja kanunin? Në qoftë se keni ndonjë përgjigje për këtë pyetje.

PË. Kanuni është një dokument i mesjetës, e ka bazën tek besimi, e ka bazën te besa. Domethënë, ideja kryesore është ajo e Biblës që duhet të mbrohesh dhe duhet të mbështetesh tek nderi. Pra, sikurse e thashë dhe më herët, në qoftë se një shoqëri është në presion, sigurisht që këto lloj mënyrash sjelljeje kanë të ngjarë që të bëhen më të forta.

Për shembull, kur kam qenë në Shqipëri në 1992 kam vizituar veriun e Shqipërisë përsëri si pjesë e monitoruesve të komunitetit evropian, dhe atje jam takuar, për shembull, me shefin e policisë. Dhe mbaj mend që, "ti duhet të kesh një rol shumë të rëndësishëm, duhet të të njohin të gjithë sepse është e vështirë që ti të vësh në jetë të zbatosh ligjet". Edhe përgjigja që ai më tha është, "në fakt nuk është fare e vështirë për mua. Kam një punë shumë të thjeshtë sepse të gjithë i zgjidhin vetë punët e veta, mbi bazën e kanunit".

Ajo çfarë po përpiqem të them është që nderi, besa, janë tipare shumë të rëndësishme për Shqipërinë e veriut po gjithashtu edhe për kosovarët. Nuk e di në qoftë se iu përgjigja pyetjes tuaj, por këtë përmbledhje kam lidhur me kanunin.

PY. Po.

ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 20

1 paraqesë në ekran një video. Për referencë, ju lutem,
2 paraqisni në ekran dokumentin P02519.

3 PY. Besoj që do ta shikoni në ekran, z. Duncan.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ka transkript, apo jo?

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, nuk ka transkript,
6 megjithatë, ju lutem transmetojeni derisa t'ju them ta
7 ndaloni. Duhet të ngrini dhe volumin për ta dëgjuar.

8 [Luhet videoincizimi]

9 [Përkthim] "Duhet të vendosim datën, nuk e di sa është
10 data."

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju lutem, ndërpriteni këtu.

12 PY. A mund të na e shpjegoni çfarë patë në video, z. Duncan?

13 PË. Ky është nënshkrimi i marrëveshjes së UÇK-së për
14 demilitarizimin në mëngjes herët, në mëngjes më datë 21 janar
15 [Sipas përkthimit] 1999.

16 PY. Kë njohët në atë video, Dëshmitar?

17 PË. Z. Thaçi, Gjeneralin Jackson, Gjeneralin John Reith, dhe
18 isha edhe unë i pranishëm aty.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund ta tregoni dhe një herë
20 videon --

21 PY. -- në mënyrë të tillë që të na thoni se ku jeni aty në
22 video?

23 PË. Z. Reith, Gjenerali Reith, është në të majtë, jam unë me
24 këtë këmishën e bardhë, pastaj është Gjenerali Jackson.

25 Kërkoj ndjesë për përkthyesit. Atëherë, dhe një herë, në

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 21

1 të majtë është Gjenerali Reith, që është me këtë beretën e
2 kuqe. Unë jam personi që ka veshur këmishën e bardhë, dhe
3 kravatën e kuqe. Ndërkohë që personi tjetër me uniformë
4 laramane është Gjenerali Jackson. Pastaj në dorë ka letrat z.
5 Hashim Thaçi, pra personi që ka letrat në dorë është z. Thaçi.

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju lutem, a mund të bëni një
7 fotografi të kësaj sekuence të videos në mënyrë të tillë që z.
8 Duncan ta nënshkruajë pastaj?

9 PY. Dëshmitar, a mund të shkruani dhe emrat e personave,
10 sepse do kërkoj që të pranohet në provë materiale kjo
11 fotografi?

12 PË. A mund të vendos 1, 2, 3, 4? Sepse si dislektik mbase do
13 t'i shkruaj gabim emrat.

14 PY. Në rregull.

15 PË. Në rregull. Ky është personi 1, që është Gjenerali John
16 Reith. 2 është, jam unë. Personi 3, është Gjenerali Mike
17 Jackson. Dhe personi këtu që do ta shënojmë me numër 4, është
18 z. Hashim Thaçi.

19 PY. Faleminderit.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që
21 të pranohet në provë kjo fotografi.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fotografia e
23 marrë nga videoja, përpara se të marr vendimin, a ka
24 kundërshtime?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do pranohet
2 si provë. I lutem Sekretares t'i caktojë një numër.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
4 është dokumenti që do të marrë numrin e provës 1D382.

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund ta hiqni nga ekrani
6 dokumentin, dhe faleminderit.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Vetëm një çast sa ta
8 ruaj, nëse është e mundur.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

10 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses se pse ishit ju aty i
11 pranishëm, Dëshmitar?

12 PË. Po, patjetër. Unë isha i pranishëm sepse unë e kam
13 shkruar tekstin e marrëveshjes.

14 PY. Faleminderit. Kur dhe ku e ka zanafillën ideja për
15 marrëveshje, Dëshmitar?

16 PË. Ideja për marrëveshjen doli si rezultat i bisedave të mia
17 me Gjeneralin Mike Jackson ndërkohë që ai po negocionte
18 marrëveshjen e Kumanovës me serbët.

19 PY. A mund të na tregoni se çfarë të ka thënë ty Gjenerali
20 Mike Jackson, ose për çfarë ishin këto bisedat që kishit ju me
21 të?

22 PË. Së pari dua t'ju shpjegoj se pse po flisja unë me të.

23 PY. Po, patjetër.

24 PË. Sikurse u mundova t'jua shpjegoj dhe pak më herët, detyra
25 ime ishte që të mbuloja çështjet e Kosovës ndërkohë që Mike

1 Durkee ishte përgjegjës për çështjet e Serbisë. Por ne
2 sigurisht që komunikoni me njëri-tjetrin dhe ndanim
3 informacion me njëri-tjetrin. Ndërkohë që Mike Durkee ishte me
4 Gjeneralin Jackson, duke u marrë me Kumanovën, unë kam qenë në
5 Bruksel dhe roli im kryesor ishte që të ndiqja se çfarë
6 ndodhte në Uashington edhe në kryeqytete e tjera të botës.
7 Kishte ndryshim ore, për shkak të gjeografisë, por zakonisht
8 ajo çfarë ndodhte ishte që kryeqytetet na informonin, ne bënim
9 bisedat dhe ndryshimet, mbi bazën e bisedave tona, dërgoheshin
10 përsëri në kryeqytete dhe më pas ata na informonin neve lidhur
11 me zhvillimet më pas. Dhe kjo ndodhte tjetrën ditë, pra në
12 mëngjes të ditës së nesërme.

13 Dhe kjo ka ndodhur në veçanti edhe në Uashington, për
14 shembull në rastin në fjalë kam diskutuar me Mike Jackson në
15 mbrëmje, i kam thënë që "këto janë zhvillimet, mund të presësh
16 që të ndodhë një, dy, tre, gjëra", dhe pastaj ideja ishte që
17 në mëngjes ai duhet të ishte i përgatitur lidhur me zhvillimet
18 gjatë natës për shkak të diferencës së kohës në kryeqytetet e
19 tjera të botës, dhe të mos befasohej nga zhvillimet përkatëse.
20 Ky ishte pra roli im, që ta informoja Gjeneralin Jackson mbi
21 zhvillimet.

22 Mund të vazhdoj më tej?

23 Në këto biseda, Gjenerali Mike Jackson më tha që ishte
24 shumë i shqetësuar që nuk kishte asnjë lloj mekanizmi për të
25 trajtuar ose për t'u marrë me UÇK-në, dhe vlerësoi që UÇK-ja

1 të përbëhej nga rreth nga 20.000 luftëtarë guerilë. Ai ishte
2 pranë momentit të dislokimit në Kosovë, megjithatë, nuk kishte
3 asnjë mekanizëm të ngjashëm me marrëveshjen teknike-ushtarake
4 që do ta lejonte atë që të krijonte një kornizë për të pasur
5 një marrëdhënie me UÇK-në. Ndërkohë që ne të dy ishim të
6 njohur me paralelet historike të një ushtrie që ishte në
7 pozitë për të mbrojtur popullatën e vet dhe që të përfundonte
8 duke luftuar me ta. Në veçanti e kam fjalën këtu për
9 marrëveshjen e Palestinës, midis Palestinës, mandatit të
10 Palestinës së Mbretërisë së Bashkuar në vitet 1940. Dhe ai më
11 pyet, çfarë mendon ti se duhet të bëjmë në këtë rast? Unë i
12 thashë që kam qenë në kontakt me kryeqytetin tim një muaj më
13 përpara. Ju kërkoj ndjesë, ta formuloj ndryshe. Pra, në maj e
14 thashë që kisha qenë në kontakt, duke u bërë thirrje atyre se
15 për ne ishte e nevojshme që të kuptonin shumë më mirë se si do
16 të trajtonim rastin e Kosovës, pra popullin e Kosovës, dhe
17 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Dhe i thashë që pavarësisht
18 interesit tim nuk është se kam bërë shumë përparim lidhur me
19 këtë temë. Për rrjedhojë unë i thashë që "Unë kam trajnim në
20 të drejtën ndërkombëtare. Mendoj që mund të hartoj diçka, mund
21 të hedh diçka në letër, pra, të shkruaj diçka lidhur me
22 qëllimin tuaj, domethënë, në qoftë se ju pajtoheni me mua,
23 mund të shkruaj, mund të paraqes diçka me shkrim për ju". Dhe
24 ai më tha, po.

25 PY. A ishte e nevojshme që ju të merrnit miratimin e ndonjë

- 1 personi tjetër për fillimin e hartimit të tekstit përveç
- 2 Gjeneralit Jackson?
- 3 PË. Jo, jo. Jo për fillimin e hartimit të dokumentit, se kjo
- 4 është natyra e punës së një diplomati. Por, në momentin kur
- 5 ishte shkruar një projekt fillestar të marrëveshjes, sigurisht
- 6 që më duhej që të merrja miratimin për të vazhduar më tej.
- 7 PY. Kur e shkruat ju këtë version fillestar të marrëveshjes?
- 8 PË. Unë e shkrova dhe e kisha gati projektin fillestar të
- 9 marrëveshjes gjatë negociatave. Negociatat përfunduan më 10
- 10 qershor, besoj, në mos gabohem.
- 11 PY. Kam përshtypjen që ka qenë data 9 jo 10.
- 12 PË. Në rregull me datën 9. Atëherë, drafti ose versioni
- 13 fillestar i marrëveshjes i shkruar prej meje ka qenë gati më
- 14 datën 9 qershor. Megjithatë, unë e kisha diskutuar përmbajtjen
- 15 e tij me kryeqytetin tim, me zyrtarët atje, dhe kisha një
- 16 skicim të përgjithshëm të formulimit dhe çfarë synonte që të
- 17 realizonte ky dokument.
- 18 Për shembull, unë flisja me të në mbrëmje, pastaj në
- 19 mëngjes flisja me personat zyrtarë në kryeqytetin tim, si
- 20 funksiononte, cilat ishin përgjegjësitë. Për shembull, kam
- 21 folur me personat zyrtarë të kryeqytetit tim dhe Uashingtonin.
- 22 PY. Kur thua kryeqytetin tim, a mund të na thoni për kë e
- 23 keni fjalë, domethënë me kë keni biseduar dhe kush është
- 24 kryeqyteti juaj.
- 25 PË. E kisha fjalën për shërbimin e jashtëm të Anglisë, kur

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 26

1 them kryeqyteti im.

2 PY. Nga kush duhet të merrnit miratimin ju, pra, në momentin
3 kur e kishit versionin fillestar të marrëveshjes, kush duhet
4 të jepte miratimin?

5 PË. Ka dy pika që lidhen me pyetjen tuaj. Së pari, kemi të
6 bëjmë me mandatin ligjor për t'u përfshirë në negociata, dhe
7 në fakt ky mandat ligjor buronte nga Rezoluta e Këshillit të
8 Sigurimit 1244, që e udhëzonte UÇK-në, domethënë e udhëzonte
9 KFOR-in që të çarmatoste ose të demilitarizonte UÇK-në.
10 Domethënë, ky ishte karakteri ligjor.

11 Por nga ana tjetër kishim edhe karakterin ushtarak që do
12 të duhej që të merrej një miratim dhe për këtë aspekt. Lidhur
13 me këtë unë kam marrë miratimin nga Uashingtoni, nga Londra,
14 nga Sekretari i Përgjithshëm Solana. Sigurisht domethënë që
15 miratimin nga Sekretari i Përgjithshëm Solana e kam marrë
16 përmes Gjeneralit Wesley Clark.

17 PY. Pra, Rezoluta 1244 ju ka autorizuar juve që të hartonit
18 këtë marrëveshje, këtë po thoni, Dëshmitar?

19 PË. Autorizonte COMKFOR-in, domethënë, përbënte bazën ligjore
20 ku mund të mbështetej kjo marrëveshje.

21 PY. Po marrëveshja e Rambujesë, a kishte ndonjë marrëdhënie
22 mes Rambujesë dhe asaj çfarë keni bërë ju, Dëshmitar?

23 PË. Po. Dua që të shtjelloj pak më shumë aspektin ligjor,
24 nëse më lejoni.

25 PY. Po, patjetër.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 27

1 PË. Me çfarë aspekti ligjor po konfrontoheshim ne? Pra,
2 kishte deklaratat të ndryshme dhe mendime të ndryshme në
3 nivelin ndërkombëtar të cilat më pas çuan në Rezolutën 1244.
4 Rambujeja ishte një. Ndërkohë që deklarata e parimeve e grupit
5 G8 ishte një tjetër. Negociatat e Rambujesë nuk e mbaj mend
6 ekzaktësisht se si ishin të formuluar, si ishte marrëveshja e
7 Rambujesë e formuluar, por ideja kryesore ishte që forcat
8 paramilitare nuk janë në përputhje me këtë marrëveshje.

9 PY. Z. Duncan, a na keni dhënë një deklaratë ju më datë 24
10 gusht 2025?

11 PË. Po.

12 PY. A na e keni shpjeguar siç duhet se cilat ishin zhvillimet
13 lidhur me këtë aspekt?

14 PË. Po.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Z. Smith, a mund t'i tregojmë
16 Dëshmitarit atë çfarë na ka thënë më datë 25 gusht 2025?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, patjetër.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull. Do i kërkoja
19 Sekretares të paraqesë në ekran tani deklaratën e dëshmitarit
20 që është DHT11893 deri në DHT11903, paragrafët 14 deri 18.

21 PY. Z. Duncan, do ju kërkonim që t'i lexonit këto paragrafë
22 dhe pastaj do ju kërkoja që t'i përgjigjeshit pyetjes time.

23 PË. Po patjetër. Ju falënderoj se po më ndihmoni goxha. Po,
24 është shumë herë më e thjeshtë tani. Besoj që është edhe më e
25 thjeshtë për Gjykatën për ta kuptuar.

1 Marrëveshja e ndërmjetme e Rambujesë nënkuptonte që UÇK-
2 ja do shpërbehej sepse në të thuheshin që:

3 "Forcat paramilitare dhe të rregullta nuk janë në
4 përputhje me këtë marrëveshje."

5 Kjo shërben si deklaratë parimesh, por nga ana tjetër nuk
6 shpjegon se si do të arrihet kjo, pra nuk jepet mekanizmi për
7 arritjen e kësaj pike. Më pas thuhet që:

8 "... për të realizuar një armëpushim që zgjat, është e
9 rëndësishme që të ndalohen luftimet... Pra, ndërkohë që flitet
10 gjithashtu që ... është e nevojshme që të respektohen
11 parashikimet e këtij kapitulli dhe është e rëndësishme që të
12 mos ketë grupe paramilitare, dhe të mos ketë grupe të
13 parregullta. Dhe kjo është diçka që do të duhet të trajtohet
14 nga komandanti i KFOR-it, COMKFOR. Për qëllimet e këtij
15 kapitulli termi 'Forca' përfshin të gjithë personelin dhe
16 gjithashtu përfshin aftësinë ushtarake përshin dhe ushtrinë e
17 rregullt ose grupet civile të armatosura, grupet paramilitare
18 e kështu me radhë ..."

19 Ideja këtu është që thua çfarë do realizohet, por
20 mekanizmi si do realizohet kjo nuk përcaktohet. Më pas kalojmë
21 tek forcat e tjera. Domethënë dy organizatat më të njohura për
22 të gjithë ishin UÇK-ja dhe FARK-u dhe kjo nënkuptohej me
23 termin "forcat paramilitare" dhe "forcat e parregullta".

24 A të vazhdoj me paragrafin tjetër?

25 PY. Po patjetër.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Kam përshtypjen që bëhet fjalë për
2 paragrafin 21.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

4 PË. Pra, këtu flitet për Rezolutën 1244, paragrafin 9 i kësaj
5 Rezolute, parashikon se:

6 "... është vendosur që përgjegjësitë e prezencës së
7 sigurimit ndërkombëtar do të zhvendosen dhe do të veprojnë në
8 Kosovë, dhe këtu do të përfshijnë pra, përgjegjësitë do të
9 përfshijnë demilitarizimin e UÇK-së, pra Ushtrinë Çlirimtare
10 të Kosovës, dhe grupe të tjera të shqiptarëve të Kosovë siç
11 kërkohet në paragrafin 15 më poshtë".

12 Pra, me fjalë të tjera, COMKFOR-it i jepet përgjegjësia
13 për ta realizuar këtë. Megjithatë, nuk jepen specifikat se si
14 do të realizohet kjo gjë, dhe askush nuk kishte sugjeruar se
15 si duhet të realizohej kjo. Dhe kjo, ky ishte shqetësimi
16 kryesor i Gjeneralit Jackson.

17 Ndërkohë që në paragrafin 22, trajtohet një tjetër
18 çështje. Besoj që do ta shtjellojmë pak më vonë këtë pikë, apo
19 jo?

20 PY. Po.

21 PË. Problemi, ose sfida për ne ishte që në një strukturë
22 ushtarake ti ke autoritetin ligjor që të bësh diçka, domethënë
23 mund të shprehësh aktin e luftës, gjendjen e luftës, etj. Por
24 ndërkohë, në rastin e një operacioni paqeruajtës siç ishte
25 rasti i Kosovës ose rasti në Bosnjë, të duhet diçka që është

1 më poshtë në hierarki. Pra, normalisht ti ke një traktat dhe
2 ke dhe legjislacionin zbatues. Por në kontekstin ushtarak ti
3 ke autoritetin ose miratimin për t'u futur ose për të shkuar
4 në luftë, por të duhet që të kesh rregullat e përfshirjes si
5 dhe të angazhimit, dhe me thënë të drejtën, unë kam shpenzuar
6 shumë kohë për të identifikuar se çfarë duhet të përmbajnë
7 rregullat e angazhimit. Rregullat e angazhimit i tregojnë
8 komandantëve se cilat janë rrethanat në të cilat ata mund të
9 përfshihen në forcë vdekjeprurëse, dhe si duhet të realizohet
10 kjo gjë.

11 Domethënë për të qenë më konkret, mund t'ju themi që
12 parashikimi mund të ishte që në qoftë se ti shikon forcat
13 armike në distancë mund të hapësh zjarr, ose mund të mos
14 hapësh zjarr derisa ata të qëllojnë në drejtimin tuaj. Dhe,
15 një tjetër aspekt që ngrihej gjithë kohës, në rastet
16 paqeruajtëse, është që në qoftë se forcat armike, pra,
17 sulmojnë civilët, ju nuk lejohet që të bëni asgjë deri në
18 momentin kur ata të qëllojnë në drejtimin e tyre. Pra, ideja
19 është që në rregullat e angazhimit përcaktohen se çfarë duhet
20 të bëjnë komandantët. Pra nuk është, nuk duhet të veprosh në
21 momentin kur ti shikon diçka. Por duhet të veprosh atëherë kur
22 të duhet të mbrosh veten.

23 Me fjalë të tjera, domethënë këto janë rregulla angazhimi
24 që u jepen komandantëve dhe ideja është që këto rregulla më
25 pas të transmetohen deri në nivelin e ushtarëve të zakonshëm

1 në terren. Mbase mund të jenë të shkruar më thjesht në disa
2 copa letre që ata t'i kishin me vetë, dhe të bëjnë x gjëra që
3 lejoheshin.

4 Megjithatë, kjo pjesa mungonte në arkitekturën e
5 përgjithshme se si e trajtonim ne UÇK-në, ose çfarë do bënte
6 UÇK-ja në kontekstin e demilitarizimit.

7 PY. Në rregull. Në momentin kur ju keni hartuar marrëveshjen,
8 keni përdorur ndonjë model? Na e shpjegoni pak ju lutem çfarë
9 modeli ka qenë baza e hartimit, sa më shkurt të jetë e mundur.

10 PË. Do të përpiqem t'i bie shkurt. Unë jam rritur në Afrikë.
11 Kisha punuar për çështje të Afrikës në të shkuarën time, në
12 eksperiencën time profesionale, dhe isha shumë i ditur, shumë
13 i njohur me faktin që në fund të konfliktit rodezian, ka pasur
14 në marrëveshje një aspekt që kishte të bënte me trajtimin e
15 ushtrisë rebele atje. Kështu që i kam kërkuar dikujt që ishte
16 i përfshirë në forcën monitoruesve të Komonuelthit se si
17 funksioni kjo marrëveshje. Në qoftë se marrëveshja kishte qenë
18 efektive apo jo. Dhe kolegu im më tha që, po, kishte qenë një
19 marrëveshje efektive, dhe në fakt ishte e mundur që në fund
20 fare luftëtarët guerilë të integroheshin në shoqërinë në
21 mënyra të ndryshme. Ne bëmë testimin mbase disa vite më pas.
22 Dhe ky ishte koncepti bazë që unë kam shtjelluar. Kjo është
23 baza ime, këtë e kam bashkuar po ashtu edhe me aspekte të
24 ndryshme të Rambujesë, kam përfshirë gjithashtu edhe
25 marrëveshjen teknike me serbët, dhe duke marrë parasysh të

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 32

1 gjitha këto dokumente, unë jam mbështetur në të, më pas
2 hartova ose krijova atë çfarë më pas u bë marrëveshja.
3 PY. Çfarë qëllimi të përgjithshëm kishte marrëveshja, mund të
4 na e shpjegoni?

5 PË. Qëllimi i përgjithshëm i marrëveshjes ishte të lejonte
6 demilitarizimin e kontrolluar dhe të përgjegjshëm të UÇK-së
7 dhe të FARK-ut, dhe të lejonte COMKFOR-in që të realizonte
8 detyrimet që ishin përcaktuar në Rezolutën 1244 të Këshillit
9 të Sigurimit. Domethënë, ka shumë nënpika të tjera, megjithatë
10 ky është objekti i përgjithshëm i këtij dokumenti.

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mbase është momenti i
12 përshtatshëm për të bërë një pushim tani përpara se sa të
13 shtjellojmë nënpikat e tjera të këtij dokumenti?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
15 dhjetë minuta pushim tani dhe pastaj do të vazhdojmë me
16 dëshminë tuaj.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
20 pushim deri në orën 10.10.

21 --- Pauza fillon në orën 09.58

22 --- Seanca rifillon në orën 10.10

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
24 dëshmitarin në sallë, ju lutem.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 33

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

2 Tavakoli, mund të vazhdoni.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

4 PY. Para pushimit thatë se kishte një numër të qëllimeve

5 dytësore që të thuash apo anësore. Ju lutem na tregoni se

6 cilat ishin, por më ngadalë për shkak të përkthimit.

7 PË. Nëse më lejoni, të nderuar Gjykatës, a mund ta vendosim

8 në ekran dëshminë time pasi është shumë e ndërlikuar. Dhe

9 është e vështirë që të kuptohen disa konflikte ndaj njerëzve

10 që mendojnë ndryshe dhe prandaj për të dhënë të tërë

11 kontekstin do të ishte me vlerë sikur ta kishim në ekran

12 dëshminë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë

14 kundërshtim?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk ka problem. Ne mendojmë që

16 tani ka të bëjë me paragrafin 31.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po. Janë vetëm dy paragrafë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpiquni që

19 të mos e lexoni. Ideja është që të freskoni kujtesën dhe të

20 jepni dëshminë gojore.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Dakord.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju lutem të shohim në ekran

23 paragrafin 31.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Dakord.

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të shkojmë në fund. A kemi

1 arritur në fund të këtij paragrafi? Dakord.

2 PY. Cilat ishin objektivat e tjera të kësaj marrëveshjeje?

3 PË. Siç e thashë, qëllimi tërësor apo i përgjithshëm ishte që
4 të kishim një mekanizëm me anë të cilit të kishim mundësi të
5 kontrollonim procesin e çmilitarizimit, çarmatosjes me qëllim
6 që të bëhej në mënyrë të kontrolluar në marrëveshje me UÇK-në.
7 Pasi kështu do të siguroheshim që ato nuk do të ishin armiku
8 ynë.

9 Ky ishte shqetësimi ynë kryesor edhe ligjor apo ushtarak.
10 Po kishte dhe një shqetësim si të thuash nga pikëpamja
11 politike, pasi donim të ishim të bënim të mundur që Kosova të
12 mos përballej me një situatë, siç kishte ndodhur në vende të
13 tjera të Ballkanit, ku strukturat politike ishin të lidhura në
14 mënyrë të ngushtë me strukturat ushtarake apo policore. Pra,
15 ne donim që këto struktura të ishin tërësisht të ndara. Pra,
16 këto struktura që ne mendonim që ekzistonin donim që të
17 funksiononin në mënyrë të veçuar me qëllim që kështu të ishte
18 edhe baza për të shkuar në drejtim të një shoqërie
19 demokratike.

20 PY. Kur thatë që kishin ekzistuar këto struktura politiko-
21 ushtarake apo policore, ku kanë ekzistuar?

22 PË. Ishin të shpërndara.

23 PY. Nuk e kisha fjalën nga pikëpamja gjeografike.

24 PË. Ekzistonin citoj "forca policore" se kishin emrin forca
25 policore. Ne nuk kishim dijeni sa të shpërndara gjeografikisht

1 ishin ato apo sa të efektshme e kishin punën e tyre. Ne kishim
2 dijeni që ekzistonin. Ne kishim dijeni po kështu për
3 pikëpamjen ushtarake, pasi një gjë e tillë vërehej. Po kështu
4 kishim dijeni dhe për aspektin politik që ishin njerëzit që
5 përreth Hashim Thaçit. Ne dinim që kishte dhe pjesë të tjera
6 të këtij spektri, si të thuash të përkohshëm, LDK-ja dhe të
7 tjerë.

8 Pra, ne kishim këto struktura politike dhe në qoftë se
9 nuk do të kishin si të thuash bazën apo mbështetjen e policisë
10 apo të ushtrisë nuk do të ishte e mirë për të ardhmen.

11 PY. Që ta kemi të qartë, kur thoni që ju nuk keni strukturën
12 politike e cila e kishte mbështetjen apo reagimin mbi pjesën e
13 strukturës politike dhe ushtarake, çfarë ishte sipas mendimit
14 tënd, çfarë do të ndodhte me strukturën politike sipas
15 mendimit tuaj?

16 PË. Sipas marrëveshjes ato do të funksiononin në mënyrë të
17 veçuar.

18 PY. Faleminderit.

19 PË. Sa i përket aspektit ushtarak apo të ushtrisë, kjo do të
20 bëhej përmes kontrollit të NATO-s. Ato do të ishin të dukshme.
21 Gjëja më e keqe që mund të ndodhë është që luftëtarët e UÇK-së
22 të zhdukeshin në male dhe në atë mënyrë ne nuk do të mund t'i
23 shihnim apo t'i kontrollojmë. Ky mekanizëm ka siguruar mënyrën
24 për të bërë që ato të bindeshin, pasi përmbante edhe përfitime
25 po edhe ndëshkime.

1 Ju, si ushtri e Kosovës, bini dakord që të zbrisni nga
2 malet, të shkoni në kampet, të dorëzoni armët dhe si shpërblim
3 ne do t'ju gjejmë juve një rol për të luajtur në shoqëri.

4 Dhe kështu funksionoi ky proces në Namibi dhe ky është
5 modeli që shfrytëzova unë për ta hartuar këtë marrëveshje.

6 Një nga shqetësimet tona të menjëhershme ishte që të mos
7 i krijonim mundësinë UÇK-së që të luftonte serbët, pavarësisht
8 se serbët kishin rënë dakord me armëpushimin dhe kishin
9 nënshkruar marrëveshjen ushtarake teknike, nuk kishin
10 mekanizëm për ta bërë një gjë të tillë, pra, ne donim që të
11 kishim një marrëveshje me UÇK-në që ata të mos të mund ta
12 shkatërronin procesin e pages. Kjo ishte mënyra për ta bërë
13 një gjete të tillë.

14 Pjesë tjetër e marrëveshjes ishte edhe inkurajimi se me
15 nënshkrimin e marrëveshjes, nënkuptohej që të vazhdonte
16 procesi që UÇK-ja, nga perceptimi ndërkombëtar, të shndërrohej
17 nga një grup kriminelësh apo terroristësh, të ishin luftëtarë
18 të lirisë që kishin nënshkruar Marrëveshjet e Rambujesë. Ky
19 ishte një hap në drejtim të demokracisë, pra, ata do të
20 pranoreshin si një grup i përgjegjshëm njerëzish me një proces
21 të respektueshëm politik që i drejtonte.

22 Pra, ajo që i kemi ofruar është kjo. Ju thamë,
23 "Nënshkruani një gjë të tillë. Kjo na ndihmon që të mos
24 luftojmë njeri-tjetrin. Por ju ndihmon edhe juve, pasi nëse
25 nënshkruani do t'i tregoni komunitetit ndërkombëtar që jeni

1 persona përgjegjës që e meritoni respektin dhe, në fund të
2 fundit, apo si proces i fundit edhe pavarësinë".

3 PY. Ju sapo thatë që kjo "do të bëhej nën kontrollin e NATO-
4 s". Çfarë e kishit fjalën? Për çfarë e keni fjalën? Kush do të
5 ishte nën kontrollin e NATO-s apo çfarë?

6 PË. Ish-luftëtarët e UÇK-së do të vireshin nën kontrollin e
7 NATO-s, siç edhe ndodhi.

8 PY. Përse ishte një gjë e tillë kaq e rëndësishme?

9 PË. Me qëllim që të kishim vizibilitet apo pamshmëri që të
10 kemi mundësinë që t'i ndëshkonim nëse ishte e nevojshme dhe që
11 kjo të kishte bazë ligjore.

12 PY. Për cilën forcë të armatosur e keni fjalën?

13 PË. Edhe në këtë rast dhe kjo është paksa e ndërlikuar, le ta
14 thjeshtëzoj. Ne e dinim që UÇK-ja ishte forca luftarake më e
15 madhe dhe më e efektshme. Kishte dhe të tjera, kryesisht FARK-
16 u. Por nëse UÇK-ja e nënshkruante këtë marrëveshje të tjerët
17 do të mënjanoreshin nga njëra anë, nga ana tjetër, ata do të
18 kishin edhe motivimin për t'ju bashkuar kësaj marrëveshjeje
19 pasi po të bëheshe pjesë e kësaj marrëveshjeje, si shpërblim
20 ke respekt dhe nder. I kthehem përsëri kësaj çështjeje.

21 PY. Jo, dua t'ju ndaloj. Nuk e di çështjen e përkthimit.

22 Përgjigja juaj kur unë thashë se kush do të ishte në
23 kontrollin e NATO-s, këtu thuhet që partitë e UÇK-së. Kështu
24 është, apo jo?

25 PË. Jo. Ushtria.

1 PY. Pra, ushtria do të ishte nën kontrollin e NATO-s. Dhe
2 para se të kaloni, dua t'ju pyes a u vendos nën kontrollin e
3 NATO-s dhe nëse ndodhi një gjë e tillë kur?

4 PË. Filloi kjo menjëherë pas fillimit të procesit të
5 çarmatosjes. Ata filluan të vinin në kampe, marrëveshja tregon
6 vendet se ku do të grumbulloheshin dhe aty filluan të
7 grumbulloheshin.

8 PY. Po u ndaloj. Ju ndalova. Ju kërkoj ndjesë. Thatë që
9 kishte dhe forca të tjera luftarake, FARK-u ndaj të tjerët.

10 PË. Po forcat e tjera luftarake si, për shembull, FARK-u do
11 të kishin motivimin që të bëheshin pjesë e kësaj
12 marrëveshjeje, pasi do të duhej të merrnin përfitimin.
13 Përfitimi ishte respekti dhe mundësia e vendeve të punës që
14 ishte pjesë e kësaj marrëveshjeje. Ne nuk ishim në gjendje që
15 të specifikonim se çfarë trajnimi do të merrnin apo se në
16 çfarë do të shndërrohej UÇK-ja në atë fazë. Ishte e pamundur
17 që unë në atë moment që të siguroja miratimin e Londrës apo të
18 Uashingtonit e aq më pak kjo marrëveshje e gjerësishme
19 ndërkombëtare se çfarë do të ndodhte me UÇK-në pas
20 çarmatosjes.

21 Por kjo pjesë integrale e këtij teksti. Aty nënkuptohet
22 që do të shndërrohet në diçka. Unë e dija se çfarë do të
23 ndodhte. Ua kisha shpjeguar këtë komandantëve. Dhe kjo ishte
24 bazuar në modelin francez, unë jam francez dhe e dija për
25 këtë, bëhej fjalë për *Securite Civile*, që është një fuqi apo

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 39

1 një grup i forcave të paarmatosura. Unë e dija, Bernard
2 Kouchner e donte, por ata që nuk kanë ide për një gjë të
3 tillë, nuk kanë dijeni se si funksionon. Dhe brenda disa
4 ditëve, nuk ishin në gjendje që t'i bindja njerëzit që kjo
5 ishte një ide e mirë që do të mund të shfrytëzohej dhe të
6 funksiononte. Nuk ishte momenti ai që mund të ndodhte kjo. Ky
7 ishte nënteksti pra.

8 PY. Cilët ishin disa prej sfidave të hartimit të kësaj
9 marrëveshjeje?

10 PË. A mund të zbresim pak poshtë në tekst?

11 PY. Unë mendoj që është paragrafi 32.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund ta
13 lejojmë z. Duncan që t'i hedhë një sy dhe pastaj të jap
14 dëshminë?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit. Besoj që kalon
17 edhe në faqen tjetër.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Po ashtu është dhe e di se çfarë
19 thuhet në faqen tjetër.

20 Argumenti im kishte një element kyç që ka të bëjë me
21 pikën që sapo diskutuam, me aspektin që sapo diskutuam. Në
22 Namibi dhe në Rodezi kanë ekzistuar ushtritë, ushtritë e tyre.
23 Kështu që disa prej guerilëve u bënë pjesë e këtyre ushtrive,
24 pra, u bënë ushtarë të rregullt. Dhe këtë donte edhe UÇK-ja që
25 të ndodhte. Mirëpo Kosova nuk ishte shtet, nuk kishte ushtrinë

1 e saj. Dhe për këtë arsye ekzistonte një sfidë jo e vogël se
2 çfarë do të ndodhte me këta persona, me këta njerëz. Dhe
3 prandaj unë krijova idenë që të ishte -- krijova një organizim
4 i ngjashëm me *Securite Civile*, që unë e dija që njerëz si
5 Bernard Kouchner do ta kuptonin se çfarë ishte dhe do të
6 ushtronin trysni që kjo të realizohej pasi nuk kishte mundësi
7 që të bëhej ndryshe. Ata nuk mund të shndërroheshin thjesht në
8 persona civilë, pasi nuk do të ishte paqe kjo bashkë,
9 ndershmërisht si të thuash. Kjo ishte një sfidë e madhe.

10 E dyta është koha e kufizuar. Uashingtoni dhe Londra
11 dhanë miratimin për këtë më datën 10 qershor. Serbët e kishin
12 për t'u larguar nga Kosova brenda 10 ditëve. Kjo duhej bërë
13 brenda një periudhe rekord. Dhe kjo ishte sfidë në vetvete.

14 Komandanti i COMKFOR-it, Mike Jackson, i cili kishte
15 autoritetin për ta zbatuar nuk mund ta zbatonte një gjë të
16 tillë pasi ai në atë kohë po merrej me faktin që rusët kishin
17 marrë nën kontroll Prishtinën dhe unë kam luajtur një rol të
18 madh dhe ai ka luajtur një rol shumë të madh për zgjidhjen e
19 asaj krize. Nga ana tjetër ai duhej të dislokonte të gjitha
20 forcat e tjera, që është në fakt një detyrë shumë e vështirë
21 ushtarake. Pra, koha e shkurtër ishte sfidë e jashtëzakonshme
22 për ne.

23 Problemi tjetër ishte se Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk
24 ishte një forcë heterogjene. Siç e përshkrova më lart ne e
25 quanim atë "ushtria e atyre që s'kishin asgjë". Ky ishte termi

1 që kam përdorur në atë kohë. Dhe kur kam shkuar në terren kam
2 parë njerëz që kishin patur një jetë normale, ata ishin
3 civilë, ishin doktorë, avokatë, njerëz të cilët kishin lënë
4 punën dhe kishin marrë armët. Aspiratat e tyre nuk ishin të
5 njëjta.

6 Dhe kur negocion me këta njerëz duhet të kuptosh cili
7 është synimi i tyre, si kanë arritur në këtë pikë, çfarë
8 faktorësh i shtyn që të shndërrohen në atë pikë ku ndodhen,
9 cilat janë aspiratat e tyre, interesat e tyre. Dhe duhet që të
10 gjitha këto gjëra të shfrytëzohen për t'i bindur njerëzit për
11 të bërë një gjë të ndryshme. Mirëpo aspiratat nuk ishin të
12 njëjta, motivimi nuk ishte i njëjtë, ata ishin pjesë, vinin
13 nga shtresa të ndryshme të shoqërisë. Disa ishin ish-ushtarakë
14 të armatës Popullore Jugosllave dhe donin që të mbeteshin
15 ushtarakë.

16 Problemi tjetër i madh ishte që udhëheqësia e UÇK-së siç
17 personifikohet - dhe po i zgjedh me kujdes fjalët këtu - siç
18 personifikohet nga Hashim Thaçi, mund të mos ishin në gjendje
19 që t'i bindnin ushtarët e UÇK-së të cilët ne nuk ishim të
20 bindur që do të ndodhte një gjë e tillë apo që kishte këtë
21 mundësi. Po të ishim të bindur që kjo do të ndodhte do të
22 kishim shkuar tek udhëheqësia politike e UÇK-së do t'i kishim
23 thënë që "Kemi nevojë për një marrëveshje të çarmatosjes. Dhe
24 ta negociojmë".

25 Pra, siç e thashë, ne nuk kishim kohë të madhe në

1 dispozicion dhe ne nuk kishim besim që z. Thaçi do të ishte në
2 gjendje që t'i binte ushtarakët apo ushtarët.

3 PY. A thatë që Kosova nuk ishte hetoregjene?

4 PË. Jo, kërkoj ndjesë. Nuk ishte homogjene. Ishte
5 heterogjene. Ju kërkoj ndjesë.

6 Sa i përket udhëheqjes politike nëse mund të shtoj diçka.
7 Nuk ishte realiste që z. Thaçi të njihej si udhëheqësi politik
8 i Kosovës. Kishte forca të tjera politike që ekzistonin atje
9 si LDK-ja, z. Rugova dhe të tjerët. Ata mund të kishin
10 zgjedhur atëherë si udhëheqës të delegacionit të Rambujesë,
11 por ai nuk ishte atë që quhet legjitimiteti politik në një
12 shoqëri demokratike. Nuk ishte zgjedhur nga populli. Ai kishte
13 deklaruar një Qeveri të Përkohshme por ne kishim arritur në
14 pikën që ne, në fakt, apo NATO ta njihte atë si një
15 kryeministër të Kosovës. Nuk ishte kjo gjë realiste, nuk
16 përfaqësonte realitetin dhe nuk ishte në fakt e qëndrueshme
17 nga pikëpamja politike.

18 PY. Z. Duncan, kjo përgjigje ka shumë elementë dhe dua t'i
19 trajtojmë një nga një. Gjëja e parë që thatë ju, folët për
20 "udhëheqja e UÇK-së e personifikuar - dhe po i zgjedhë fjalët
21 me kujdes - e personifikuar nga Hashim Thaçi i cili nuk mund
22 të ishte në gjendje t'i bindte ushtarët e UÇK-së". Çfarë
23 nënkuptoni me fjalën "i personifikuar nga"?

24 PË. I referohem pyetjes së më hershme lidhur me rolin --
25 përgjigjes sime të mëhershme lidhur me rolin e diplomatëve.

1 Komuniteti ndërkombëtar dhe kemi thënë këtë se kjo ka të bëjë
2 me median, politikanët, shoqërinë civile, është e domosdoshme
3 që politikanët, që diplomatët të kenë me kë të flasim. Medias
4 i pëlqen një gjë e tillë. Media thotë ky është Nelson Mandela,
5 ky është personi, e shembuj të tillë ka të shumtë, po
6 realiteti nuk është i atillë. Ka edhe udhëheqës të tjerë rreth
7 e rrotull.

8 Dhe si diplomat, e ke për detyrë ta kuptosh se sa e
9 ndërlikuar është një situatë dhe t'i tregoni kryeqytetit tuaj
10 sesi është situata dhe për sa i përket negociatave. Duhet t'i
11 tregosh se cili është personi i cili i ka të gjithë pushtetin
12 apo mënyrën e ushtron pushtetin real. Shembulli më i fundit
13 ishte në Irak. Nëse ju kujtohet, në Irak kemi pasur Chalabi i
14 cili ishte udhëheqës i supozuar i opozitës dhe sapo ndodhi
15 pushtimi ai u zhduk. Një gjë e tillë ndodhte gjatë gjithë
16 kohës dhe kjo ndodhi dhe në Kosovë në fillin. Udhëheqësi i
17 kosovarëve mendohej që ishte Rugova. A mund të ishte ai, a
18 mund të ishte një person tjetër, pastaj a mund të bëhej ai,
19 pastaj i ndodhi z. Thaçi që ishte si personifikim, si të
20 thuash, i UÇK-së, i shoqërisë dhe i kosovarëve. Ne kishim
21 dyshime të mëdha lidhur me këtë çështje.

22 PY. Përse nuk kishit ju besim që z. Thaçi do të mund t'i
23 bindte ushtarakët në terren?

24 PË. Sipas informacionit --

25 PY. Nga ç'burim vjen ky informacion?

1 PË. Jo, nuk i përgjigjem dot kësaj çështje.

2 PY. Vazhdoni.

3 PË. Fuqinë reale në strukturën e UÇK-së e kishin komandantët
4 rajonalë dhe kjo na u konfirmua kur takuam me Gjeneral Agim
5 Çekun në fillim të negocimit të marrëveshjes. Ai na tha që
6 këtë "unë nuk e bëj dot pa praninë e komandantëve të zonave.
7 Ju duhet të vini në Kosovës".

8 PY. Dhe çfarë kuptuat nga kjo që tha Z. Çeku?

9 PË. Unë i besova. Ai ishte shumë ngulmues për këtë çështje.
10 Ai tha dy gjëra. E para tha që z. Thaçi nuk ishte i
11 disponueshëm dhe për ta bërë një gjë të tillë ai, pra, z.
12 Thaçi, do të duhej të konsultohet dhe më pas ai shtoi, që "Unë
13 nuk e bëj dot një gjë të tillë në qoftë se ne në negociata nuk
14 marrin pjesë komandantët e zonave"

15 PY. Ku e keni bërë këtë bisedë me z. Çeku?

16 PË. Në Tiranë.

17 PY. A ju kujtohet kur?

18 PË. Po, më 14 qershor.

19 PY. Dhe kur ai tha se ai do të duhej të konsultonte z. Thaçi,
20 çfarë nënkuptuat me këtë gjë?

21 PË. Mua mu duk krejtësisht normale që pjesa politike e
22 organizatës -- le ta them ndryshe. Si komandant ushtarak po ta
23 bënte këtë pa mbështetjen e pjesës politike, kjo, në fakt,
24 nënkuptonte që udhëheqja politike nuk do të kishte kompetenca,
25 do kishte ndarësi. Dhe ishte normale që të thoshte kam nevojë

1 që për këtë të bien dakord, të paktën të konsultohet pjesa
2 politike. Nëse bëhet fjalë për zbatim politik, apo jo, nuk e
3 di.

4 PY. Dhe ai tha se nuk mund ta bënte një gjë të tillë në qoftë
5 se në negociata nuk merrnin pjesë komandantët e zonave?

6 PË. Po.

7 PY. Si e kuptuat ju një gjë të tillë?

8 PË. Shumë e qartë, që nuk ishte i gatshëm që të hynte në
9 negociata ai si komandant pa praninë komandantëve të tjerë. I
10 donte që ata të ishin të pranishëm.

11 PY. Çfarë nënkuptuat ju me mënyrën se si funksiononte UÇK-ja?

12 PË. Që komandantët e zonave kishin fuqi të madhe që kishin të
13 paktën një lloj pavarësie. Ishin komandantë me fuqi të mëdha.
14 Nga pikëpamja ushtarake, kjo gjë ishte paksa e pazakontë.

15 Forcat tona ushtarake nuk kërkojnë që komandantët rajonalë të
16 jenë të pranishëm në negociata në qoftë se kemi komandantë të
17 nivelit të lartë apo shtabet e tyre.

18 PY. Kur thua "forcat tona" për kë e ke fjalën?

19 PË. Për forcat e NATO-s apo forcat britanike. Pra, ishte e
20 pazakontë të thuhej një gjë e tillë, po nuk më çuditi.

21 PY. Fakti që ju nuk e keni menduar që Hashim Thaçi -- më
22 falni, ta bëj pyetjen ndryshe. Si ndikoi kjo në procesin tuaj
23 gjatë negociatave? Çfarë nuk besojë ti se do të ndodhte? Pse
24 mendoje ti që Thaçi nuk do të bindte dot luftëtarët në terren?

25 PË. Kjo shpjegon pse shkua tek Gjeneral Çeku dhe komandantët

1 e zonës.

2 PY. Kur thoni "ne", për kë e keni fjalën?

3 PË. Unë, John Reith dhe ekipet tona. Dhe miratimi i
4 Sekretarit të Përgjithshëm Solana ishte pikërisht ajo që donim
5 të bënim ne. Ne i thamë "Këtë duhet të bëjmë. Kjo është mënyra
6 më e mirë për të vepruar" dhe ai tha "Në rregull. Kështu
7 veproni".

8 PY. Po çfarë mendonit ju se mund të bënte Çeku?

9 PË. Kjo lidhet me përgjigjen që dhashë më herët kur thashë
10 për NATO-n, si duhet të vepronte NATO. Si rregull, NATO do të
11 ftonte komandantët e lartë të bëhej një marrëveshje mes
12 Gjeneralit Clark dhe cilitdo që mund të ishte nga pala tjetër.
13 Nuk do të shkonim kurrë në nivel rajonal. Pra, kjo shërben për
14 të kuptuar strukturën hierarkike, pra, si funksiononte atje
15 dhe në strukturë hierarkike që po funksiononte në mënyrë jo
16 hierarkike. Kjo ishte vështirësia me të cilën po përballeshim
17 ne sepse nuk kishin struktura hierarkike, ishin të organizuar
18 ndryshe, pushtetet ishin të ndryshme në vende të ndryshme.

19 Nuk mund të shkonim thjesht dhe të bisedonim me z. Thaçi
20 apo me Gjeneral Çekun dhe të mendonim të e zgjidhëm problemin.
21 S'funksiononte kështu. Duhet të flisnim me personat që vërtetë
22 kishin kompetenca dhe ata ishin komandantët e zonave. Nuk e di
23 a ju përgjigja pyetjes suaj?

24 PY. Po. Po lexoj që thatë pak më herët. Më jepni një çast ju
25 lutem.

1 Pak më herët, po ashtu thatë në faqen 39 të transkriptit,
2 thatë:

3 "... kjo nuk ishte një situatë që NATO ta miratonte dhe
4 nuk mund ta njihte si kryeministrin në fuqi të Kosovës. Nuk
5 ishte realiste. Nuk pasqyronte realitetin dhe ishte e
6 parealizueshme nga pikëpamja politike."

7 Mund të na e shpjegoni këtë?

8 PË. Po çfarë doni që t'ju shpjegoj?

9 PY. Kur thoni, pra, pse nuk do ta njihte NATO z. Thaçi si
10 kryeministër të Kosovës?

11 PË. Forcat aleate nuk do të pajtoheshin për këtë. Nuk ishin
12 ende gati ta njihnin Kosovën në vetvete si shtet dhe,
13 sigurisht, që nuk ishin ende gati të njihnin Hashim Thaçi si
14 udhëheqësin e Kosovës. Prandaj quhet marrëveshje kjo. Nuk mund
15 të bënin një marrëveshje dypalëshe mes NATO-s dhe Qeverisë së
16 Përkohshme të Kosovës, pra, parimisht ekzistonte, po nga
17 pikëpamja politike nuk ekzistonte shteti i Kosovës, as qeveri
18 të Kosovës e andaj NATO nuk mund të bënte një marrëveshje
19 dypalëshe me një shtet që nuk ekzistonte e për rrjedhojë një
20 qeveri që nuk ekzistonte. Prandaj ishte një zotim, një ofertë
21 nga pala kosovare për ne. Prandaj kemi thënë zotim,
22 marrëveshje zotuese më shumë sesa marrëveshje dypalëshe,
23 angazhim prej tyre.

24 PY. Po çfarë mendonte NATO për faktin që Hashimi thirrej si
25 kryeministër, si e kuptonte NATO këtë?

1 PË. Nuk e njihnin.

2 PY. Faleminderit. Na thatë se jeni takuar me Agim Çekun në
3 Tiranë. Dhe kjo ka ndodhur më 14 qershor, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Ju pamë tek videoja ngjitur me gjeneralin Reith?

6 PË. Po.

7 PY. Çfarë roli kishte Gjenerali Rieth gjatë negociatave dhe
8 kur e keni takuar për herë të parë?

9 PË. Për t'ua shpjeguar më thellë. Unë kisha pëlqimin nga
10 Londra dhe nga Uashingtoni për të filluat "Marrëveshjen
11 angazhuese", por kjo ishte diçka, ishte një marrëveshje që të
12 merrnim një zotim prej tyre. Ishte e njëanshme. Nuk ishte një
13 marrëveshje dypalëshe në kuptimin e mirëfilltë. Por unë doja
14 t'i bindja që të nënshkruanin një dokument që s'e kishin parë
15 asnjëherë më përpara dhe duhet ta bënin brenda shtatë ditësh.

16 Mua nuk më njihte UÇK-ja. As nuk më kishin parë
17 ndonjëherë. Detyra ime ishte të më dëgjonin, jo të më shihnin.
18 Kur më thanë, "Shko dhe realizoje këtë gjë", unë ju thashë kjo
19 nuk ka për të funksionuar. Unë s'mund të shkoj si një diplomat
20 i panjohur, të shkoj te UÇK-ja me një grup personash që po
21 luftonin në malet, në bjeshkët e Kosovës dhe të them
22 urdhëroni, firmoseni këtë. Nuk do të funksionojë. Na duhet një
23 komandant ushtarak që të jetë në pararojë, që të angazhohet me
24 ta, të cilin e respektojnë, të cilit ia dinë punën dhe i cili
25 do të komunikojë me ata. Dhe Johnn Reith ndonëse ishte shumë i

1 përfshirë, shumë i angazhuar me krizën humanitare, kjo ishte
2 përgjegjësia e tij me refugjatët që ishin në Shqipëri, John
3 Reith kishte negociuar më përpara në Ballkan edhe ai tha "në
4 rregull, do ta bëj unë". Kështu që unë shkova e informova se
5 çfarë duhej bërë dhe e shoqërova për gjatë gjithë procesit.

6 PY. A ju kujtohet kur e keni informuar?

7 PË. Më 13 qershor.

8 PY. Më 14 takuat Agim Çekun?

9 PË. Po.

10 PY. Kur e takuat Çekun, si e priti ai idenë e kësaj

11 marrëveshjeje angazhuese, këtij angazhimi?

12 PË. Nga një anë të jepte përshtypjen sikur ishte udhëheqësi i
13 një ushtrie çlirimtare. Kështu u prezantua. Tha, "Burrat dhe
14 gratë e mia kanë luftuar me Serbinë, ju na keni ndihmuar,
15 faleminderit, por ne e fituam betejën". Ai e pa dokumentin që
16 i treguam, pasi e lexoj shpejt e shpejt ai tha, "Po e prisja
17 diçka të tillë", tha që, "Dakord, mund të punojmë për këtë
18 gjë, por duhet diskutuar dhe me komandantët e zonave". Dhe
19 tha, "Unë e kam bërë një pjesë të kësaj pune. I kam thënë
20 njerëzve të mi që të mos angazhohen me serbët. U kam dhënë
21 urdhër komandantëve të zonave të mos angazhohen me serbët por
22 të qëndrojnë të tërhequr. Por le ta diskutojmë më tej". Dhe
23 bëme një takim, mbledhje tjetër të nesërmen dhe të nesërmen na
24 tha, "Duhet diskutuar kjo me komandantët e zonës, përndryshe
25 kjo nuk bëhet, është e pabëshme".

1 PY. Ku u mbajt takimi ditën tjetër?

2 PË. Paraditen e nesërme është bërë takimi. Atë na e tha. Pra,
3 herën e parë u takuam në 14 në mbrëmje dhe të nesërmen
4 paradite na tha "duhen dhe komandantët e zonave".

5 PY. Në të njëjtin vend?

6 PË. Po, në të njëjtin vend.

7 PY. A ishte Hashim Thaçi në këtë takim?

8 PË. Jo.

9 PY. Pra, Çeku ju tha nuk mund ta bëjmë këtë pa miratimin e
10 komandantëve të zonave. Ju i ofruat që të kishit një takim ku
11 të ishin dhe ata të pranishëm?

12 PË. John Reith është personi që ofroi të bëhej një takim ku
13 të ishin të pranishëm komandantët e zonave ku mua më befasoi,
14 të jem i singertë.

15 PY. Pse u befasuat?

16 PË. Sepse do të mbahej në Kosovë në një zonë që ishte ende
17 nën pushtimin serb dhe unë isha një civil vetë.

18 PY. Si u ndjeve?

19 PË. U befasova pra. I thashë John Reith asokohe, "Ti ke
20 siguracion jete. Unë jo. Po më çon në një zonë lufte dhe unë
21 s'kam siguracion jete dhe po ma bën pak të vështirë punën".
22 Nuk thashë jo. Por i thashë duhet të përgatitemi pak para se
23 të shkojmë.

24 PY. Kur ndodhi ky takim?

25 PË. Më datë 17.

1 PY. Kur mbërrite në atë vend?

2 PË. Natën, kaluam përmes bjeshkëve, hymë në Kosovë. Takimi u
3 mbajt natën sepse serbët ishin ende në atë pjesë të Kosovës, e
4 kishin ende të pushtuar atë pjesë të Kosovës.

5 PY. Ju kujtohet ai udhëtim?

6 PË. Sigurisht që po.

7 PY. Na tregoni.

8 PË. Na çuan me helikopter mbi bjeshkë dhe hymë në një zonë të
9 pyllëzuar edhe mbaj mend që ka pasur një stuhi gjatë kohës që
10 ka ndodhur kjo me vetëtimën, me bubullima edhe e bëri edhe më
11 "të këndshme" punën. Po bëhesha ironik, s'ishte aspak për të
12 qeshur ajo që ndodhi.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do ju tregoj një video. Është
14 prova materiale me numër 1D00287. Dhe ju lutem ta shohim nga
15 minuta 03:02 dhe në vijim. Pastaj do t'ju bëj pyetje. E
16 shikojmë deri në minutën 05:48.

17 PY. Dhe më parashtroj do t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë.

18 [Luhet videoincizimi]

19 "... problemi është që Gjeneralit Jackson po i kërkohet
20 në qoftë se do jenë armë të tilla në qytet, luftëtarë me armë
21 do t'i konfiskojë, prandaj është më së miri në tonën që të mos
22 shkojnë ushtarët me armë sepse ai do të japë urdhër pastaj të
23 konfiskohet. Dhe ajo sjell konfrontime. [Njerëz që flasin
24 njëkohësisht].

25 "S'un na e marrin.

1 "A do të jetë e mundur që të takohemi nesër në mbrëmje në
2 vend që të takohemi të shtunën?

3 "Nuk e dimë a na vjen kryeministri.

4 "Është krijuar dhe për faktin që do të jemi nën një
5 presion politik. Dhe ata do të na bëjnë presion gjatë gjithë
6 kohës për shumë detaje për këtë. Gjithçka folëm duhet sqaru.
7 Mundësia me gabu është e madhe. [Njerëz që flasin
8 njëkohësisht]

9 "Në qoftë se nuk mund ta bëni -- nuk mund të bëhet nesër
10 në mbrëmje unë do të pëlqejë që të bëhet të shtunën në
11 mëngjes.

12 "11.00 ora është mëngjes.

13 "Paradite.

14 "Ora 10.00?

15 [Njerëz që flasin njëkohësisht].

16 "Dua të rri jashtë syve të mediave. Tani ky do të jetë
17 një dokument i juaji. Dhe shikoni për të bërë invazivin me ju
18 edhe do të thonë që kjo është marrëveshje -

19 "U vendos e shtuna, mirë është.

20 "Kështu që është më mirë. Këtu ke me çu. Ideja tjetër që
21 do të thojë, në qoftë se ju e ndjeni që mund të diskutojmë
22 edhe më herët sesa ora 10.00, të shtunën, unë mund të vij edhe
23 më herët. [Folës që flasin njëkohësisht]

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ndalojmë këtu.

25 PY. Z. Duncan, çfarë video është kjo?

1 PË. Është një video që tregon diskutimet e datës 17 qershor
2 1999 në Kosovë.

3 PY. Njihni ndonjë prej personave në video?

4 PË. Unë, Gjeneral Çeku, John Reith. Komandantët e zonave
5 Ramush Haradinaj. Më dukej se dhe Remi ishte aty. Ishte një
6 tjetër që s'më kujtohet emri që ishte nga struktura e policisë
7 së tyre, pra, nën varësinë e komandantëve të zonave.

8 PY. A e dini si erdhën komandantët e zonave në atë takim?

9 PË. Jo.

10 PY. A e mbani mend si ishin veshur?

11 PË. Po mund ta shihni që janë me veshje ushtarake. Më
12 kujtohet era, vinin era luftë. Më ka bërë shumë përshtypje,
13 era barut, era tym. Është diçka, një nga gjërat që më ka lënë
14 mbresa, moment shumë mbresëlënës për mua.

15 PY. A mund të na thoni cilat kanë qenë pikat kryesore të atij
16 takimi?

17 PË. Po. Nuk ishte e papritur që ata bënë shumë pyetje të
18 hollësishme. Ranë dakord për pika të përgjithshme. Nga
19 pikëpamja ushtarake ka qenë shumë konstruktiv, frutdhënës si
20 takim. Kahu politik, më duket se është z. Haliti atje, apo një
21 nga të pandehurit këtu mbase, ishin shumë të vështirë.

22 Përpiqeshin të kërkonin formulime që e bënin të qartë që të
23 njihej qeveria e përkohshme dhe u përpoqëm që të mos e
24 prananim këtë. Pra, takimi pati një sukses të pjesshëm, teksti
25 mbeti pak a shumë siç e kisha hartuar unë, i shtuam disa

1 hollësi.

2 Takimi në vetvete ishte frutdhënës. Por qëndrimi i tyre
3 në përgjithësi ose do ta them ndryshe, hezitonin shumë se ata
4 thonin, "ne kemi fituar luftën dhe duam që të çarmatosim me
5 nder nëse do çarmatosemi ta bëjmë siç duhet".

6 Kishte një ndjenjë të fortë prej tyre, kjo do të ishte e
7 vështirë edhe ata e konsideronin veten luftëtarë të suksesshëm
8 dhe deshën të mbronin nderin e tyre përpara syve të popullit
9 të tyre.

10 PY. Përmendët Ramush Haradinaj thatë që ishte aty. Si ishte
11 veshur ai?

12 PË. Ramushi është karakter i veçantë. Ishte si në filmat e
13 Rambos. Dhe mbaj mend që kishte një emblemë në krah, të binte
14 në sy si personazh. Fliste goxha, i dëgjohej zëri shpesh.

15 PY. Si e kuptuat ju UÇK-në në përgjithësi për mënyrën se si
16 ishte organizuar dhe hierarkia e saj bazuar në këtë takim?

17 PË. Thjesht përforcoi më shumë atë që më kishte thënë
18 Gjenerali Çeku, që këta janë aktorët kryesorë dhe duhen
19 përfshirë me doemos në negociata. Ju e patë që ne me përkthim,
20 se kishim probleme me gjuhën se shumë pak flisnin anglisht.

21 Haradinaj fliste pak anglisht, por shumica nuk flisnin.

22 Sidoqoftë ishte shumë e qartë që me këta persona duhet të
23 flisnim ne.

24 PY. A pati diskutime lidhur me atë çka u bë paragrafit 25 i
25 marrëveshjes angazhuese?

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 55

1 PË. Kahu politik u përpoq të ndikonte, ishte pikërisht ajo
2 deklarata ku thuhej që UÇK-ja apo udhëheqja politike kishte
3 kërkuar të njëjtën gjë në të shkuarën.

4 PY. Kush ka qenë nga ana politike në atë takim?

5 PË. Besoj se një prej të pandehurve.

6 PY. Cili i pandehur?

7 PË. Ju lutem, më thoni emrat e të pandehurve sepse unë nuk
8 arrij të lexoj jam disleksik. Të pandehurit këtu janë Thaçi,
9 Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

10 PË. Pikë me vend kjo. Do më duhet të rifreskoj kujtesën se
11 nuk mbaj mend emra.

12 PY. Në rregull. Në qoftë se nuk ju kujtohet kush ka qenë.

13 PË. Ka qenë një person që ka bërë të gjitha këto deklaratat
14 politike në emër të UÇK-së. Zakonisht dikur këtë e bënte
15 Krasniqi. Mbase z. Krasniqi ka qenë atëherë.

16 PY. Vazhdojmë të shohim më tej videon. Pastaj do t'ju bëj
17 pyetje. Ju lutem shiheni me vëmendje dhe më pas do t'ju bëj
18 pyetje.

19 [Luhet videoincizimi]

20 [Njerëz që flasin njëkohësisht]

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ndaloni këtu.

22 PY. Data ishte para, në fillim ishte 17, data ishte e saktë,
23 17 qershor 1999?

24 PË. Po.

25 PY. Çfarë pamë në këtë video?

1 PË. Kjo ishte një pjesë shumë e rëndësishme e negociatave.
2 Siç ndodhin zakonisht negociatat në Ballkan, është momenti kur
3 njerëzit thyejnë bukën, ndajnë bukën. UÇK-ja na ofroi darkë në
4 një tendë në mes të pyllit - vërtetë në mes të pyllit, nuk po
5 e ekzagjeroj - u ulëm të gjithë bashkë edhe aty përfunduar
6 negociatat formale, ndamë bukën me njëri-tjetrin. Dhe aty e
7 kuptuam që vërtetë kishim hyrë në negociata dhe deshëm t'i
8 siguronim që ne ishim të besueshëm që NATO nuk do t'i hiqte
9 qafe. Pikërisht NATO ishte aleat i tyre, do t'i ndihmonte të
10 çarmatoseshin me nder dhe me shpresë të gjenin një zgjidhje në
11 të ardhmen.

12 Më kujtohet që dhe mund të kem biseduar unë për disa
13 modele që mund të ndiqnim dhe modelin e *Securite Civile*. I
14 thamë kjo është pjesa informale e negociatave që në fakt është
15 kjo shumë e rëndësishme në kontaktin e Ballkanit.

16 PY. Të njëjtët persona që ishin në darkë ishin dhe në takim?

17 PË. Po, pak a shumë.

18 PY. Më 18 qershor çfarë ndodhi?

19 PË. Po përpiqem ta formuloj siç duhet që ta kujtojme. Nëse më
20 kujtohet siç duhet, ne patëm disa punë. Fillimisht duhet të
21 flisnim me Kombet e Bashkuara t'i informonim çfarë po bënim.
22 Dhe më pas, në fakt, patëm dhe një problem. Fillimisht flas
23 për Kombet e Bashkuara.

24 Informuam Gjeneralin Jackson i cili më pas nga ana e tij
25 informoi Sergio De Mello, i shpjeguam çfarë po bënim, ku

1 ishim, deri ku kishim arritur, si ishin shanset për të qenë të
2 suksesshëm. Dhe ata kërkuan edhe më shumë, ne ju thamë s'është
3 e mundur. Ata donin që të kishte një zonë ku s'do të kishte
4 fare armë në Kosovë. Ne ju përgjigjëm ju thamë, "kjo shoqëri
5 shqiptare në kontekstin e Ballkanit, hiqeni nga mendja. Kjo
6 nuk ndodh. Nuk është realiste kjo, kërkoni një zonë që të mos
7 ketë fare asnjë lloj arme". U treguam se çfarë kishim bërë dhe
8 deri ku kishim shkuar me negociatat.

9 Pastaj patëm një problem sepse pati një diskutim paralel
10 nga ana e SHBA-së, që ne u përpoqëm ta zbehnim, ta zbutnim.
11 Dhe këtu lidhje kishte lidhje me z. Jamie Rubin, por nuk dua
12 të hyj shumë në thellësi sepse nuk jam në dijeni. Dhe i
13 kërkuam atij të vinte të bëhej palë me ne të nesërme, të
14 komunikonte me ne të nesërmen.

15 PY. Dini ndonjë gjë lidhur me këtë problem? A mund të na
16 thoni diçka më shumë, mund t'i shtoni diçka?

17 PË. Është klasike për diplomatët amerikanë të bëjnë gjëra
18 paralelisht. Më falni që po e bëj pak me të qeshur, por unë
19 jam diplomat karriere edhe për mua duhet të ketë bashkëpunim
20 mes agjencive dhe mos të kesh marrëveshje mes agjencive ishte
21 e habitshme dhe zbuluam që një agjenci po punonte në mënyrë
22 paralele. Por kjo nuk është e pazakontë. Nuk u habita unë që
23 po bëheshin negociata paralelisht, të paktën orvatje. Por që
24 ishin shumë hapa pas krahasuar me ne, sepse ne kishim tekstin,
25 kishim marrëveshjen parimisht, kishim projekt marrëveshjen,

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 58

1 Kishim shtuar disa hollësi bazuar në komunikimet me UÇK-në,
2 prandaj u kërkua që të bëheshin palë me ne.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Tavakoli
4 është momenti i pushimit.

5 Kemi një pushim gjysëm ore tani, do të shihemi këtu në
6 orën 11.30.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju faleminderit.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
10 deri në orën 11.30.

11 --- Pauza fillon në orën 10.02

12 --- Seanca rifillon në orën 11.30

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutemi
14 sillni dëshmitarin në sallë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
17 Tavakoli, mund të vazhdoni me pyetjet.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

19 PY. Tani do të kalojmë më 19 qershorin. A ka pasur ndonjë
20 takim atë datë, z. Duncan?

21 PË. Po. Por kam përshtypjen që nuk e përfundua përgjigjen
22 time lidhur me 18 qershorin nëse mund të vazhdoj aty.

23 PY. Po, patjetër.

24 PË. Ka disa tema të tjera që besoj që është në interes të
25 Gjykatës që t'i dijë. Së pari, ne i kërkua z. Robin Cooke që

1 ishte Ministri i Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar
2 që të kontaktonte me z. Thaçi dhe që të pajtohej me
3 marrëveshjen që ishte negociuar në Kosovë.

4 Së dyti, ne kishim një problem madhor që unë, në fakt, e
5 kam cekur në paragrafin 25 të deklaratës. Sikurse e thashë,
6 paragrafi 25 ishte hartuar nga ana e UÇK-së dhe formulimi
7 ishte i tillë që jepte njohje të nënkuptuar të Qeverisë së
8 Përkohshme. Sigurisht që ne i thamë atyre që ky formulim është
9 i papranueshëm dhe nuk pajtoheshim dot me të. Kështu që
10 gjenerali Reith dhe unë e rihartuam paragrafin 25 të
11 marrëveshjes.

12 Në qoftë se doni mund të shfaqni paragrafin 25 dhe unë
13 mund t'ju tregoj se çfarë formulimi ka bërë UÇK-ja dhe çfarë
14 formulimi kemi bërë ne. Domethënë, neve i thamë Sekretarit të
15 Përgjithshëm dhe Gjeneralit Wesley Clark cila ishte situata
16 dhe ata donin që paragrafi 25 të hiqej. Na u desh që t'ju
17 thoshim që: "Opsioni ishte që të kishim një marrëveshje
18 dypalëshe ose të kishim një marrëveshje zotimi ose
19 sipërmarrjeje të njëanshme. Dhe ne mund të thoshim publikisht
20 që, në fakt, kjo mund të ishte një marrëveshje zotimi e
21 njëkahshme nga UÇK-ja dhe në qoftë se donin ata pastaj mund të
22 përdornin të njëjtin formulim të ndryshuar sigurisht". Dhe
23 pastaj ne u pajtuam me formulimin fundor dhe, sigurisht, që
24 ata na mbështetën në këtë qëndrim.

25 Domethënë, këto ishin zhvillime që ndodhën më datë 18 dhe

1 që besoj ishin me interes për të gjithë.

2 PY. Në rregull. Tani le të kalojmë në datën 19. A ka pasur
3 ndonjë takim më datën 19?

4 PË. Po. Serbët ishin larguar prej asaj zone. Kështu që, për
5 rrjedhojë, ishte e mundur që ne të shkonim me fluturim, të
6 fluturonim atje atë ditë. Ne iu bashkuam ekipit të Shteteve të
7 Bashkuara që kishin bërë bisedat e veta me z. Thaçi, z. Rubin
8 na shpjegoi, i shpjegoi këto deklarata dhe këto procese gjatë
9 deklaratës së vet, kështu që ne shkuam si një ekip i
10 përbashkët dhe u shoqëruam nga James Rubin, Shaun Byrnes dhe
11 Larry Rossin, ne fluturuam atë ditë në mëngjes.

12 PY. Sa zgjati takimi?

13 PË. Takimi zgjati gjatë gjithë ditës.

14 PY. Në kohën kut z. Thaçi mbërriti, në çfarë faze ishte
15 marrëveshja angazhuese? Domethënë, sa kishit mbuluar, sa
16 kishit trajtuar deri në atë pikë?

17 PË. Ne kishim trajtuar çështjet logjistike, praktika dhe
18 pjesën dërmuese të asaj dite ne e kemi kaluar me orvatjet e
19 z. Thaçi dhe z. Krasniqi për të përfshirë një formulim politik
20 që në mënyrë të tërthortë ose të nënkuptuar që do i jepte
21 atyre njohje dhe që NATO t'i njihte ata. Pra, më duhet të them
22 që pjesën dërmuese e kemi kaluar duke diskutuar këtë aspekt.

23 PY. Çfarë pikëpamje kishit ju ose NATO për pranimin e këtij
24 qëndrimi të z. Thaçi e z. Krasniqi?

25 PË. Ishte e papranueshme.

1 PY. Pse?

2 PË. Sepse kjo do të cenonte vetë thelbin e marrëveshjes
3 angazhuese të zotimit. Ishte në kundërshtim të tërë me frymën
4 e përgjithshme të marrëveshjes.

5 PY. A ka ndonjë gjë që ju ka mbetur në kujtesën tuaj lidhur
6 me atë takim?

7 PË. Për mua diçka që më ka mbetur në kujtesë, po, ka pasur.
8 Unë i ndërpreva bisedat dhe ngrita dorën. Dhe ju shpjegova që
9 detyra ime ishte që të udhëzoja Gjeneralin Reith, që
10 deklaratën e kisha shkruar unë, që unë isha diplomat dhe që e
11 dija se me çfarë gjëje do të binte dakord apo jo komuniteti
12 ndërkombëtar. Ai e bëri pjesën më të madhe të të folurit, por
13 ne kemi biseduar me njëri-tjetrin. Ne kishim shkëmbyer ide dhe
14 kishim mbërritur në një version të unifikuar të qëndrimit
15 tonë.

16 Situata dukej sikur po dilte jashtë duarsh, jashtë
17 kontrollit. Z. Thaçi dhe këshilltarët e vet politik po
18 ushtronin kaq shumë trysni që të përfshihej një formulim i
19 tillë që për ne ishte i papranueshëm sa që mua mu desh që të
20 ngrihesha dhe ju kërkova komandantëve të zonës që të
21 largoheshin prej dhomë aty ku ishim dhe kërkova një takim të
22 veçantë me z. Thaçi, me Gjeneralin Çeku, James Rubin,
23 Gjeneralin Reith dhe unë vetë. Dhe, për befasinë time, të
24 gjithë u ngritën në këmbë dhe u larguan nga aty ku ishin. Dhe
25 arsyerja për këtë, siç e zbuluam më vonë, ishte që ata më

1 perceptonin mua si komisar politik. Jamie Rubin fliste me një
2 mendësi komuniste. Ndërkohë që unë personalisht isha i veshur
3 vërtetë si një komisar dhe kjo ishte mënyra e perceptimit të
4 tyre për mua, më panë më shumë si një komisar diplomatik. Dhe
5 prandaj u ngritën të gjithë në këmbë dhe u larguan nga aty.

6 Sigurisht që shkaktoi shumë problem që unë e bëra këtë
7 gjë dhe sikurse e patë në video, mendoj, pra, ishte e njëjta
8 mënyrë e të folurit si me z. Haradinaj dhe arsyeja që pse e
9 bëra këtë gjë ishte që nuk është se e dija të gjithë situatën,
10 nuk e dija që gjithsecili kishte të drejtë që të jepte
11 mendimin e vet, që të jepte një propozim të vetin. Unë kisha
12 një grup bazë, një grup bazë dhe pastaj ju thashë atyre që t'i
13 përçonin më tej ato propozime për të cilat ramë dakord me
14 palët e tjera ose për këtë arsye unë ndërhyra.

15 Në këtë ndërhyrje, unë ju thashë troç që, "Ju e keni
16 filluar punën sipas perceptimit të publikut si terroristë. Por
17 ndërkohë jeni rritur me kalimin e kohës. Domethënë, e keni
18 kaluar atë prag. Keni nënshkruar Rambujen, keni derdhur gjak
19 dhe tani ju perceptoheni mundësisht si luftëtarë lirie.
20 Megjithatë nuk jeni shtet, nuk jeni qeveri. Dhe në qoftë se
21 doni që të shkoni atje dhe si pa diskutim që duhet të shkoni
22 atje duhet që këtë marrëveshje angazhuese ose këtë marrëveshje
23 zotimi ta nënshkruani."

24 Z. Thaçi nuk shpreh fare. Nuk tha asgjë. Gjenerali Çeku e
25 mori diagramin që kisha vizatuar unë dhe ua tregoi më vonë

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 63

1 komandantëve të zonës dhe, në fakt, atë doja unë që të bënte
2 ai, që t'ia tregonte këtë diagrame komandantëve të zonës dhe
3 që ata të bindeshin që të nënshkruhej marrëveshja.

4 PY. Si e kuptuat ju faktin që Çeku e mori diagramin dhe ua
5 tregoi komandantëve, çfarë shenje ishte kjo?

6 PË. Këtë e kuptova që duhej që të merrte miratimin e tyre.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares të
8 paraqesë të njëjtën video po në një tjetër minutazh. Është
9 materiali 1D00287. Të fillojmë nga fillimi, domethënë, do ju
10 kërkoja që të paraqisni videon nga minuta 00:21 ose ndoshta
11 nga fillimi fare dhe do ju kërkoja që të përfundonit në
12 sekondën 00:42.

13 [Luhet videoincizimi]

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ndaloni këtu ju lutem.

15 PY. A mund të na shpjegoni se çfarë shpjegohet në këtë video?

16 Së pari na tregoni nëse data është e saktë këtu?

17 PË. Jo.

18 PY. Cila do të jetë data?

19 PË. Data duhet të jetë më datë 19.

20 PY. Pse mendoni këtë gjë?

21 PË. Sepse kjo ka qenë publike.

22 PY. Çfarë tregon kjo video?

23 PË. Kjo video tregon ekzaktësisht atë që unë fillova t'ju
24 thoja para pak minutash. Pasi u filluan negociatat, unë dola
25 jashtë dhe e pashë që Ramush Haradinaj ishte shumë i irrituar

1 me çfarë kisha thënë unë në takim. Pra, personi që doli po i
2 shpjegonte, e kuptoj përmes gjuhës trupore, gjesteve të veta,
3 që po u shpjegonte se çfarë kishte ndodhur dhe besoj se ai po
4 i shpjegonte se duhet të pajtoheshin me këtë zgjidhje sepse
5 kjo ishte në interes të tyre. Pra, mendoj që ky është mesazhi
6 që është dhënë që ishte shumë e rëndësishme që ata të
7 pajtoheshin me këtë marrëveshje.

8 PY. Çfarë kishte veshur ai?

9 PË. Ai kush?

10 PY. Ramush Haradinaj.

11 PË. Sikurse mund ta shikoni ka nxjerrë një thikë dhe e ka
12 thikën këtu përpara në kraharor, ndonjë granatë nuk shoh, po
13 mund ta shihni dhe vetë se çfarë kishte veshur.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do ju kërkoja që të vazhdoni më
15 tej në video. Të vazhdojmë më sekondën e 00:39 dhe në vijim ku
16 jepet një fragment ku po flet z. Duncan.

17 PY. Cili ishte rezultati i takimit në datën 19?

18 PË. Teksti, pra, formulimi i tekstit ishte diçka që u pajtuan
19 palët dhe ishte në versionin thuajse përfundimtar deri në fund
20 të datës 19. Këtë tekst më pas ia dërguam NATO-s në mënyrë të
21 tillë që të merrte miratimin e Këshillit të Atlantikut Verior.
22 Megjithëse bëhej fjalë për një marrëveshje angazhuese e
23 njëanshme, pavarësisht kësaj, duhej që të merrte miratimin e
24 NATO-s, pra, nuk mund të ishim përpara një situate kut të
25 miratohej marrëveshja nga UÇK-ja dhe pastaj dikush, një aleat

1 i NATO-s të thoshte kjo është e papranueshme.

2 PY. A ju kujtohet se kur e keni dërguar këtë material?

3 PË. Mbase mbrëmjen e së njëjtës ditë.

4 PY. A e morët miratimin?

5 PË. Po, eventualisht e morëm. Kishte shumë diskutime lidhur
6 me bllokun e nënshkrimeve në fund të marrëveshjes dhe ky ishte
7 një ndër pengesat kryesore të fundit. Unë personalisht nuk kam
8 qenë aty.

9 PY. A mund të na e shpjegosh pak për cilën pjesë të
10 nënshkrimit e keni fjalën?

11 PË. E kam fjalën për nënshkrimet në fund të dokumentit ku
12 thuhet "Pranuar nga Gjenerali Jackson", pra, Gjenerali i
13 COMKFOR-it.

14 PY. Mund të vazhdoni më tej.

15 PË. U dha miratimi nga NATO dhe u ndryshua formulimi,
16 domethënë, "U morr nga" dhe jo u pranua nga. Dhe ky ndryshim
17 më pas iu prezantua palës së UÇK-së më datë 20, të nesërmen
18 dhe të nesërmen pati diskutime të tjera të mëtejshme për të
19 diskutuar se pse ishte bërë ndryshimi.

20 PY. A ju kujtohen në qoftë se qeveritë e tjera të ndryshme
21 kanë diskutuar lidhur me ndryshimin e formulimit tek blloku i
22 nënshkrimeve në fund të marrëveshjes?

23 PË. Jo, në hollësi. Unë kam qenë pjesë e raportit dhe po
24 merrnim raporte në fakt nga Londra që kishte pasur shumë
25 kundërshti dhe që amerikanët kishin përdorur shumë presion për

1 të siguruar që të gjithë aleatët e NATO-s pajtoheshin me këtë
2 formulim. Për shembull, shtete të tilla si Greqia do ishin
3 veçanërisht të shqetësuar se çfarë do të ndodhte, se çfarë do
4 të bënim ne në atë vend që ishte në kufi, megjithatë kishte të
5 tjerë të cilët sipas mendimit të tyre ne po negocionim me
6 persona që ishin terrorist e ne nuk duhet të negocionim me
7 terroristë. Dhe ishin që shqetësuar lidhur me të ardhmen, pra,
8 çfarë do të ndodhte në të ardhmen. Ne përfundam në mënyrë të
9 suksesshme një fushatë ushtarake, po pastaj nuk e dinim se
10 cili do ishte rezultati. Domethënë, do kishim të bënim me një
11 shtet, do kishim të bënim me një mandat të Kombeve të
12 Bashkuara mbi territorin, pra, pavarësisht përfundimit të
13 marrëveshjes ushtarake nuk ishte e qartë se çfarë do të
14 ndodhte.

15 PY. Kur është nënshkruar marrëveshja?

16 PË. Është nënshkruar dhjetë minuta pas mesnatës së datës 20.
17 Domethënë më datë 21, orët të para të datës 21.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do ju lutesha që të paraqisni
19 në ekran një dokument P1104, le të shikojmë dokumentin në
20 faqen e parë një herë. Të kalojmë në faqen e fundit. Vazhdojmë
21 më poshtë. Pak më poshtë. Shikojmë këtë pjesën e nënshkrimeve
22 në fund të marrëveshjes.

23 PY. Mund të na e shpjegoni, Dëshmitar, se çfarë shikoni këtu?

24 PË. Kjo është faqja e fundit e marrëveshjes angazhuese.

25 PY. Dëshiroj që të përqendrohemi tek pjesa e UÇK-së,

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 67

1 domethënë, tek pjesa e nënshkrimit nga ana e UÇK-së. A mund të
2 na e shpjegoni a ka pasur një pjesë të nënshkrimeve në draftin
3 e parë?

4 PË. Jo.

5 PY. Çfarë date mbante drafti i parë ose versioni i parë i
6 marrëveshjes angazhuese?

7 PË. Versioni i parë që kam hartuar unë ka qenë më datë 10
8 qershor.

9 PY. A mund të na e shpjegoni se pse nuk ka pas një vend ku
10 viheshin nënshkrimet tek propozimi i parë i
11 projekt marrëveshjes?

12 PË. Sepse isha i shqetësuar se në qoftë se do vendosja atë
13 pjesën e nënshkrimit në fund mund të na shpërqendronte nga
14 qëllimi kryesor i dokumentit, do na hiqte vëmendjen nga thelbi
15 i dokumentit, kështu që kur ju thamë versionin e parë të
16 dokumentit, kur ia dhamë Gjenerali Çeku, nuk e kishte këtë
17 pjesë sepse unë nuk doja që ai të përqendrohej tek pjesa se
18 kush do e nënshkruante dokumentin po se çfarë thoshte, cila
19 ishte përmbajtja kryesore e dokumentit.

20 PY. Kur e keni prezantuar këtë bllok nënshkrimesh për herë të
21 parë?

22 PË. Mendoj më 18 ose 19 qershor.

23 PY. Çfarë rëndësie kishte dhe fillimisht kush mendohej që ta
24 kishte nënshkruar atë?

25 PË. Fillimisht ideja ishte që të nënshkruhej nga Gjenerali

1 Çeku në emër të UÇK-së.

2 PY. Dhe pse e përfshitë z. Çeku?

3 PË. Për arsye praktike se ky ishte personi me të cilin u
4 angazhuam fillimisht ne për nënshkrimin e marrëveshjes. Më
5 datë 17 apo 18 z. Thaçi nuk ishte drejtpërdrejt për negociata
6 për marrëveshjen angazhuese, neve na ishte thënë se ai nuk
7 ishte i disponuehëm. Dhe për këtë arsye ne fillimisht vendosëm
8 emrin e gjeneralit Çeku.

9 PY. Shohim në dokumentin që kemi përpara që në bllokun e
10 nënshkrimeve emri është i Hashim Thaçit dhe jepet një titull
11 aty dhe pastaj nënshkrimi. Do i kalojmë njëra-pas tjetrës. A
12 mund të na e shpjegoni sesi përfundoi emri i Hashim Thaçit në
13 këtë dokument?

14 PË. Mesa më kujtohet, ndryshimi u bë gjatë bisedave ose
15 diskutimeve të datës 19.

16 PY. Kush e propozoi këtë ndryshim?

17 PË. Nuk më kujtohet, ishte një ditë shumë e gjatë, shumë e
18 tensionuar. Unë nuk lejova askënd që të hante drekë dhe atë
19 ditë kishte shumë zhvillime, vërtetë kishte shumë biseda dhe
20 debate kështu që nuk më kujtohet se kush e ka ndryshuar emrin.

21 PY. A e dini arsyen se pse ka ndryshuar emri?

22 PË. Jo. Jo, ka ardhur nga ana e UÇK-së, domethënë, di që
23 është propozim nga UÇK-ja për të nënshkruar dokumentin Hashim
24 Thaçi.

25 PY. Komiteti ndërkombëtar, në veçanti Shtetet e Bashkuara të

1 Amerikës, a kishin ndonjë mendim ose ndonjë opinion se kush
2 duhet të nënshkruante nga ana e UÇK-së?

3 PË. Jo, jo, nuk funksiononte kështu tamam. Ne e kemi bërë
4 punën dhe pastaj propozimi i është dërguar atyre. Nuk është
5 puna se ata na kanë dhënë udhëzime, po ne e kemi bërë punën
6 dhe ju kemi dhënë atyre propozimet përkatëse. Për shembull,
7 unë kam qenë personi i parë që e kam hartuar këtë dokument dhe
8 ju kam dhënë pastaj versionin që ju kam hartuar unë. Nuk është
9 se më ka thënë mua Londra, për shembull, se çfarë duhet të
10 shkruash ti në atë dokument. Ajo ça kam bërë unë është që jam
11 ulur, e kam shkruar dokumentin dhe ia kam dhënë propozimin
12 Londrës. Domethënë, me fjalë të tjera po përpiqem të them që
13 nuk kemi marrë udhëzime, në atë nivel detajesh pa diskutim që
14 s'kemi marrë udhëzime.

15 PY. A e kishit problem ju që dokumenti do nënshkruhej nga
16 Thaçi?

17 PË. Jo.

18 PY. Po pse jo?

19 PË. Ajo çfarë ishte e rëndësishme për mua ishte që të
20 siguronim angazhimin ose përfshirjen e plotë të palës
21 kosovare, në veçanti të krahut ushtarak. Në qoftë se ata donin
22 që dokumenti të nënshkruhej prej Hashim Thaçit nuk është se
23 kishte problem për ne, sepse kjo nuk funksiononte në këtë
24 mënyrë. Në kuptimin që i gjithë procesi ishte që të siguronim
25 angazhimin ose përfshirjen e tyre sepse i kuptonim se çfarë

1 motivimesh kishte, çfarë dëshironin ata në aspektin afatgjatë.
2 Por pasi ata të angazhoheshin, të përfshiheshin, atëherë duke
3 marrë parasysh natyrën e tyre, duke marrë parasysh nderin dhe
4 besën e shqiptarëve dhe faktin që ata do angazhoheshin për ta
5 zbatuar atë dhe duke pas parasysh që komandantët e zonës do të
6 përfshiheshin që prej fillimi, ata do të ndiheshin të detyruar
7 që të respektonin formulimin e marrëveshjes, por jo vetëm kaq
8 po edhe do fitonin diçka prej saj.

9 Ata e kuptonin që ata gradualisht do njiheshin. Dhe do
10 përfshiheshin me organizata të fuqishme ndërkombëtare,
11 përfshirë këtu NATO-n. Mbi të gjitha dhe që ekzistonte
12 mundësia e diçkaje që mund të çonte në pavarësinë e tyre në
13 afat të gjatë.

14 Kështu që duke i kuptuar motivimet e tyre, duke i kuptuar
15 synimet e tyre që janë të mishëruara në këtë dokument, në
16 kuptimin tim, nuk ishte fare e rëndësishëm se kush e
17 nënshkruante dokumentin. Sepse procesi në vetvete ishte një
18 moment kyç, shumë i rëndësishëm që do ta çonte më tej
19 situatën.

20 PY. Ju përmendët përemrin "ata" për kërkohet e keni fjalën kur
21 thoni ata?

22 PË. E kam fjalën për aspektin ushtarak ose për krahun
23 ushtarak.

24 PY. A e dini kush e dha këtë mendimin për komandant kryesor,
25 kryekomandant i UÇK-së?

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 71

1 PË. Jo.

2 PY. Po ju vetë a e përdorni këtë formulim ose këtë emërtim?

3 PË. Unë nuk e di kush e ka dhënë këtë si propozim e për
4 rrjedhojë nuk ju jap dot një përgjigje të plotë. Mund t'ju jap
5 gjithsesi përshtypjen time çfarë kam menduar unë në atë kohë.
6 Sipas mendimit tim, bëhej fjalë për një titull grandioz, të
7 zmadhuar, të madh. Dhe nga përvoja ime personale, më kujtohet
8 që në lëvizjet revolucionare afrikane, që kanë ndodhur në një
9 vend ku unë jam rritur, për shembull, guerilëve ju dhanë emra
10 të tilla si, për shembull, "Gjeneral". Edhe në Francë madje,
11 ku kam jetuar për disa vite, liderët e rezistencës, pra, mund
12 të thonin që "Ky është batalioni X, Y", por në fakt nuk bëhej
13 fjalë fare për një batalion. Flitej vetëm për 300 vetë pak a
14 shumë.

15 Domethënë, ekzistonte tendenca për zmadhimin, për
16 ekzagjerimin e titujve. Kështu që kjo është diçka që nuk e
17 mora fare seriozisht dhe nuk më befasoi fare. Nuk e di në
18 qoftë se mbase ka ardhur nga modeli amerikan, që presidenti ka
19 titullin komandant kryesor, por sigurisht që në realitet
20 situata është tërësisht e ndryshme. Domethënë, sipas meje,
21 ishte thjesht një ekzagjerim, një zmadhim, një titull grandioz
22 me emër të madh që i jepej dikujt që nuk përkonte me
23 realitetin.

24 PY. Dua t'i rifreskoj kujtesën, z. Duncan, dhe dua t'ju
25 tregoj paragrafin 60 të deklaratës së tij që flet lidhur me

1 këtë çështje. Në qoftë se doni mund t'ua lexoj dhe unë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do ta lexoj me gojë.

4 PY. A mendoni ju që Hashim Thaçi mund të kishte nënshkruar si
5 kryeministër?

6 PË. Jo.

7 PY. Pse?

8 PË. Sepse kjo do nënkuptonte automatikisht njohjen e Qeverisë
9 së Përkohshme të Kosovës.

10 PY. A mendoni ju që nënshkrimi prej tij si kryekomandant
11 ishte i lidhur me këtë gjë, me këtë pikë, me këtë aspekt?

12 PË. Mendoj që kjo ishte më e përshtatshme për NATO-n duke
13 qenë se ishte emri i tij në fund. Në qoftë se UÇK-ja do
14 pajtohej me faktin që emri i tij të ishte në fund duke i
15 vendosur një emër ushtarak do ishte një gjë më e pranueshme
16 nga aleatët e NATO-s. Jam i sigurtë, që siç edhe unë nuk është
17 se i kanë kushtuar ndonjë rëndësi të madhe shkrimit ekzakt të
18 titullit. Por megjithatë kjo kishte të bënte me një
19 marrëveshje ndërmjet dy kaheve të ndryshme por që në fund të
20 fundit ishin kahe ose krahë ushtarakë.

21 PY. A mendoni ju se në realitet Hashim Thaçi ishte
22 kryekomandant i UÇK-së ose komandant i përgjithshëm i UÇK-së?

23 PË. Jo, se nuk kam parë asnjë dëshmi, asnjë provë të kësaj
24 gjëje

25 PY. Po në qoftë se do të kishte qenë në një pozicion të

1 tillë, çfarë provash do kishit parë ju? Mbase pyetja me vend
2 që duhet të bëja është që kush është një person, çfarë
3 detyrash ka një person që është komandant i përgjithshëm?
4 PË. Pyetje me vend. Përkufizimet janë dhënë në fakt por nuk
5 janë përkufizime të cilat njihen ose pranohen kaq mirë nga ne,
6 nga persona si puna ime. Atëherë komandanti i përgjithshëm
7 lidhet kryesisht me komandimin dhe kontrollimin. Komandimi ka
8 të bëjë me të drejtën e lëshimit të urdhrave, udhëzimeve,
9 direktivave. Ndërkohë që kontrollimi në vetvete ka aftësinë
10 për ta kryer këtë komandim dhe për t'u siguruar që urdhrat e
11 dhëna ose udhëzimet e dhëna realizohen në mënyrë efektive.

12 Pra, me fjalë të tjera ky është një lloj autoriteti ose
13 një lloj kompetence politike që nuk të jep kompetenca
14 absolute. Për shembull, problemi që kishte Gjenerali Jackson
15 kur sulmuan rusët ishte ekzaktësisht ky, domethënë, ai mori
16 një komandë por Wesley Clarck, Gjenerali Wesley Clarck nuk
17 ishte kontroll mbi këtë komandë. Domethënë, ky është një
18 aspekt ose problem konceptual që shqetëson organizatat
19 ushtarake ose *think tanks* ushtarake gjatë gjithë kohës.

20 Domethënë, komandanti i përgjithshëm duhet të ishte i
21 shqetësuar me realizimin e udhëzimeve, direktivave, urdhrave
22 të dhëna, domethënë, ishte aspekti i dykahshëm i udhëzimit ose
23 urdhërimit dhe i kontrollimit.

24 PY. Pse thatë ju përpara një çasti se Hashim Thaçi nuk ishte
25 komandant i përgjithshëm i UÇK-së ose kryekomandant i UÇK-së?

1 PË. Sepse mënyra se si silleshin ata me të gjatë negociatave
2 ishte e tillë, që ata e trajtonin atë si krahun politik, siç
3 prisja unë që, domethënë, kishte një lloj ndikimi, një lloj
4 autoriteti por jo si dikë për të cilin kishin respekt
5 ushtarak. Ishte shumë e dukshme kjo. Domethënë, ata e
6 respektonin Gjeneralin Çeku sepse ai ishte oficer ushtarak në
7 profesion. Familja e tij kishte vuajtur në duart e serbëve,
8 kishte vuajtur rëndë do thosha dhe atë e shihnin si
9 profesionist, si ushtarak profesionist.

10 Kur mbërriti Hashim Thaçi kishte një lloj tensioni
11 sikurse ndodh zakonisht ose të paktën siç kam parë unë
12 zakonisht në atë kohë. Atëherë ky është një tension tipik që
13 ndodh kur mbërrin një person që është politikan edhe kur në
14 biseda janë të përfshirë edhe oficerë ushtarak. Domethënë, unë
15 mendoj që ata e kanë parë z. Thaçi si një politikan të
16 rëndësishëm për kauzën e tyre por nuk e kanë parë si komandant
17 ushtarak dhe kjo është përshtypja ime lidhur me sjelljen që
18 ata kishin ndaj z. Thaçi.

19 PY. A mund të japësh ndonjë shembull si mund ta thuash
20 ndryshe, ta ilustrosh?

21 PË. Është një ndjesi, është mënyra se si kuptohen, mënyra
22 ishte interesant si isha veshur si komisar politik dhe kjo
23 ishte me qëllim të caktuar, me qëllim tamam si etos i
24 ushtrisë. Ndërsa z. Thaçi vinte i veshur me një kostum në tip
25 si tipik perëndimorëve. Dhe dukej sikur kishte një përplasje

1 të menjëhershme me këtë grup njerëzish.

2 PY. A t'u duk se kishte autoritet mbi komandantët e zonave?

3 PË. Asnjëherë nuk e kam parë që të jepte direktiva apo
4 urdhra. Ishte qartë që kishim të bënim me dy lloj njerëzish. E
5 para kishim të bënim ushtarakun apo oficerin e nivelit të
6 lartë dhe e dyta ishte politikani. Kjo ishte përshtypja që më
7 është krijuar mua.

8 PY. Këto ndryshime në pjesën e firmës që u bënë nga ana e
9 UÇK-së, a ishte i pranishëm Gjenerali Mike Jackson apo jo?

10 PË. Jo.

11 PY. Na ke treguar tashmë se si e ke kuptuar ti funksionimin e
12 hierarkisë së UÇK-së. Po përpara syve të botës si e paraqiste
13 veten UÇK-ja?

14 PË. Ata janë përpjekur mjaft që të na tregonin që ishin
15 partner serioz nga pikëpamja ushtarake. Kështu që kur arritëm
16 në datën 17 në errësirë të plotë kishte një gardh nderi të
17 veshur me uniforma të reja, me kallashnikovë që i kishin në
18 gjoks, me bereta dhe duke na dhënë në një farë mënyre
19 përshëndetjen ushtarake ndaj një delegacioni ushtarak. Pra,
20 ishin si të thuash të gatshëm që ta tregonin veten sikur nuk
21 ishin thjesht gueriles atje në mes të pyllit.

22 PY. A ishte kjo e qartë?

23 PË. Është shumë kollaj që të gjesh uniforma për gjashtë
24 persona dhe t'i japësh beretat, kështu që nuk mund të them se
25 sa e nevojshme ishte dhe të bëhej një gjë e tillë.

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund të shohim një fotografi
2 ju lutem që ka numrin e provës DHT05354.

3 PY. Z. Duncan, çfarë paraqitet në këtë fotografi.

4 PË. Kjo është dhe garda e nderit më datën 19.

5 PY. A kanë pasur të njëjtën gjë edhe në ditët e tjera?

6 PË. Po dhe më 17.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
8 kërkoj që ta pranoni si provë materiale?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
10 kundërshtim?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk ka.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT me numër
13 rendor 05354, pranohet. Jepini një numër prove.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po
15 i japin numrin e provës 1D384 dhe është konfidenciale.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund të jetë publike.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të
18 riklasifikohet.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Atëherë a mund të vendosim në
20 ekran DHT05355.

21 PY. Z. Duncan, po kjo fotografi çfarë është?

22 PË. Ky është z. Thaçi siç ishte veshur më datën 19.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund ta pranojmë si provë
24 material?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 77

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet si
2 provë materiale. Jepini një numër.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i japin numrin e
4 provës 1D384. E shoh që është e klasifikuar si konfidenciale.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të
6 klasifikohet si publike.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran
8 DHT05356.

9 [Nuk ka përkthim].

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të
11 riklasifikohet si publike.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

13 PY. Thatë më herët që ata ishin të gatshëm ta paraqisnin
14 veten si persona profesionistë dhe jo guerrilas në pyll?

15 PË. Po.

16 PY. Sa profesionistë ishin ata sipas teje?

17 PË. Si e ke, çfarë nënkupton me "si profesionistë"?

18 PY. Ju thatë që është kollaj kur patë fotografinë e gardës së
19 nderit që ishte kollaj që të paraqisje veten me një
20 kallashnikov e kështu me radhë. A ishte kjo fotografi që
21 reflektonte realitetin në fakt?

22 PË. Jo domosdoshmërisht. Nga përvoja e vizitave në vendet e
23 tjera mund të pritesh nga një gardë e veshur mirë ndërkohë që
24 ushtria është copë-copë dhe nuk ka nevojë që të përmend emrat
25 e vendeve për të mos iu shkaktuar atyre vështirësi. Por jo,

1 kjo nuk ë shprehje e një strukture të mirë organizative. Nga
2 përvoja ime dhe nga informacionet nga burime të ndryshme në
3 terren, siç mund të pritej, kjo ishte një ushtri guerilase
4 shumë kaotike siç pritej të ishte në fakt. Dhe që në fakt
5 ishte e çorganizuar por në fakt po organizohej gjithnjë e më
6 mirë. Ata ishin ushtri guerilase dhe jo ushtri e rregullt, në
7 asnjë farë mënyre. Dhe prandaj ekzistonin dhe tituj që duken
8 sikur janë tejet të zmadhuar, grandiozi.

9 PY. Përveç UÇK-së, a ka thënë ndokush tjetër që kishim të
10 bënim me një ushtri të organizuar?

11 PË. Serbët.

12 PY. A mund të na thuash më tepër çfarë kanë bërë serbët?

13 PË. Propaganda serbe, siç e kam kuptuar unë, sipas
14 informatave që kam marrë, ata filluan që t'i konsiderojnë si
15 terroristë dhe më pas t'i shohin si një kanosje reale si një
16 ushtri e rregullt, të disiplinuar, me hierarki dhe që
17 funksionon si një ushtri e rregullt. Pjesërisht ndoshta këta e
18 kanë thënë edhe për të justifikuar mungesën e suksesit ndaj
19 UÇK-së, pasi UÇK-ja vërtetë ka pësuar shumë disfata gjatë
20 konfliktit, por në fakt ato rishfaqeshin me numër më të madh
21 njerëzish që u bashkoheshin dhe me ushtri, me pjesëmarrës të
22 APJ-së si Gjenerali Çeku të ciët kanë sjellë një farë
23 profesionalizmi në këtë organizatë.

24 PY. Çfarë përshtypje ke krijuar nga Hashim Thaçi gjatë kohës
25 së negociatave?

1 PË. Në fakt që të mos e ofendoj, do të them që mu duk si një
2 enigmë. Unë kisha bërë, kisha marrë pjesë me gjeneralin Clark
3 kur i kishim dhënë atij informacion më herët dhe më dukej
4 sikur nuk ishte shumë i angazhuar siç pres unë të jetë një
5 politikan profesionist. Gjatë diskutimeve ai më dukej se
6 përqendrohej më shumë në çështje që kishin të bënin si, për
7 shembull, me telefonatën e Clinton dhe më dukej sikur nuk e
8 vlerësonte aq faktin që ky angazhim, si të thuash, do ta
9 ndalonte krijimin e një force policore, një force të
10 inteligjencës apo të zbulimit. Politikanët në Ballkan
11 pikërisht shfrytëzojnë këto organizata si pjesë e bazës së
12 tyre të pushtetit. Pasi mund ta shfrytëzojnë. Dhe më dukej
13 sikur ai nuk e vlerësonte një gjë të tillë, pasi duhet të
14 mbante të qarta policia do të punonte si polici, UÇK-ja do të
15 çarmatosej, do të demobilizohej, ndërsa ai do të ishte i
16 veçuar si të thuash. Dhe kjo do të ishte në fakt që duhet ta
17 shqetësonte atë, pasi ky ishte rezultati i këtij angazhimi që
18 do të ndërmernte.

19 Dhe m'u duk sikur nuk e kuptonte si duhej situatën dhe u
20 çudita.

21 PY. Thatë që ai ishte i fokusuar në çështje që kishin të
22 bënin me telefonatën me Clinton?

23 PË. Po.

24 PY. Çfarë nënkuptove nga ajo, që ai ishte i interesuar në
25 telefonatën e Clinton?

1 PË. U çudita. Dhe kështu na siguroi marrëveshjen James Rubin.
2 Ata dolën, kur u ndërpre në bisedat, ata dolën, patën diskutime
3 të veçanta. James Rubin me z. Thaçi dhe Gjenerali Reith me
4 Gjeneralin Çeku me qëllim që të binin dakord për disa prej
5 hollësive të kësaj marrëveshjeje angazhuese.

6 Dhe mua mu duk e çuditshme që ai përqendrohej gjithmonë
7 në këtë çështje, siç më tha James më vonë, pra, në çështjen e
8 telefonatës me Clinton. Shumë më vonë e kuptova se kjo mund të
9 kishte qenë mënyra se si një politikan kosovar mund të thoshte
10 "Unë jam në gjendje që të flas me Shtetet e Bashkuara të
11 Amerikës". Dhe kosovarët e kanë kuptuar këtë se kjo do ishte
12 më shumë me vlerë për karrierën e ardhshme politike.

13 PY. Përse?

14 PË. Për të thënë që "Kam folur me Presidentin Clinton dhe, ai
15 tha, që po bëni punë shumë të mirë. Vazhdoni punën" apo çfarë,
16 si të donte ta paraqisje këtë telefonatë që kishte pasur me
17 Presidentin Clinton. Pra, do të kishte vlerë politike për të.

18 PY. Pra, mbështetja e amerikanëve ishte e rëndësishme për
19 Hashim Thaçi apo jo?

20 PË. Ishte e qartë. Ai ka pasur diskutime me James dhe me
21 Madeleine Albright dhe sigurisht që ai i shihte amerikanët si
22 lojtarë kyç dhe nuk ishte krejtësisht gabim. Madeleine
23 Albright, James Rubin dhe Gjenerali Clark ishin si të thuash
24 edhe pala kyçe në të gjithë këtë fushatë dhe në mënyrën sesi
25 evoluoi më tej konflikti.

1 PY. Faleminderit. A mund të shpjegoni se çfarë marrëdhëniesh
2 kishte Hashim Thaçi me Gjeneralin Çeku nga ajo sa ishin në
3 gjendje të shihnit ju?

4 PË. Si pjesëtarë të një ekipi dhe kështu e paraqisnin veten
5 para nesh dhe mënyrën se si silleshin njëri me tjetrin. Unë
6 merrem me çështjen ushtarake, unë merrem me çështjen politike
7 dhe ne të dy po bëjmë punë të ndryshme. Pra, si një ekip, si
8 një përpjekje brenda një ekipi. Kjo është mënyra se si e kam
9 parë edhe unë.

10 A kishte ndonjë respekt aty brenda në këtë? Nuk kam parë
11 ndonjë lloj respekti të madh të treguar, ishte thjesht se
12 secili kishin përgjegjësitë e veta. Kështu të paktën e kam
13 perceptuar unë.

14 PY. Dua t'ju lexoj atë që ka thënë Gjenerali Mike Jackson.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe referenca për Trupin
16 Gjykues është P1257, paragrafi 16 deri në 31

17 PY. Gjenerali Mike Jackson tha:

18 "Thaçi e nënshkroi këtë angazhim më datën 21 qershor në
19 vend të Çekut pasi ishte bosi, ishte 'komandanti i
20 përgjithshëm.'

21 "Për shkak se Thaçi ishte komandanti i UÇK-së, në qoftë
22 se kjo do të ishte nënshkruar nga Çeku, Thaçi do të kishte
23 pasur mundësi manovrimi më vonë.

24 "Thaçi kishte autoritet mbi Çekun. Kjo ishte pranuar. Unë
25 nuk e pashë këtë që të kishte ndonjë ndryshim që Thaçi ishte

1 më i lartë në nivel sesa Çeku. Dhe nuk kishte asnjë dyshim në
2 kokën tonë në KFOR se shefi i përgjithshëm i UÇK-së ishte
3 Thaçi. Thaçi nënshkroi këtë angazhim në datën 21 qershor për
4 shkak se ai ishte shefi. Dhe kjo ishte e qartë gjatë gjithë
5 kohës që jemi në Kosovë. Në qoftë se Thaçi do t'i kishte dhënë
6 një udhëzim Çekut, Çeku do ta kishte zbatuar këtë urdhër. Nuk
7 kam arsye që të mendoj ndryshe. Çeku kishte qenë ushtar i
8 ushtrisë jugosllave dhe kroate dhe nuk kam dëgjuar ndonjëherë
9 që të mos i jetë bindur një urdhri të dhënë nga Thaçi. Nuk më
10 kujtohen shembuj të qartë që Thaçi të ketë dhënë urdhër dhe të
11 ishte realizuar një gjë e tillë, por kjo nuk nënkupton që ai
12 nuk ishte shef dhe nuk ishte shef dhe nuk janë realizuar
13 fjalët e tij."

14 A jeni dakord me atë që tha Mike Jackson?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Është shumë e ndërlikuar. A mund
16 ta ndajmë?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
18 dëgjojmë. Përgjigjuni në tema të përgjithshme.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Dakord, i nderuar Gjykatës.

20 Gjenerali Jackson dhe unë ishim miq. Kishim marrëdhënie
21 personale midis këshilltarit politik dhe komandantit politik.
22 Unë i isha thjesht këshilltari i tij politik. Por kam punuar
23 shumë ngushtë dhe për këtë arsye isha unë ai që e hartova këtë
24 marrëveshje, këtë marrëveshje të angazhimit.

25 Megjithatë në këtë rast përgjigja është jo. Së pari, siç

1 e thashë në fillim, roli i Gjeneralit Jackson ishte që të
2 dislokonte këto forca të NATO-s, që ishte gjë shumë e
3 vështirë. Atij i është dashur që të merrej dhe me çështjen e
4 pushtimit të Prishtinës nga ana e rusëve. Më kujtohet komenti
5 që tha që "Nuk dua të krijoj, të filloj luftën e tretë
6 botërore këtu". Më kujtohet isha atje. Ai ishte nën presion
7 shumë të madh. Ne nuk i kemi treguar atij se çfarë po bënim.
8 Thjesht i kemi thënë "Po bëjmë diçka". I vetmi rast kur ne i
9 shkuam dhe i kërkuam ndihmën e tij ishte për të biseduar me
10 Kombet e Bashkuara pasi ishte mandati i Rezolutës së Këshillit
11 të Sigurimit.

12 Pra, rezultati është se Gjeneral Jackson nuk ka ditur se
13 çka ndodhur në këto male, nuk ishte i pranishëm atje. Nuk e ka
14 mësuar as deri mbas shumë vitesh. Në një nga sesionet e
15 famshme të uiskit, kur ne të dy ishim së bashku, kur i kam
16 treguar se çfarë kemi bërë dhe ai tha që "Nuk kisha dijeni se
17 ju po merreshit me këtë çështje". Pra, ai nuk ka patur dijeni
18 fare sesi është hartuar apo si është arritur tek kjo
19 marrëveshje angazhuese.

20 Ajo që thotë ai me atë që ka ndodhur më vonë nuk është
21 çudi, pasi ky është perceptimi që ka një oficer i një ushtrie
22 të vendeve perëndimore lidhur me urdhrin e një politikani. Ai
23 vetë thotë që nuk i kujtohet asnjë rast që ta mbështesë apo
24 një shembull që ta mbështesë atë pikëpamje.

25 Ai mund të ketë të drejtë. Se në qoftë se Çeku do t'i

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 84

1 ishte dhënë një urdhër ai do ta kishte zbatuar, por është duke
2 folur për një periudhë të mëvonshme, pas nënshkrimit të këtij
3 angazhimi, pas përfundimit të konfliktit kur çdo gjë ka zënë
4 vend, ku ka zënë vendin e vet në periudhën pas konfliktit.

5 Pra, unë nuk jam dakord me deklaratën e tij. Unë mendoj që kjo
6 vjen nga që s'ka qenë i pranishëm në kohën kur është
7 nënshkruar dhe ka të bëjë edhe me perceptimin e tij të plotë
8 lidhur me mënyrën se si silleshin ushtarakët profesionistë -
9 ai kishte respekt për Gjeneralin Çeku - dhe ai është duke
10 shprehur se çfarë do të kishte pritur të bënte Gjenerali Çeku.
11 Por kjo nuk është mënyra sesi e kam kuptuar unë atë situatë.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dua t'ju tregoj një dokument
13 tjetër.

14 Dhe për këtë duhet të shkojmë, të futemi në seancë
15 private. SPOE00214873 deri në SPOE00214999.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 85

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 86

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 87

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 88

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 89

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

14 PY. Z. Duncan, duhet ta përsërisim pyetjen. A e dini nëse

15 UÇK-ja në të vërtetë u çarmatos, u demilitarizua?

16 PË. Po.

17 PY. Kush ishte përgjegjës për demilitarizimin?

18 PË. Gjeneral Çeku.

19 PY. Kujt i raporte?

20 PË. Gjeneralit Mike Jackson.

21 PY. Kush e kishte përgjegjësinë kryesore të procesit të

22 demilitarizimit të UÇK-së?

23 PË. E njëjta gjë, Gjenerali Mike Jackson.

24 PY. Mbi ç' baza ligjore?

25 PË. Rezoluta 1244.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 90

1 PY. Faleminderit.

2 PËRKTHYESJA: Përkthyesit kërkojnë të bëhet një pauzë
3 midis pyetjeve dhe përgjigjeve.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

6 PY. Tani do të flasim për një temë tjetër që lidhet me
7 situatën pas luftës në Kosovë.

8 Pasi u nënshkrua marrëveshja a shkuat më në Kosovë ju në
9 1999 dhe, nëse po, kur dhe me kë?

10 PË. Po. Kam shkuar disa herë. Më konkretisht në gusht me
11 Gjeneralin Wesley Clark.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në cilin vit?

13 DËSHMITARI: [Përkthim] 1999.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

15 PY. Po para gushtit keni shkuar?

16 PË. Po mendoj se të gjitha vizitat me Gjeneralin Wesley Clark
17 i kemi pasur në gusht.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund të
19 më lejoni t'i rifreskoj dëshmitarit kujtesën duke ia lexuar
20 paragrafin 74 të deklaratës së tij?

21 PY. Z. Duncan, do lexojmë paragrafin 74 të deklaratës suaj.
22 Më falni. Po 74 është, mendova 73, po jo 74.

23 PË. Po. Paskam pas një vizitë në korrik. Më falni për këtë.
24 Ju kërkoj ndjesë.

25 PY. Nuk ka problem. Na përshkruani si ishte situata në

1 qershor të 1999? E kam fjalën për situatën politike, të
2 sigurisë, situatën ligjore?

3 PË. Në korrik apo gusht. Qershor a korrik, më falni?

4 PY. Në qershor.

5 PË. Kur u larguan forcat serbe pati një eksod të
6 jashtëzakonshëm në eksodin publik dhe në tërësinë e vet.
7 Burgjet, juristët, avokatët, gjyqtarët, policët, pra, kjo
8 ishte si rezultat e sistemit të aparteid që kishin ushtruar
9 serbët vitet pararendëse, ku në thelb ose i kishin pushuar
10 shqiptarët nga puna, shqiptarët i kishin shkarkuar nga këto
11 pozita dhe nuk kishin lejuar dhe nuk kishin rekrutuar më
12 shqiptarë.

13 Pra, shumica e shërbimeve publike asokohe kanë qenë të
14 ushtruara prej serbëve të cilët u larguan dhe kjo krijoi një
15 vakum shumë të madh.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do t'ju tregoj një dokument. Po
17 ta pyes njëherë Prokurorinë nëse duhet ta bëjmë privatisht apo
18 publikisht këtë. Atëherë bëhet fjalë për dokumentin ERN
19 SPOE00000959 deri në 000001070.

20 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

21 Z. HALLING: [Përkthim] Në seancë publike nuk ka problem.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju lutem të vendoset dokumenti
23 në ekran. Ju lutem të shohim fillimisht faqen e parë.

24 PY. Z. Duncan, kjo është deklarata e një dëshmitari të
25 Anthony Quinn, i cili ka qenë pjesë hetimore dhe është një

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 92

1 deklarata që ka bërë para Gjykatës së Lartë në Londër, ka qenë
2 i policisë metropolitane desha të thoja.

3 PY. Shohim datën 5 mars 2016. Keni dijeni, e njihni Anthony
4 Quinn?

5 PË. Jo.

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shohim pjesën e fundit të
7 paragrafit 1 që të kuptoni kontekstin.

8 PY. Mes qershorit-shtatorit 1999 ka qenë i dislokuar në
9 Kosovë, ka qenë zëvendëskomandant i degës hetimore speciale të
10 Policisë Ushtarake Mbretërore.

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, të
12 shohim paragrafin 6 fjalia e fundit.

13 PY. Thotë:

14 "Hymë në Prishtinë më 20 qershor më 1999."

15 Z. Duncan, a e dini ju se asokohe Policia Ushtarake
16 Mbretërore kishte forca të dislokuara në Prishtinë?

17 PË. Më 20 qershor unë kam qenë në fakt i ngarkuar me detyra
18 të tjera. Por nuk kam pas dijeni që ne kishim dislokuar forca,
19 këto njësi të posaçme ushtarake, por nuk më befason.

20 PY. A e mësuat këtë më vonë?

21 PË. Lidhur me dislokimin asokohe? Jo. Por pjesërisht në punën
22 që kam kryer më pas, në fund të konfliktit, madje shumë muaj
23 më vonë, pak a shumë, në dimër u vura në dijeni e mësova që
24 kishim forca të caktuara që trajtonin kriminalitetin.

25 PY. Në rregull.

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shohim paragrafin 13 të
2 deklaratës.

3 PY. Do ju lexoj për procesverbal, ju lutem më ndiqni:

4 "Situata kur mbërritëm në Kosovë në qershor 1999 ishte
5 tejet e vështirë. Nuk kishte qeverisje vendore, as ujë, as
6 ujëra të zeza, as energji elektrike dhe as monedha, monedhë
7 vendase. Kishte dalë rendi publik komplet jashtë kontrollit.
8 Ekipi ynë me pothuajse 100 oficerë policie mbretërore ishin e
9 vetmja forcë policore në Qendrën MNB. Kishte numër të
10 jashtëzakonshëm refugjatësh të shqiptarëve të Kosovës që po
11 hynin në Kosovë përmes kufirit dhe përmes disa enklavave,
12 grupimeve serbe, xhepave serbë. Qasja në terren nga KFOR-i,
13 trupat e KFOR-it në Qendrën MNB ishte shumë e butë, ishin
14 shumë të sjellshëm për popullatën lokale ..."

15 Po kaloj.

16 "Se gjuha është një problem shumë i madh sepse na
17 duheshin gjatë gjithë kohës përkthyes, na duheshin përkthyes
18 serbë, na duhej përkthyes shqiptar gjatë gjithë kohës, pasi
19 personat e komuniteteve përkatëse nuk donin të flisnin përmes
20 përkthyesit të palës tjetër."

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shkojmë në paragrafin 14, ju
22 lutem.

23 PY. Mund ta lexoni këtë?

24 "Pasi hymë në Kosovë, pasi hyri në Kosovë një detyrat
25 kryesore të KFOR-it ishte t'i kthente në një lloj normaliteti

1 civilëve. Nuk ishte një detyrë e lehtë. Popullata serbe, që
2 kishte kontrolluar gjithçka, kryesisht ishte larguar dhe e
3 kishte lënë vendin në prag të anarkisë. Kishte një vakum të
4 jashtëzakonshëm nga pikëpamja e infrastrukturës civile. Edhe
5 më keq, nuk kishte polici, çka e kuptoj sepse policia në
6 Kosovë kanë qenë pothuajse serbë dhe u detyruan të tërhiqeshin
7 në kuadër të marrëveshjes teknike ushtarake.”

8 Pyetjet e mia janë si në vijim, fillimisht, përshkrimi i
9 Quinn këtu kur flet për vakumin përputhet me kujtesën tuaj?
10 PË. Shumë.

11 PY. Po përshkrimi që i ka bërë situatës - s’kishte qeveri,
12 s’kishte ujë, e kështu me radhë?

13 PË. Saktësisht këtë kam parë edhe unë.

14 PY. Po kur thotë që kishte komplet një situatë të rendit
15 publik që kishte dalë jashtë kontrollit?

16 PË. Po.

17 PY. Po kur thotë që “Serbët, që kontrollojnë gjithçka ishin
18 larguar dhe vendi ishte në prag anarkie”?

19 PË. Po, kështu ka qenë.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do kërkoj
21 që të pranohet kjo deklaratë pak më vonë. Sidoqoftë dua të
22 trajtojë edhe disa pjesë të tjera të deklaratës gjatë ditës.

23 Për momentin mund të hiqet dokumenti nga ekrani. Ju
24 faleminderit, Sekretarisë.

25 PY. Keni vizituar Pejën në 16 korrik, sikurse e patë?

1 PË. Po.

2 PY. A mund t'i përshkruani Trupit Gjykues çfarë patë në
3 vizitën tuaj të parë?

4 PË. E tmerrshme ishte ajo që pashë, tronditëse. Kur hymë, kur
5 shkua atje, mbërritëm atje, pamë të gjitha dëmet që kishin
6 pësuar shtëpitë e shqiptarëve, kafshët. Mund të shihnim edhe
7 shtëpitë serbe teksa po digjeshin. Të paktën gjashtë kur
8 shkua ne dhe një prej tyre ishte 100 jard prej nga vendi ku u
9 ul helikopteri.

10 Teksa vozisnim nëpër qytet, mund të shihnim rrëmujën që
11 po mbizotëronte, dëmtimet që u ishin bërë bizneseve shqiptare,
12 shtëpive shqiptare. Nuk është shkatërrimi që shikon zakonisht
13 nga bombardimet. Bombardimet i kam parë dhe e di çfarë
14 pasojash lënë. Ky ishte një shkatërrim tjetër, lloj tjetër
15 shkatërrimi.

16 Këtë s'e kam thënë në dëshminë time, por edhe James
17 Blunt, siç ka thënë James Blunt në këngën e tij sepse ka qenë
18 atje, ai thotë "Unë kam qenë këtu. Unë kam qenë këtu. Nuk ka
19 trimëri" dhe thotë, "njerëzit e këqij po bëjnë dëme".
20 Pikërisht njerëzit e këqij ishin pikërisht ata që bënë dëme
21 dhe kjo ishte e tmerrshme.

22 PY. Po sipas jush, të paktën në perceptimin tuaj, kush po e
23 shkaktonte këtë dhunë dhe pse?

24 PË. Fillimisht dhuna ka mbizotëruar gjatë konfliktit, e ka
25 prejardhjen nga konflikti. Kjo ka qenë, ishte një dhunë që

1 kishte disa javë që kishte filluar. Dhe shtëpitë që po
2 digjeshin qartazi ishin shtëpi serbe ose që dikur i kishin
3 serbët, të cilat po digjeshin.

4 PY. Po sipas jush kush po i digjte, kush po ushtronte këtë
5 dhunë, kush po i bënte këto akte dhune?

6 PË. Është e vështirë ta them sepse unë nuk kam parë trupa të
7 armatosur ta bënin këtë gjë. Thjesht persona të zakonshëm.

8 PY. Kur thoni "thjesht persona të zakonshëm"?

9 PË. Thjesht persona të zakonshëm të paarmatosur. Jo forcat e
10 armatosura.

11 PY. Po pse? Pse po ndodhte kjo gjë?

12 PË. Shpagim, po. Po. Për të marr hak. Kur e di çfarë të ka
13 ndodhur edhe unë kam marrë raporte si të tjerët nga OJQ-të dhe
14 organizata të tjera dhe e sheh edhe me sytë e ty. Ju mund ta
15 imagjinoni pse e bëjnë këtë personat, se kjo shkon përtej
16 besës dhe nderit. Këto ndodhin zakonisht në fund të një lufte.

17 PY. Shpagim për çfarë?

18 PË. Për mizoritë që kanë pësuar.

19 PY. Kush janë "ata"?

20 PË. Ju kërkoj ndjesë nuk e thashë qartë. Mizoritë që kanë
21 kryer serbët ndaj shqiptarëve të Kosovës.

22 PY. Atëherë po e ushtronte dhunën serbët apo shqiptarët?

23 PË. Dhuna fillimisht ishte ushtruar prej serbëve, ndërsa
24 dhuna që pash unë kur isha atje po bëhej prej shqiptarëve të
25 Kosovës.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 97

1 PY. Për të marrë hak?

2 PË. Pikërisht.

3 PY. Ju thoni thjesht njerëz të zakonshëm. Sipas jush ishte e
4 organizuar kjo, apo jo?

5 PË. Jo.

6 PY. A patë ndonjë anëtar të UÇK-së të ushtronte krime, të
7 kryente vepra penale?

8 PË. Jo.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund të shohim paragrafin 78
10 të z. Duncan?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

13 PY. Mund ta lexoni këtë fjalinë në paragrafin 78?

14 PË. Nuk më dukej mua sikur kjo dhunë të ishte e organizuar
15 apo udhëzuar prej nga lart, por ishin thjesht akte
16 individuale, hakmarrje dhe sjellje penale, kriminale.

17 PY. Kush ishin këta kriminelë? Domethënë, ju po i ndani. Se
18 më duket sikur thoni më vete hakmarrje ose sjellje kriminale.
19 A janë dy gjëra të ndara?

20 PË. Po. Hakmarrja është kryer nga personat e zakonshëm. Në
21 një situatë anarkie ata që janë kriminelë, sigurisht që do
22 përpiqen tas shfrytëzojnë situatën kriminelët, plaçkitin
23 shtëpi për synime kriminale, shfrytëzojnë anarkinë, situatën e
24 tillë për të vjedhur ç'të mundin. Prandaj po e bëj dallimin
25 mes atyre që janë oportunistë, kriminelë që shfrytëzojnë

1 mundësinë dhe atyre që përpigën të marrin hak për shkak të
2 asaj që kanë vuajtur. Janë dy motive të ndershme.

3 PY. Çfarë kombësie kishin kriminelët?

4 PË. Tani do bëjmë një dallim mes asaj që kishte ndodhur në të
5 shkuarën edhe asaj që kam parë unë. Varet, sjelljet kriminale
6 mund të jenë kryer në të shkuarën, mund të jenë kryer prej
7 serbëve, po do ju flas për këtë, por ajo që pamë ne ishin
8 shtëpitë kur po digjeshin këto ishin akte hakmarrjeje. Kur
9 janë plaçkitur shtëpi, unë vetë me sytë e mi nuk i kam parë,
10 po kuptohet që kjo është një sjellje kriminale.

11 Dhuna në të shkuarën dukshëm nuk ishte kriminale. Ishte
12 një sjellje e synuar. Dhuna e ushtruar prej serbëve dhe
13 shqiptarëve të Kosovës ishte krejt e qëllimshme. Për shembull,
14 të vrasësh kafshët, t'ju djegësh gjënë e gjallë, t'ju djegësh
15 bizneset, ishe një stacion autobusi madje që kishte disa
16 autobusë, autobusë Volvo, që i kishin djegur, i kishin
17 shkrumbuar. Këto kishin ndodhur në të shkuarën prej
18 kriminelëve.

19 Prandaj të bëjmë dallimin mes asaj që ka ndodh në të
20 shkuarën dhe asaj që kam parë me sytë e mi.

21 PY. Në atë ditë që ju bëtë vizitën tuaj, a mësuat gjë si
22 ishte struktura e komandantëve të Pejës?

23 PY. Më duket sikur në Pejë ishte më vështirë sepse kishte një
24 mosmarrëveshje mes udhëheqjes. Njësia atje kishte shumë
25 probleme me UÇK-në, të angazhohej me UÇK-në sepse thanë që

1 komandanti vazhdon të ndryshohet gjatë gjithë kohës atje. Pra,
2 ishte një mosmarrëveshje pushteti mes zonës atje dhe me UÇK-
3 në, të cilën ata na e kanë raportuar.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shohim një artikull në anglisht
5 dhe në shqip. Në anglisht është 018319. Shqipja me të njëjtin
6 numër. Në krye.

7 PY. Z. Duncan, kjo është një deklaratë e Gjeneralit Clark e
8 14 gushtit ku flet për dhunë në Kosovë dhe thotë:

9 "Clark: Nuk ka fakte për sulme të UÇK-së.

10 "Prishtinë - Komandanti suprem i NATO-s Wesley Clark tha
11 gjatë një vizite në Prishtinë se nuk ka fakte që Ushtria
12 Çlirimtare e Kosovës është pas sulmeve që janë kryer kundër
13 serbëve qëkur paqja është nënshkruar me ta në qershor. Clark
14 tha se liderët e UÇK-së herë pas here i kanë mbështetur
15 thirrjet që serbët të qëndrojnë në krahinë."

16 Më pas e citon dhe thotë:

17 "'Unë nuk po i përmend me gishta në UÇK. Lideri i tyre ka
18 qenë shumë bashkëpunues me ne në nivel të lartë' ..."

19 "Disa nga gazetarët në emisionin e KFOR-it thonë që disa
20 zyrtarë ndërkombëtarë kanë thënë se", pra, po na ndiqni, "disa
21 ndërkombëtarë kanë thënë se UÇK-ja është shkaktare për sulmet
22 ndaj serbëve se kanë dëbuar 170 mijë serbë nga Kosova. Por
23 Clark shpjegoi se në shumicën e rasteve dhuna duhet parë si
24 spontane dhe veçanërisht në jug të Kosovës, dhuna është e
25 lidhur me krimin e organizuar."

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 100

1 Sërish citohet:

2 "Nga lideri i UÇK-së ne kemi marrë deklaratë të
3 njëpasnjëshme për mbështetjen e shoqërisë multietnike dhe
4 qëllimeve të komunitetit ndërkombëtar, kështu që unë nuk do
5 t'i vë gishtin se kush e ka bërë këtë' ..."

6 Z. Duncan, a ju kujtohet nëse Gjenerali Wesley Clark e ka
7 bërë këtë deklaratë në një prej udhëtimeve kur e keni
8 shoqëruar dhe ju?

9 PË. Unë e kam udhëzuar ta bënte.

10 PY. A përputhet pikëpamja e tij me tuajën këtu?

11 PË. Po.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kërkoj pranimin e këtij
13 artikulli si provë gjyqësore.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

17 Atëherë dokumenti me numër 018319, pa kundërshtime,
18 pranohet.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
20 numrin 1D387 dhe klasifikimi do është konfidencial.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dokumenti mund të jetë publik.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Tani duhet të kalojmë sërish në
24 seancë private për shkak të rregullës 107 dhe do kërkoja
25 ndërkohë të shfaqej në ekran dokumenti SPOE00214873 deri në

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 101

1 SPOE00214999.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
3 seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 102

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.58

17 --- Seanca rifillon në 14.30

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

19 sillni dëshmitarin në sallë.

20 Z. TULLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di në

21 qoftë se më lejoni që të përditësoj lidhur me kohën që na

22 duhet për t'i bërë pyetje dëshmitarit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 Z. TULLY: [Përkthim] Aktualisht kemi kërkuar 30 minuta.

25 Do kërkoj më pak kohë se kaq, në qoftë se kemi pyetje, sepse

1 edhe mund të mos kemi fare pyetje.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ne na duhet më pak sesa një
4 orë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon, ka
6 ndonjë ndryshim?

7 Z. DIXON: [Përkthim] Fillimisht kisha planifikuar një
8 orë, por besoj se do më duhet më pak sesa një orë.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Besoj 15-20 minuta maksimumi.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
11 të gjithëve.

12 Po, Prokuroria, sa kohë mendon se do i duhet për
13 kundërpyetjet?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj që do të na duhet e njëjta
15 kohë që kemi parashikuar; do përfundojmë nesër mbase deri në
16 drektë ose pasdreke, nuk e di.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 Mund të vazhdoni me pyetjet për dëshmitarin, znj.
21 Tavakoli.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
23 Gjykatës.

24 PY. Z. Duncan, do t'i kthehemi përsëri temës që diskutuam
25 përpara fundit të luftës. Ju kërktoj ndjesë se ishte faji im.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 105

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do ju kërkoja dhe një herë që
2 të paraqisnit [REDAKTUAR]
3 [REDAKTUAR].

4 Z. HALLING: [Përkthim] Për shkak të kufizimeve duhet që
5 të jetë konfidenciale.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
7 seancë private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 106

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 107

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 108

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 109

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 jemi në seancë publike.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të kalojmë dhe një herë te
9 deklarata e Anthony Quinn. Për procesverbal është SPOE00000959
10 deri në 000071070. Do ju lutesha të paraqitni në ekran
11 dokumentin, faqen që përfundon me 962. Është paragrafi 15 i
12 deklaratës.

13 PY. Ju lutem lexon dy fjalitë e fundit, Dëshmitar.

14 Aty thuhet: "Niveli i vrasjes ishte jashtëzakonisht i
15 lartë: brenda katër javëve të para kishin mbi 100 vrasje.
16 Pjesa dërrmuese e viktimave ishin nga komuniteti serb të cilët
17 nuk ishin larguar nga vendi, ndërkohë që shqiptarët që po
18 ktheheshin po merrnin hak."

19 A është e vërtetë kjo, me sa ju kujtohet ju, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Le të shikojmë më poshtë në
22 paragrafin 18.

23 PY. "Gama e krimeve të kryera nga popullata që po kthehej
24 dukej sikur të ishte rritur, domethënë, kishte krime,
25 hakmarrje të kryera nga shqiptarët ndaj serbëve për shkak të

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 110

1 gabimeve që kishin bërë gjatë luftës, por gjithashtu edhe
2 përpara luftës. Megjithatë, ka pasur dhe raste kur grupe
3 oportuniste ose grupe -- persona të tillë, përfitonin nga
4 rasti për t'u hakmarrë ndaj gjërave personale ose mund të
5 ishin thjesht persona kriminalë të cilët përfitonin nga
6 situata dhe amullia e krijuar për të bërë akte kriminale."

7 A është e vërtetë kjo çfarë ju kujtohet z. Quinn,
8 Dëshmitar?

9 PË. Po, nuk ishte fare befasuese situata, sepse në të njëjtën
10 situatë kemi pasur dhe në Francë në fund të Luftës së Dytë
11 Botërore. Por, sigurisht në Francë në fund të Luftës së Dytë
12 Botërore ne kemi pasur një administratë. Pra, kemi pasur forcë
13 policore që ka pasur mundësi që të përgjigjej. Ndërkohë që në
14 rastin e Shqipërisë --

15 PY. E keni fjalën për Kosovën, besoj, Dëshmitar?

16 PË. Po e kam fjalën për Kosovën. Në Kosovë kishe vakum, nuk
17 kishte administratë. Kështu që kjo nuk është një situatë
18 befasuese. Sigurisht që situata ishte shumë herë më e vështirë
19 dhe më e rëndë se sa ne kishim parë në 60 ose më shumë vite më
20 përpara.

21 PY. Në këtë paragraf ku flitet për ndërmarrje kriminale, a
22 keni qenë në dijeni ju, z. Duncan, në qoftë se ka pasur grupe
23 kriminale që vinin nga kufiri me Shqipërinë në verë të '99-s
24 apo jo?

25 PË. Sigurisht që kam parë disa raporte nga burime të ndryshme

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 111

1 lidhur me këtë që sapo cekët ju.

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të shohim paragrafin 17. Të
3 lexojmë fjalinë e fundit të këtij paragrafi.

4 PY. Zoti Quinn thotë si më poshtë:

5 "Nuk kishte ndonjë dritë jeshile në atë kohë që të ishe
6 në gjendje që të ndiqje penalisht autorët e veprave, sepse nuk
7 kishte një zyrë prokurorie; nuk kishte prokuror. Ne shpresonim
8 që intervistat që ishin bërë në përputhje me PACE, të
9 kryheshin duke -- po kryheshin duke përdorur përkthyes të mund
10 të shërbenin për mbledhjen e të gjithave provave në mënyrë të
11 tillë që të shërbenin si bazë për gjykimet të cilat më pas do
12 të realizoheshin nga UNMIK-u."

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Vazhdojmë në paragrafin 24. Në
14 këtë paragraf thuhet:

15 PY. "Megjithëse nuk kishte ndonjë autoritet lokal të
16 prokurorisë që ishte tërësisht funksional për të bërë hetime
17 ne kemi përgatitur dosjet e çështjeve në sa më shumë hollësi
18 të ishte e mundur në mënyrë të tillë që ato të mund të
19 trajtoheshin më pas nga UNMIK-u ose nga TPNJ-ja."

20 A e patë këtë, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. A ishit në dijeni të faktit ju që nuk ka pas organe
23 prokurorie në atë kohë?

24 PË. Sigurisht që po.

25 PY. Komentet e z. Quinn lidhur me këtë pikë, a janë në

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 112

1 përputhje me atë çfarë keni menduar ju në atë kohë?
2 PË. Po. Kjo ka qenë një pikë që ka qenë e vështirë që
3 komuniteti ndërkombëtar të jepte kontributin e vet përmes
4 personelit ose stafit dhe që të bëheshin hetime. Dhe që të
5 siguroheshin gjithashtu edhe zyrtarë të prokurorisë apo
6 avokatë mbrojtës. Kjo ka qenë një çështje shumë akute në
7 Kosovë në atë kohë, me sa më kujtohet.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dëshiroj t'i kërkoj Trupit
9 Gjykses që të pranojnë në prova gjyqësore deklaratën e Z.
10 Anthony Quinn.

11 Z. HALLING: [Përkthim] E kundërshtojmë këtë. E kemi
12 përmbajtur veten që të mos ndërhyjmë për sa i takon orientimit
13 të dëshmitarit përmes pyetjeve të avokates. Megjithatë është e
14 qartë që ky dokument nuk mund të pranohet në pajtim me
15 rregullin 153 deri 155.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të
17 kundërpërgjigjem, ne kërkojmë që të pranohet kjo në provë
18 gjyqësore sipas rregullës 138. Është dokument relevant; ka të
19 bëjë me situatën pas lufte në Kosovës; është autentik; është
20 një deklaratë dëshmitari; është një dokument i cili ka datë,
21 ka nënshkrim dhe ka një dispozitë aty ku thuhet që dëshmitari
22 thotë të vërtetën dhe vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit
23 cenues. Nuk bie në fushën e veprimit të rregullës 153 deri 155
24 sepse nuk është një deklaratë dëshmitari që është marrë në
25 kontekstin e hetimeve penale ose një procesi penal.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 113

1 Gjykimi i Kontic ka qenë një proces civil gjyqësor, jo
2 penal dhe sikurse e keni vendosur dhe më herët dëshmia e
3 dëshmitarit për qëllime të rregullës 153 deri në 155 është një
4 procesverbal dhe këtu citoj "i çfarëdolloj forme që një
5 dëshmitar ka thënë në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante
6 me një çështje gjyqësore të marrë në kontekstin e një hetimi
7 penal ose një procesi penal". Dhe kjo është thënë prej jush,
8 të nderuar anëtarë të Trupit Gjykues, në parashtimin F03340.
9 Ky është gjykim civil, kështu që si rezultat ne parashtrojmë
10 që duhet të pranohet mbi bazën e dispozitës së rregullës 138.

11 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

13 [Përkthim] Ju lutemi, jepini një numër provizor prove.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
15 numri provizor që do t'i caktoj këtij dokumenti është MFI
16 1D388.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
18 vazhdoni.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

20 Të kalojmë në seancë private për shkak të ofruesit të
21 dokumentacionit sipas rregullës 107.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
23 Sekretare, të na kaloni në seancë private.

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 114

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: John Duncan (Seancë private)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 115

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
14 jemi në seancë publike.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

16 PY. Në vizitën se bashku me Wesley Clark më datë 13 gusht, a
17 ju kujtohet në qoftë se keni pasur biseda të veçanta me z.
18 Thaçi?

19 PË. Po, kemi pasur.

20 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses çfarë keni diskutuar me
21 të?

22 PË. Kemi diskutuar situatën e sigurisë që ekzistonte në
23 terren. Kemi bërë pyetjes të ndryshme si për shembull,
24 mundësinë për bashkëpunim ndërmjet partive politike ose
25 forcave politike. Kemi pasur diskutime lidhur me gardën

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Tavakoli

Faqe 116

1 kombëtare, pra me çështjen e gardës kombëtare. Megjithatë më
2 duhet të them që me sa më kujtohet ka qenë një bisedë e
3 shkurtër.

4 PY. A e keni informuar ju Gjeneralin Clark përpara takimit?

5 PË. Po.

6 PY. A ju kujtohet se për çfarë e keni informuar?

7 PË. Në thelb atë që sapo e diskutova dhe pak më herët.

8 Domethënë e informova që ai të ngrinte këto pyetje, këto
9 çështje. Ndoshta në procesverbal ose në dëshminë time mund të
10 kem dhënë pak më shumë hollësi lidhur me këtë temë.

11 PY. Po në fakt keni dhënë më shumë informacion.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do kërkoja që t'i rifreskohet
13 kujtesa dëshmitarit.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për këtë.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

16 PY. Ndërkohë që shfaqet në ekran deklarata do ju kërkoja që
17 të lexonit pjesën përkatëse të saj.

18 DËSHMITARI: [Përkthim]

19 PË. Po. Ngrija një problem me Gjeneralin Clark, një problem
20 që kishim identifikuar lidhur me procesin e demilitarizimit,
21 duket sikur ky proces kishte shkaktuar shumë pakënaqësi. Dhe
22 z. Thaçi dukej sikur po humbte mbështetjen nga disa prej
23 komandantëve të zonës të cilët dëshironin që të lidheshin ose
24 të shiheshin si të asociuar me palën të tjera. Në veçanti me
25 lidhjet për financimin e mëparshëm të UÇK-së. Dhe ngritëm

1 problemin që mbase kjo mund të ishte një pengesë për procesin
2 e demilitarizimit të UÇK-së.

3 E këshillova Gjeneralin Clark që të shmangte një
4 përballje publike me z. Thaçi, sepse mendoja që mbasi kjo mund
5 të dëmtonte pozicionin e vet, edhe megjithëse ai ishte një
6 person shumë i lehtë për të punuar, e kam fjalën për z. Thaçi
7 këtu.

8 Ne na nevojitej argumenti publik ose argumentet e
9 vazhdueshme publike të tij që përmbajtja e marrëveshjes do të
10 zbatohej.

11 PY. Po Gjenerali Çeku a ka qenë i pranishëm në atë takim?

12 PË. Jo, ka qenë një tjetër takim ai që kemi bërë me z. Çeku.

13 PY. Çfarë takimi keni pasur me Gjeneralin Çeku?

14 PË. Kemi diskutuar pak a shumë të njëjtat tema. I kemi
15 kërkuar atij të na japë vlerësimin e vet se si po shkonte
16 procesi i demilitarizimit; si po e pranonin komandantët e
17 zonës, në veçanti këtë proces demilitarizimi, në qoftë se po
18 respektonin marrëveshjen dhe si ishte fryma, klima e
19 përgjithshme në UÇK sa i takon demilitarizimit.

20 PY. Kush pjesëtar i UÇK-së ishte përgjegjës për të raportuar
21 dhe për të përmbushur marrëveshjen për demilitarizimin?

22 PË. Gjenerali Çeku.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ta heqim dokumentin nga ekrani.

24 PY Z. Duncan i keni treguar Trupit Gjykues prova grafike
25 lidhur me krimet e shqiptarëve ndaj serbëve në verën e 1999-s.

1 A mund ta kishte ndaluar këtë dhënë Hashim Thaçi?

2 PË. Në mënyrë të pavarur, jo.

3 PY. Pse e thoni një gjë të tillë?

4 PË. Për shkak se me sa kuptonim ne nuk ishte dhunë e
5 orkestruar. Ajo që donim ne të bënte ai ishte t'u lëshonte
6 thirrje kosovarëve që të mos e bënin një gjë të tillë, të
7 përmbaheshin. Megjithatë, siç e përshkrova bëhej fjalë për
8 sulme të hakmarrjes, oportunistë kriminelë. Pra, si çdo
9 politikan ai mund të lëshonte thirrje për qetësi, por nuk
10 ishte në gjendje që ta zbatonte një gjë të tillë. Por për
11 shkak se kjo nuk ishte organizuar nga UÇK-ja, me sa kuptonim
12 ne nga informacioni që merrnim dhe nga burimet e zakonshme,
13 kjo ishte më e mira që mund t'i kërkonim të bënte.

14 PY. Dhe a e bëri ai këtë apel për qetësi?

15 PË. Po, e bëri.

16 PY. Faleminderit.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon, ju
19 e keni radhën.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

21 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

22 Z. DIXON: [Përkthim]

23 PY. Mirëdita, z. Duncan.

24 PË. Mirëdita.

25 PY. Unë jam Rodney Dixon; unë përfaqësoj z. Kadri Veseli dhe

1 kam disa pyetje të tjera për t'u bërë gjatë kësaj pasditeje.
2 Në mëngjes sot në faqen 13 të transkriptit -- dhe s'ka nevojë
3 që ta shohim me sy, përshkruat ditën e punës suaj që fillonte
4 aq herët në mëngjes dhe thatë që një nga gjërat kryesore që
5 bënit ishte që të shqyrtonit të gjithë informacionin e
6 disponueshëm me qëllim që t'i tregonit apo të informonit z.
7 Gjeneralin Clark. Dhe thatë se çfarë mund të shihnit në
8 internet në 24 pararendëse. Thatë që shihnit po kështu edhe
9 telegrame diplomatike që merrnit, që keni lexuar shërbimet e
10 mbikëqyrjes së monitorimit për të parë nëse mund të gjenit
11 ndonjë gjë tjetër dhe vlerësimit që bënin organet e zbulimit
12 gjithashtu.

13 Pra, a kam të drejtë të them se sipas mendimit tuaj keni
14 krijuar një pamje të përgjithshme, gjithëpërfshirëse si
15 rezultat i këtij gjithë materiali?

16 PË. Nuk do thosha që ishte gjithëpërfshirës për shkak të
17 vështirësive që dalin nga raportimi nga një zonë lufte dhe
18 faktit që në terrenin e luftës kishte shumë pak gazetarë. Pra,
19 krijohej një pamje e përgjithshme por jo gjithëpërfshirëse.

20 PY. Ju na thatë se kishit informacion nga njerëz që
21 ndodheshin në terren, a ishte kështu?

22 PË. Mund të jeni më specifik?

23 PY. Ju thatë që kishit komandantë operativë nga të cilët
24 merrnit informacion; a keni marrë informacione të tilla të
25 drejtpërdrejta nga terreni?

1 PË. Nuk mund të komentoj një gjë të tillë.

2 PY. E kuptoj se për shkak të procedurës së rregullit 107 që
3 nuk do të jepnit dot hollësi, por në përgjithësi a mund të na
4 tregosh të thoni që keni marrë informacion edhe nga terreni
5 lidhur me atë që ndodhte në zonën e konfliktit çdo ditë?

6 PË. Më duket se nuk i përgjigjem dot kësaj pyetje.

7 PY. Ju thatë që keni lexuar të gjitha vlerësimet e zbulimit,
8 a është e saktë kjo përgjigje?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe kjo bëhej çdo ditë?

11 PË. Po.

12 PY. A mund të konfirmoj lidhur me periudhën kohore që po
13 shqyrtojmë dhe për informacionin që merrnit, që kjo periudhë
14 ishte nga gushti i '98, gjatë gjithë 1999?

15 PË. Po, është e saktë, ajo është periudha që unë kam pasur
16 këtë post.

17 PY. Pra, shqyrtimi i materialeve që merrnit çdo ditë, kjo ka
18 ndodhur gjatë gjithë kësaj periudhe të '98 dhe '99?

19 PË. Po.

20 PY. Në dëshminë tuaj thatë se me sa keni kuptuar ju, UÇK-ja
21 nuk ishte e organizuar në mënyrë hierarkikë, a kishit krijuar
22 këtë përshtypje nga informacioni që merrni plus përvojën tuaj,
23 pra, a ka ardhur nga shqyrtimi i të tërë këtij informacioni
24 dhe materiali?

25 PË. Po. Por nuk ekziston një moment i caktuar, një pikë e

1 caktuar kohore kur kuptohet që nuk e kishin këtë strukturë.

2 Pra, e gjitha kjo situatë ka evoluar, ka ndryshuar që nga
3 gushti i 1998; kemi patur masakrën - masakra e Reçakut ka
4 ndodhur në atë kohë dhe të tjera. Dhe organizata e njohur si
5 UÇK-ja me afrimin e konfliktit u zmadhua dhe u bë shumë e
6 madhe sesa ç'kishte qenë në vitet pararendëse.

7 Pra, nëse po më pyesni, nëse kishte një pikë të caktuar
8 kohore kur unë kam arritur në këtë përfundim, do të thosha,
9 jo. Unë po i shqyrtoja informacionet siç vinin në momentin që
10 vinin gjatë kësaj periudhe. Por nuk kam parë shembuj që të
11 tregonin llojin e organizmit siç pretendonin serbët por edhe
12 ata vetë.

13 PY. Pra, situata evoluonte. Kështu që, është një periudhë,
14 pra, e cila i përket '98-s dhe '99-s, apo jo, kështu është?

15 PË. Po.

16 PY. Në deklaratën tuaj si dëshmitar dhe nuk ka nevojë që ta
17 vendosim në ekran, pasi rrjedh nga ajo që sapo thatë. Në
18 paragrafin 62 thoni:

19 "Edhe para fillimit, edhe përpara fillimit të negociatave
20 të marrëveshjes ndërmarrëse në qershor '99 dhe më pas nuk kam
21 parë asnjë tregues që UÇK-ja të ishte një organizatë e
22 disiplinuar nga lart me hierarki nga lart-poshtë. UÇK-ja mund
23 të ishte përpjekur ta bindte publikun e gjerësishëm se mund të
24 ishte e krahaseshme me forcat e rregullta ushtarake, për
25 shembull, përmes deklaratave të tyre publike, por nuk i kam --

1 por këtë unë e kam parë thjesht dhe më shumë si një gjest
2 politik sesa reflektim apo pasqyrim i realitetit.

3 A i përmbaheni këtij qëndrimi?

4 PË. Po.

5 PY. Pak më herët në deklaratën tuaj thatë”:

6 “Lëvizjet çlirimtare gjithmonë zakonisht iu jepnin tituj
7 vetes së tyre komandantëve dhe e quanin batalion edhe njësite
8 të cilat nuk mund të krahasohen me ushtritë të rregullta.”

9 PË. Po, ashtu është, dhe është -- kështu kanë funksionuar të
10 gjitha guerilet që nga vitet në 80 vitet e shkuara

11 PY. Dhe kjo vlen për UÇK-në?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe thatë që i jepnin vetes tituj të zmadhuar që nuk
14 kishin asgjë të përbashkët me realitetin, kështu është?

15 PË. Po.

16 PY. A është e saktë atëherë që kjo që po shpjegoni që këto
17 tituj dhe këto struktura mund -- ekzistonin edhe në Shtabin e
18 Përgjithshëm të UÇK-së, në qoftë se ke dëgjuar për të? Pra
19 realiteti në praktikë ishte që Shtabi i Përgjithshëm nuk ishte
20 një organ kolektiv i cili të kontrollonte dhe të komandonte
21 UÇK-në në të tërë territorin e Kosovës, a është e saktë kjo?

22 PË. Mund të ofroj një koment?

23 PY. Dakord.

24 PË. Gjatë kohës time unë kam dëgjuar të përmendet Shtabi i
25 Përgjithshëm, por këtë në deklaratat politike kryesisht. Nga

1 aktakuza kam kuptuar që është krijuar në mes të viteve '90 kur
2 UÇK-ja ishte një organizatë tejet e ndryshme, shumë më e vogël
3 dhe po të dëshironin t'i jepnin tituj grandioz vetes si Shtabi
4 i Përgjithshëm e kështu e me radhë, këtë bënë organizatat e
5 ngjashme. Por në kohën që unë kam qenë atje, nuk kam patur
6 asnjë dëshmi që të ekzistojë një Shtab i Përgjithshëm sipas
7 kuptimësisë, nga pikëpamja ushtarake.

8 PY. Faleminderit. Dhe ti vetë nuk ke pasur takime me Shtabin
9 e Përgjithshëm si në tërësi gjatë kohës tënde, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Ju thatë që keni mbajtur takime me datën 17 dhe me datën
12 19 korrik - më falni - qershor, me 17 dhe 19 qershor, por kjo
13 ishte me komandantët e zonave, kështu është?

14 PË. Po, ishte me Gjeneralin Çeku dhe komandantët e zonave me
15 datën 17 dhe me datën 19 na u bashkua edhe z. Thaçi dhe disa
16 prej kolegëve të tij të sektorit politik.

17 PY. Po ju edhe u përqendruat në një numër diskutimesh që ke
18 patur me komandantët -- kishit patur me komandantët e zonave,
19 a ishin këto diskutime intensive, a është e saktë kjo?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe bëhej fjalë për çarmatosjen dhe për hapat që duheshin
22 marrë në këto zona?

23 PË. Kishte të bënte me të tërë, por siç e thashë edhe më
24 herët problemi apo pika në të cilët ato u bënë intensiv dhe ku
25 ndaluan diskutimet ishte se ato nuk po pranoreshin si pjesë e

1 diskutimeve, por gjatë vetë këtyre diskutimeve që bëmë ata
2 kishin pyetje, gjëra që donin t'i sqaronin. Por situata nuk
3 ishte konfrontuese. Ato po bashkëpunonin për të arritur
4 marrëveshje bashkë me ne.

5 PY. Unë nuk po sugjeroj që ishte intensive, por po thosha që
6 ishin të interesuar që të gjenin një marrëveshje, të arrinin
7 një marrëveshje për ta zbatuar në terren, kështu është?

8 PË. Nuk jam -- nuk është se nuk jam dakord me atë qëndrim
9 pyetje.

10 PY. Pra, ata donin të ishin në gjendjen që të arrinin
11 marrëveshjen për ta zbatuar deri në fund.

12 PË. Sipas diskutimeve të plota që janë bërë me Gjeneralin
13 Çeku, unë mendoj se pritshmëria ishte që ky vendim do të ishte
14 kolektiv dhe individual.

15 PY. Gjatë diskutimeve me komandantët e zonave, a kuptove që
16 këta njerëz ishin përfaqësuesit e qytetarëve, fshatarëve të
17 tyre, të zonave të tyre përkatëse, a krijove këtë përshtypje?

18 PË. Ata ishin personat që erdhën, ata ishin personat të cilët
19 Gjenerali Çeku na tha se duhet të ishin të pranishëm. Nuk mund
20 të komentoj më tutje.

21 PY. Po ke pritur që ato të ktheheshin në zonat e tyre për ta
22 zbatuar këtë?

23 PË. Po.

24 PY. Faleminderit, z. Duncan. Këto ishin pyetjet e mia.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 125

1 Z. Ellis.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] 20 minuta kam për të bërë pyetje. 20
3 minuta siç e thashë edhe më herët.

4 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

5 Z. ELLIS: [Përkthim]

6 PY. Mirëdita. Unë jam z. Aidan Ellis; përfaqësoj Jakup
7 Krasniqin.

8 PË. Po.

9 PY. Edhe me znj. Tavakoli edhe me z. Dixon keni përmendur
10 burimet e informacionit. Dhe konfirmuat se përveç raportit të
11 shërbimit të monitorimit të zbulimit dhe telegrameve
12 diplomatike thatë që keni përdorur me z. Durkee apo jo?

13 PË. Po, ashtu është.

14 PY. Faleminderit dhe thatë që më parë ishin dislokuar si
15 pjesë e ekipit të Monitorimit të Bashkimit Evropian në kufi,
16 është e saktë?

17 PË. Po.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran
19 materialin SPOE003044001, faqen e dytë ju lutem.

20 PY. Kjo është pjesa e paredaktuar e një raporti të Misionit
21 Monitorues të Bashkimit Evropian me datën 27 nëntor 1998. Dhe
22 thatë që kishin konfirmuar që keni filluar punën në gusht të
23 '98-s. Pra, kjo është brenda asaj periudhe. A keni një shans
24 apo mundësi për ta lexuar këtë paragraf?

25 PË. Më jepni një sekondë ju lutem. Po e lexova.

1 PY. Pra, duket se ky është një raport që ka të bëjë me
2 raportin e paraqitur nga shefi i policisë së Gjakovës që është
3 pjesa e aparatit serb, apo jo?

4 PË. Po ashtu duket.

5 PY. Shihet aty se kur shkoi KDOM-i dhe e gjeti viktimën dhe e
6 gjeti që ishte afër një granatahedhësi, i gjithë ky nuk
7 përputhej me atë që sulmi të ishte ndërmarrë nga UÇK-ja. A e
8 shihni këtë?

9 PË. Po.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë a mund të shohim një
11 dokument tjetër SPOE00133489. Dhe sa për orientim edhe ky
12 është një raport i KDOM-it, një raport javor nga 23-29 nëntor.
13 Të kalojmë në faqen e dytë, paragrafi katër.

14 PY. Ndoshta bëhet fjalë për të njëjtin incident apo për
15 incidente të ndryshëm, por edhe një herë këtu thuhet se kur ka
16 vizituar vendin KDOM-i gjeti prova të cilat dukej se binin në
17 kundërshtim me raportin e dhënë nga policia dhe rrethanat që
18 duheshin -- a e shihni këtë gjë në raport?

19 PË. Po.

20 PY. Atëherë në faqen tjetër, në faqen që përfundon me shifrën
21 91 është në paragraf ku thuhet në fillim, "Me 27 nëntor..."
22 paragrafi i dytë. Ju lutem, hidhini një sy; lexojeni.

23 PË. Po.

24 PY. Edhe këtu bëhet fjalë për një raport të marrë nga forcat
25 e Armatës Jugosllave të cilin KDOM-i nuk ishte në gjendje që

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 127

1 të konfirmonte nëse bëhej fjalë për operacion të UÇK-së apo
2 ishte i sajuar nga MUP-i dhe VJ-ja -- dhe ushtria jugosllave.
3 A të kujtohet nëse kur keni qenë në post keni parë
4 informacione të tilla?

5 PË. Po, sigurisht që kam parë telegrame të tilla. Unë nuk e
6 përmenda në dëshminë që dhashë më herët. Kjo ishte një nga
7 burimet e informacionit që kishim ne. Kjo nuk është çudi fare
8 nëse mbahet mend se Shqipëria u shkatërrua në vitin 1997. Të
9 gjitha depot e armëve u hapën dhe në zonë kishte armë pafund.
10 Dhe prandaj është e vështirë që të thuhet dhe nëse këtu bëhet
11 fjalë për armë të UÇK-së apo të dikujt tjetër.

12 PY. Në faqen 72 të transkriptit sot konfirmuat që ka patur
13 propagandë serbe në atë kohë --

14 PË. Po.

15 PY. -- në atë kohë. A përputhet kjo me raportet e asaj kohe
16 që pa patur raste të propagandës serbe që të sajoheshin
17 operacione të tilla për të hedhur baltë mbi UÇK-në?

18 PË. Po.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kalojmë në faqen pararendëse të
20 këtij dokumenti, në paragrafin e gjashtë.

21 PY. Po kërkoj të lexoni pjesën ku thotë "Fshatarë në Voljakë
22 dhe Svrhe," ju kërkoj ndjesë për mënyrën e shqiptimit të
23 emrave.

24 PË. Po e lexova.

25 PY. Në fillim të dëshmisë më duket se thatë se si e kishit

1 kuptuar shoqërinë shqiptare në atë kohë dhe kanun, a të
2 kujtohet kjo pjesë?

3 PË. Po.

4 PY. A është e saktë që një pjesë e kanunit, pjesë kanuni
5 nënkupton që njerëzit i zgjidhnin vetë problemet që kishin apo
6 jo?

7 PË. Ky është thelbi i kanunit; nuk po flasim për kanunin në
8 mesjetë, por mënyrën si funksionon shoqëria që me anë të tij
9 zgjidheshin, si të thuash, zgjidheshin problemet duke marrë
10 veprime të cilat ishin të barasvlershme.

11 PY. Dhe kështu evitohet konflikti?

12 PË. Po.

13 PY. Gjatë kohës që keni qenë në zonë, a keni lexuar raporte
14 që njerëzit të vriteshin për shkak të rivaliteteve familjare
15 apo rajonale?

16 PË. Nuk më kujtohet shembuj, por nuk do të çuditesha të
17 shihja gjëra të kësaj natyre.

18 Më lejoni t'ju pyes edhe një herë? Në periudhën pas
19 konfliktit dhe më duhet të jem i kujdesshëm se si i përgjigjem
20 kësaj pyetje, ka ekzistuar një incident ku një anëtar i
21 nivelit të lartë i UÇK-së ishte i përfshirë në një hakmarrje
22 personale me një familje, nga familje e tij, domethënë, dhe me
23 një familje tjetër që nuk ishte pjesë e UÇK-së. Dhe në fillim
24 mendohej që kjo mund të ishte shkelje e marrëveshjes apo
25 angazhim, dhe në fakt, këtu bëhej fjalë për incident të tipit

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 129

1 për të cilin po flisni, kur bëhej fjalë për hakmarrje
2 personale midis dy familjeve që ishin në gjak. Dhe njëra prej
3 familjeve mori, ndërmori veprim kundër familjes tjetër dhe
4 ndodhi që një pjesëtar i njërës prej këtyre familjeve të ishte
5 nga UÇK-ja.

6 PY. Dhe në këto raste themi se hetimi është i thellë, është e
7 vështirë që të përcaktohet se për çfarë bëhej fjalë?

8 PË. Po ashtu është.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këto dokumente
10 unë kisha ndërmend që t'i paraqisja përmes procedurës së
11 zakonshme këtu ose përmes dëshmisë jogojore sipas në qoftë se
12 z. Halling nuk është në kundërshtim me këtë.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim me
14 kusht që të klasifikohen si konfidenciale.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, sa
16 prej këtyre, sa pjesë të këtyre doni të pranoni, faqen 2 të
17 këtij dokumenti?

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Dokumenti i parë SPOE00304401 dhe në
19 faqen e parë e vetmja gjë të cilën nuk është redaktuar është
20 data dhe titulli.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po pyes cilat
22 faqe doni të pranohen si prova.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Unë do t'i kërkoja të dyja në faqen
24 1 dhe faqen 1 [Sipas përkthimit].

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 0304401 faqe

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 130

1 1 dhe 2 e të cilët e tij pranohen dhe do kenë klasifikimin
2 konfidencial.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të kenë numrin e
4 provës 4D107.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe dokumenti i dytë ishte
6 SPOE00133489. Dokument me katër faqe. Unë kam shfrytëzuar
7 vetëm dy faqe, por për arsye konteksti dhe katër faqe mund të
8 pranohen.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
10 problem?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk ka problem.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Katër faqet e
13 SPOE00133489 do të pranohen.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të kenë numrin e
15 provës 4D108.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Doja t'i tregoja dëshmitarit një
17 dokument tjetër, por -- ju kërkoj ndjesë se nuk e kam vendosur
18 në dokumentacionin që do doja të paraqisja. A mund të më jepni
19 leje që ta paraqis?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë
21 dokumenti bëhet fjalë?

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Është një artikull i Telegrafit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni
24 problem?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi numrin rendor.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 131

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Është DJK08054 -- 02054

2 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim që t'i
3 tregohet dëshmitarit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E tregoni.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. A
6 mund ta vendosim këtë në ekran. Ju kërkoj ndjesë që nuk ishte
7 në radhën e dokumenteve që do të paraqiteshin. Të zbresim pak
8 më poshtë. Faleminderit. Aty është mirë.

9 PY. Ky është një artikull i Telegrafit. Nuk e di nëse mund të
10 komentoni apo jo mbi këtë dokument, por fillohet aty ku
11 thuhet:

12 "Ekipet e forcave speciale britanike dhe amerikane
13 punonin me rebelët në Kosovë dhe me Ushtrinë Çlirimtare të
14 Kosovë..."

15 Jeni në gjendje ta konfirmoni këtë?

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo, nuk jam në gjendje ta bëj këtë
17 pyetje.

18 PY. A kishit dijeni se raporte të tilla botoheshin në atë
19 kohë?

20 PË. Unë sigurisht që do ta kem parë në atë kohë.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të kërkoja
22 që të pranohet si provë mbi bazën se dëshmitari ka parë
23 dokumente të tilla në atë kohë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling,
25 keni kundërshtim?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DJK02054

3 pranohet. A duhet të jetë konfidencial?

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, është dokument publik.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Jemi dakord. Është publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë le të
7 mbetet publik.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
9 t'i jepet numri i provës 4D109 dhe vërej që është një artikull
10 me tre faqe.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju
12 dëgjova.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është në dokument me
14 tre faqe dhe ju përmendët vetëm faqen e parë.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe këto ishin pyetjet që kisha unë.
16 Faleminderit i nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë një
18 pushim 10 minutësh përpara se të fillojmë me pyetjet e
19 Prokurorisë.

20 E kemi, pra, dhjetë minuta pushim.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Takohemi pas
23 dhjetë minutash.

24 --- Seanca ndërpritet në orën 15.26

25 --- Seanca rifillon në orën 15.26

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 133

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
2 sillni dëshmitarin në sallë.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ditë e gjatë,
5 ëh?

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Është në fakt e gjatë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling
8 tani nga Prokuroria do t'ju bëjë pyetjet. Ju lutem, dëgjojeni
9 me vëmendje.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

12 Pyetje të palës tjetër nga z. Halling:

13 Z. HALLING: [Përkthim]

14 PY. Dhe mirëdita, z. Duncan. Quhem Matt Halling, jam Prokuror
15 pranë Prokurorisë së Posaçme, të Specializuar. Do t'ju bëj
16 pyetje sot deri në orën 16.30, do të përfundoj nesër.

17 PË. Në rregull.

18 PY. Po flisnit për njohuritë që keni për UÇK-në, Qeverinë e
19 Përkohshme, burimet që keni lexuar, vështirësitë e raportimit
20 në një zonë lufte. Dhe unë do të filloj me këtë pyetje, e
21 njihni Lëvizjen Popullore të Kosovës? E njohur ndryshe si LPK-
22 ja.

23 PË. Po.

24 PY. Po marrëdhënien e LPK-së me UÇK-në, a e njihnit?

25 PË. Po.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 134

1 PY. Si e keni kuptuar ju marrëdhënien mes tyre?

2 PË. Më duhet të kthehem shumë kohë pas dhe pyetja është tepër
3 e hollësishme. Nga sa më kujtohet -- po përpiqem të gjej
4 formulimin e duhur. Ka qenë krahu politik i UÇK-së. Të paktën
5 si e kam kuptuar unë. Kanë qenë pjesë e të njëjtit grupi, nëse
6 mund të shprehem kështu.

7 PY. A e njihni përmbajtjen e komunikatave zyrtare të UÇK-së?

8 PË. I kam parë, po jo gjithmonë, por kam parë shumë shpesh.
9 M'i raportonin, KDOM-i, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, ndonjëherë i
10 shihja në shtyp. Tek ekipet që monitoronin shtypin, pra më
11 raportonin. M'i dërgonin në forma të ndryshme.

12 PY. Komunikatat e UÇK-së, çfarë temash mbulonin?

13 PË. Larmishmëri temash lidhur me aspektet politike të
14 zhvillimeve. Por nga sa kam lexuar unë, unë kam qenë drejtori
15 -- kam qenë drejtor komunikimesh në një nga punërat që kam
16 pasur dikur, po përpiqeshin të tregonin që ishin një
17 organizatë e mirëthemeluar dhe se ishin e ardhmja e Kosovës.
18 Kjo është, ky është mesazhi që përpiqeshin të përcillnin.

19 PY. Ta shohim në një shembull më konkret.

20 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të nxjerrë në
21 ekran provën materiale me numër P273-ET.

22 PY. Dëshmitar, komunikatat e UÇK-së mbanin numër sipas
23 dëshmimeve që kemi marrë. Kjo komunikatë numër 28 e datës 16
24 janar 1997, dhe fillon kështu:

25 "Më 26 dhjetor 1996 dhe 9 janar 1997 [Sipas përkthimit]

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 135

1 në zonën operative numër 1, njësitë tona të armatosura kryen
2 dy vrasje kundër kolaboracionistëve të pushtuesve serbë në
3 Kosovë.”

4 Më poshtë vazhdon dhe thotë:

5 “Vendimi për t’i ekzekutuar u mor nga Shtabi Qendror i
6 UÇK-së pasi ishin paralajmëruar më herët të hiqnin dorë nga
7 bashkëpunimi me pushtuesin dhe në përputhje me vendimin e
8 Shtabi Qendror të UÇK-së të botuar në komunikatën numër 27.”

9 A keni parë ndonjë komunikatë të ngjashme më përpara?

10 PË. Kjo është nxjerrë përpara se të shkoja unë. Unë kam
11 filluar në gusht të 1998, këtu bëhet fjalë për në janar të
12 1997. Kështu që nuk ka qenë, nuk ka qenë e njëjta situatë.
13 Lufta kishte përparuar shumë. Nuk më kujtohet të kem parë
14 ndonjëherë diçka të kësaj natyre, ku të përmendeshin
15 ekzekutime apo likuidime të kolaboracionistëve apo të
16 tradhtarëve të kombit. Mund ta shihni në paragrafët e fundit
17 mesazhin që jepet këtu.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim tani në ekran provën
19 materiale P1752-ET.

20 PY. Dëshmitar, në krye të ekranit këtu thuhet që është
21 komunikata numër 80 e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, data
22 është 23 qershor. Vitin nuk e ka këtu, sidoqoftë mund ta
23 shihni ku thuhet:

24 “Takimi i parë mes COMKFOR-it dhe UÇK-së është mbajtur më
25 22 qershor 1999, në Prishtinë.”

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 136

1 E shihni, në paragrafin e dytë?

2 PË. Po.

3 PY. Në pjesën 1 të kësaj komunikate, thuhet si në vijim:

4 "Shërbimi i Zbulimit të Zonës Operative të Drenicës ka
5 informacion të pakontestueshëm se deri më 1995, Sami, Vehbi
6 dhe Gani Lutani kanë bashkëpunuar me shërbimet sekrete
7 jugosllave dhe më pas shërbimet ushtarake jugosllave në
8 Kosovë."

9 Pastaj vazhdon dhe thotë:

10 "Gjatë veprimtarive të tyre të armatosura kundër
11 popullatës kosovare, ata kanë përdhunuar gra dhe vajza
12 kosovare. Në një rast madje e detyruan një prej tyre të vriste
13 veten duke u hedhur nga kati i tretë. Për të gjitha krimet,
14 ata kërkohen nga UÇK-ja dhe më 19 qershor 1999, u gjetën dhe u
15 rrethuan nga forcat e policisë ushtarake. Iu kërkuan të
16 dorëzoheshin, por ata hapën zjarr dhe për shkak të shkëmbimeve
17 të armëve të zjarrit, Vehbi dhe Gani Lutani u vranë, ndërsa
18 Sami është ende në kërkim e sipër. Dy prej policëve tanë u
19 plagosën."

20 Pra, UÇK-ja thotë që u ka ndodhur më 19 qershor gjatë
21 kohës kur ju po negocionit për marrëveshjen angazhuese. Keni
22 dijeni për këtë?

23 PË. Jo.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Për palët e tjera lidhur me këtë
25 komunikatë, theksoj që të keni parasysh edhe provën materiale

1 431, faqen 12, P2868 faqen 2 dhe 3, P2869, faqja 5, dhe faqet
2 2793 dhe 2794 të transkriptit.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk e kam kundërshtim në vetvete,
4 por dua të theksoj që, unë me sa kuptoj, ky është përkthimi në
5 anglisht i një komunikate. Dhe origjinali nuk doli në ekran.
6 Do të donim ta kishim më të qartë se mbase duhet parë dhe
7 origjinali, dhe për të parë përkthimin. Pra, ky është
8 përkthimi i asaj që është botuar. Botimi origjinal nuk u shfaq
9 në ekran.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Unë thjesht e pyeta a e njihnte, a
11 kishte dëgjuar për këtë ngjarje.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Prandaj dhe ju thashë që nuk kam
14 kundërshtim, por kur i tha a e ke parë apo e ke kuptuar, mbase
15 do të ishte mirë që të nxirrej origjinali. Ky ishte thjesht
16 përkthimi.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e dimë a
18 ka shqip, gjë në shqip. [Mikrofoni çaktivizuar].

19 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull, e zgjidhim.

20 PY. Flisni apo kuptoni shqip, Dëshmitar?

21 PË. Jo, jo rrjedhshëm.

22 PY. Tani t'i kthehemi pyetjeve të mia. Keni lexuar ndonjëherë
23 apo njihni përmbajtjet e rregulloreve të UÇK-së?

24 PË. Për cilën rregullore konkretisht e keni fjalën?

25 PY. Çdo lloj dokumenti që mund të ketë lëshuar UÇK-ja në

1 kuadër të një rregulloreje.

2 PË. Asokohe, jo.

3 PY. A i njihni urdhrat apo raportet e UÇK-së?

4 PË. Raportet e UÇK-së që raportoheshin në shtyp, po.

5 Dokumentet e punës së brendshme, jo.

6 PY. Keni parë ndonjë dokument që kishte lidhje me emërimet
7 brenda UÇK-së, më përpara?

8 PË. Po varet për çfarë e keni fjalën konkretisht. Nëse kjo
9 është një pyetje e përgjithshme, atëherë për mua është shumë e
10 mjegullt. Unë mund të jap një shembull të gjërave që kam parë,
11 për shembull, kam parë emërimin e Agim Çekut si komandant të
12 UÇK-së. Pra, këtë e kam parë. Por shumica e dokumenteve që kam
13 parë unë nuk ishin materiale që vinin prej zbulimit, të
14 papërpunuara, informacion i papërpunuar. Mua më duhej që të
15 merrja informacion të përpunuar kriminal, apo informacion të
16 përpunuar inteligjence. Edhe unë duhet t'i shikoja këto dhe
17 këto ndonjëherë bazoheshin në informata që personat, dhe prej
18 dokumenteve të brendshme, sikurse i referoheni ju. Por unë s'i
19 kam parë domosdoshmërisht këto dokumente apo këto rregulla.

20 Unë kam parë vlerësimin që kanë bërë agjencitë lidhur me diçka
21 që ka ndodhur, e aty për shembull mund të përmenden
22 rregullorja apo një emërim. Nuk e di sa mund të ndihmojë.

23 PY. Më ndihmon. Na dhe një shembull për emërimin e Agim
24 Çekut. Ke ndonjë shembull tjetër, ndonjë emërim tjetër që ke
25 parë apo ke lexuar?

1 PË. Asgjë me rëndësi, jo.

2 PY. Tani, bazuar në këtë vendimin që emëronte Agim Çekun, a
3 ju kujtohet kush e ka lëshuar atë vendim?

4 PË. Jo, nuk më kujtohet.

5 PY. Do përpigemi t'ju rifreskojmë kujtesën.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem të nxjerrim në ekran
7 provën P113-ET, faqja 008559.

8 PY. Në fund të ekranit thuhet:

9 "Dekreti 84/99 i datës 28 prill 1999, lëshuar nga qeveria
10 e Kosovës në Prishtinë", dhe thuhet:

11 "Në mbështetje të propozimit të Ministrisë së Mbrojtjes
12 së Kosovës, në mbështetje të nenit 6, paragrafi F i ligjit
13 lidhur me Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, qeveria e Kosovës
14 në takimin e 27 prillit 1999 emëron z. Agim Çeku si shef të
15 Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

16 "Vendimi hyn në fuqi menjëherë."

17 Në fund:

18 "Hashim Thaçi, Kryeministër".

19 A është ky emërimi i Agim Çekut që keni parë ju?

20 PË. Nuk e besoj, jo nuk ma merr mendja që është ky. Po më bën
21 përshtypje, por kjo është propagandë. Më vjen keq, por kjo
22 është thjesht propagandë. Por nuk është e pazakontë kjo.

23 PY. Pra ju e kontestoni, ju thoni që Hashim Thaçi nuk e ka
24 lëshuar vendimin?

25 PË. Nuk po kontestoj përmbajtjen e këtij dokumenti. Po

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 140

1 përpigem të kuptoj formulimin që është përdorur këtu. Këtu
2 është folur për Ministrinë e Mbrojtjes të Kosovës. Ç'paska
3 qenë kjo Ministri e Mbrojtjes në Kosovë?

4 PY. Në fakt ju iu përgjigjët pyetjes sime.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga
6 ekrani.

7 PY. Keni njohur një person në UÇK me emrin Azem Sylja? Keni
8 dëgjuar për të?

9 PË. Emër të dëgjuar e kam, mund të ma rifreskoni kujtesën.

10 PY. Po Sokol Bashota?

11 PË. Kam dëgjuar shumë emra. Më vjen keq, por jam disleksik
12 edhe një nga problemet që kam janë emrat. S'kam kujtesë të
13 fortë. Edhe mua shpesh më fliste dikush, më pëshpëriste për të
14 më thënë emrat, se unë nuk i mbaja mend. Kështu që emrat nuk i
15 fiksoj dot, më vjen keq për këtë.

16 PY. Po sikur t'ju them se Azem Sylja ka qenë komandant i
17 përgjithshëm i UÇK-së, dhe Sokol ka qenë ish-zëvendës
18 komandant i përgjithshëm, mund ta kontestoni?

19 PË. Tani që i dhatë pak më shumë kontekst mund të them që
20 emrat i kam të dëgjuar.

21 PY. Po emrat e zonave operative të UÇK-së, i njihni, i mbani
22 mend?

23 PË. Të zonave, apo të komandantëve?

24 PY. Fillojmë me zonat.

25 PË. Konkretisht, jo.

1 PY. Ju keni përmendur disa në paragrafin 83 të deklaratës
2 suaj. Nuk e di a është nevoja të nxjerrim në ekran, por fjalja
3 ishte që:

4 "Remi dhe Ramushi, komandant zone të Prishtinës, pjesën
5 lindore, ishin luajalë, besnikë, por ishin luftëtarë."

6 Pra, ju e keni kuptuar sikur një nga zonat ishte
7 Prishtina dhe zona lindore?

8 PË. Në fakt kjo është marrë besoj nga një raportim që i bërë
9 Gjeneralit Clark dhe terminologjia që kam përdorur unë është
10 terminologjia që përdorte NATO-ja.

11 PY. Pra, po terminologjinë e UÇK-së e keni njohur, e keni
12 ditur kur përshkruante zonat e veta?

13 PË. Nuk më kujtohet.

14 PY. Ju thatë që Ramushi ka qenë komandant i zonës lindore.
15 Besoj zona lindore, lindja e vendit e keni fjalën?

16 PË. Besoj se ka një gabim këtu. Ose kam bërë unë gabim kur e
17 kam shkruar raportin, ose kur e kam kujtuar më vonë s'e kam
18 kujtuar siç duhet.

19 PY. Atëherë, unë po jua them që Ramush Haradinaj ka qenë
20 drejtuesi i zonës së Dukagjinit që është në pjesën perëndimore
21 të Kosovës. E kundërshtoni këtë?

22 PË. Jo, në fakt keni të drejtë.

23 PY. Tani të flasim pak për marrëveshjen angazhuese. E marrim
24 në vija të përgjithshme. Një nga vështirësitë kryesore kur u
25 hartua kjo marrëveshje ishte frika se mos rifillonin ofensiva

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 142

1 serbe, apo jo?

2 PË. Jo. Ne kishim një marrëveshje ushtarake teknike me
3 serbët. Marrëveshja fokusohej në pjesën që mungonte në këtë
4 mozaik. Pra, aftësia për të trajtuar Ushtrinë Çlirimtare të
5 Kosovës, nuk kishim asnjë mekanizëm në fuqi se si do të
6 punonim me ta. Dhe ekzistonte rreziku se mos ata ktheheshin më
7 pas kundër.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Do të doja të shihnim paragrafin
9 32 të deklaratës së dëshmitarit, që është me numër DHT11893,
10 DHT11909.

11 PY. Dëshmitar, ju thatë "më rifreskoni kujtesën sot". Por nuk
12 ua tregoi dikush që këto vështirësitë kalonin dhe në faqen
13 tjetër.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

15 PY. Dhe do të shohim te pika vii që thuhet:

16 "Kosovarët" -- pra kjo ishte një nga vështirësitë:

17 "Kosovarët më në përgjithësi ishin të shqetësuar për
18 rrezikun në plan afatgjatë se mos rifillonin ofensivat serbe
19 dhe ishin të shqetësuar për gatishmërinë e komunitetit
20 ndërkombëtar për t'i mbrojtur."

21 A s'ishte kjo vështirësi?

22 PË. Po, ishte vështirësi, por duhet parë pak më gjerë kjo
23 gjë. Ekzistonin shqetësime se nuk do t'i mbronte NATO-ja.

24 Kishte shqetësime se dhe UNHCR-ja -- Rezoluta përmend
25 rikthimet, dhe sipas tyre u keqkuptua, kujtuan se bëhej fjalë

1 për rikthimet e serbëve, shqetësim krejt legjitim nga ana e
2 tyre kjo. Se komuniteti ndërkombëtar që kishte pikëpamje të
3 ndryshme për shqiptarët e Kosovës, shumë të ndryshëm nga
4 njëri-tjetri, kishin dhe një Rezolutë në fuqi që fliste për
5 rikthimet, dhe ata ishin të shqetësuar se NATO-ja mund të
6 tërhiqej dhe do të rifillonin ofensivat serbe. Për shkak të
7 këtij shqetësimi, ata i rezistonin marrëveshjes.

8 Shpresoj t'jua kem shpjeguar siç duhet pyetjen tuaj.

9 PY. Po. Nga ana e UÇK-së, marrëveshja po ashtu duhet të
10 kufizonte sulmet e UÇK-së sepse do të konsiderohej shkelje e
11 Rezolutës 1244, apo jo?

12 Më dëgjuat?

13 PË. Po.

14 PY. Edhe një herë që ta bëjmë më të qartë për procesverbal,
15 do ta bëj dhe një herë pyetjen. Pra, në këtë marrëveshje
16 parashikohej që të mos lejohej as UÇK-ja të shkelte Rezolutën
17 1244?

18 PË. Shkelje është një term shumë i vagullt, shumë i
19 përgjithshëm. Për cilën shkelje e keni ju fjalën konkretisht
20 kur flisni për këtë marrëveshje?

21 PY. Atëherë, le të shikojmë marrëveshjen konkretisht në
22 ekran.

23 PË. Me kënaqësi.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë shikojmë në ekran
25 marrëveshjen që ka numrin e provës P1444. Paragrafi 11 i kësaj

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 144

1 marrëveshje.

2 PY. E shihni në mes të ekranit:

3 "UÇK-ja pajtohet të mos kryejë asnjë reprezalje,
4 kundërsulme apo veprime të njëanshme në reagim të, në mënyrë
5 që mos cenojë -- Rezolutën 1244 dhe marrëveshjet e tjera
6 lidhur me Kosovën. Kjo padyshim ju mohon [Sipas përkthimit] të
7 drejtën për vetëmbrojtje"

8 A s'është kjo në marrëveshje?

9 PË. Patjetër. Por që ta sqarojmë. Këtu po flasim për veprime
10 për të mos cenuar për të mos shkelur Rezolutën 1244, por këtu
11 është folur për shkelje nga ana e serbëve. Pjesa e parë e
12 fjalisë pra, "UÇK-ja pajtohet të mos kryejë reprezalje
13 kundërsulme", kjo ishte përgjegjësia e UÇK-së. Pjesa e dytë e
14 fjalisë thotë, "veprime unilaterale në kuadër të shkeljeve të
15 Rezolutës 1244". Pra, këtu është dashur të thuhet, këtu iu
16 është referuar serbëve. Serbët nuk duhet të kishin shkelur,
17 nuk duhet të shkelnin Rezolutën 1244.

18 E kuptuat?

19 PY. Po. Sot folët dhe për shqetësimet e Gjeneralit Jackson,
20 apo jo? Dhe ju ishit në unison me Gjeneralin Jackson që në
21 fakt plani i demilitarizimit, mungesa e një plani të tillë
22 ishte një shqetësim i madh.

23 PË. Shumë serioz.

24 PY. Pra, dhe gjithçka duhej përfunduar deri në 21 qershor
25 1999, apo jo?

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 145

1 PË. Po.

2 PY. Pra, diskutimet përfundimtare me UÇK-në në këto negociata
3 ishin veçanërisht të rëndësishme sa i takon pikëpamjes kohore.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
5 lutem bëni një pauzë, bëni një pauzë mes pyetjeve dhe
6 përgjigjeve.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 PY. Kur po negocionit marrëveshjen angazhuese, ju negociuat
10 vetëm me UÇK-në, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe në deklaratën tuaj ju thatë, por dhe sot në sallën e
13 gjyqit, kjo thatë që një marrëveshje ushtarake, por që kishte
14 konotacione të shumta politike, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe shqetësimi juaj ishte se funksionet e kahut ushtarak
17 dhe politik të UÇK-së në këtë rast ishin të përziera, të
18 mbivendosura.

19 PË. Nuk është mënyra se si do të shprehesha unë. E pata
20 fjalën në gojë. Ishte, nuk thashë të mbivendosura, ishte një
21 lloj arkitekture, jo hierarkike, por një arkitekturë ku
22 ekzistonte kahu politik dhe në të njëjtën arkitekturë
23 ekzistonte edhe kahu ushtarak, ana ushtarake. Ju folët pak më
24 herët për pjesën e policisë dhe asaj ushtarake. Pra kjo
25 arkitekturë përbëhej prej tre elementësh. Pra, kjo ishte

1 arkitektura e UÇK-së.

2 Por jo në formë piramide, por ishte më shumë si një
3 rrjetë. Të paktën unë kështu e kam konceptuar.
4 PY. Unë nuk ju pyeta se si ishte strukturuar nga pikëpamja
5 hierarkike, por ata duhej që të ishin të ndara, domethënë
6 krahu politik nga njëra anë dhe tjetri krahu ushtarak nga ana
7 tjetër, apo jo?

8 PË. Ju kërkoj ndjesë, keni të drejtë. Në fakt ishte e
9 nevojshme që bëhej dallimi ndërmjet të dy kaheve.

10 PY. Dëshmitar, ju diskutuat se si Hashim Thaçi e ka
11 përfaqësuar UÇK-në në këto negociata teknike. Ajo çfarë ishte
12 me interes për ju në atë kohë ishte që personi që do të
13 nënshkruante marrëveshjen të kishte autoritetin që të
14 nënshkruante marrëveshjen, apo jo?

15 PË. Besoj që e shtjellova në detaje, por marrëveshja në
16 vetvete krijon disa shtytës që i motivojnë njerëzit që të
17 bëjnë disa gjëra, dhe këta njerëz janë në veçanti komandantët
18 e zonave, z. Çeku, Agim Çeku. Dhe ideja ishte që në momentin
19 kur ta kishim këtë strukturë, ta kishim prezantuar, pra kur
20 ata të negocionin me ne, ata duhej që të respektonin
21 marrëveshjen, domethënë ishin të detyruar që këtë marrëveshje
22 ta respektonin. Më pas, vinte momenti i formalizimit.

23 Dhe në qoftë se ata zgjodhën Hashim Thaçin për të
24 nënshkruar marrëveshjen, për ne nuk kishte pikë problemi. Por
25 rëndësia më e madhe e kësaj marrëveshje ishte që të krijohej

1 ky moment, të kapërcehej ky moment. Domethënë, është diçka që
2 është më komplekse se sa mund të duket në pamje të parë.

3 PY. Besoj që ju kuptova. Megjithatë, për t'u siguruar që ju
4 kuptova 100 për qind --

5 Z. HALLING: [Përkthim] -- do ju kërkoja që të kalonim në
6 paragrafin 59 të deklaratës.

7 PY. Në fund të paragrafit thuhet si më poshtë:

8 "Ajo çfarë ishte më e rëndësishme ishte që personi që do
9 të bënte nënshkrimin të kishte autorizimin për ta bërë këtë
10 gjë, pra që të ishte një person i autorizuar në aspektin
11 diplomatik ... dhe në qoftë se do të marrim parasysh këtë
12 aspekt, flitet për kompetenca të plotfuqishmërisë, ose të
13 ishte nga natyra një qasje ose një pozicion që të kishte të
14 drejtën të nënshkruante marrëveshjen."

15 PË. Fjala kyçe këtu është "në dukje", domethënë, në dukje të
16 ishte një person që kishte kompetencë, ose kishte autoritet që
17 të nënshkruante marrëveshjen. Kjo është fjala kyçe këtu.

18 PY. Dhe ju ishit bindur që Hashim Thaçi kishte staturën e
19 nevojshme për ta nënshkruar këtë dokument në emër të të gjithë
20 UÇK-së?

21 PË. Ishte kërkesa e tyre, ishte marrëveshja e tyre. Unë nuk
22 do kundërshtoja personin që do zgjidhnin ata të nënshkruante
23 marrëveshjen. Në qoftë se ata dolën me emrin e Thaçit, nuk
24 kishte pikë problemi, ishte në rregull.

25 PY. Përpara se sa të flasim në më tepër hollësi për

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 148

1 negociatat për marrëveshjen, dua që të përqendrohemi tek një
2 aspekt i procesit të draftimit juridik, ose të hartimit
3 juridik, teknikës legjislativë të përdorur prej jush. Kemi
4 folur më herët për marrëveshjen e Rambujesë, për marrëveshjen
5 e Lancaster House dhe gjithashtu kemi folur edhe për modelin
6 që ju keni përdorur si bazë për hartimin e marrëveshjes në
7 fjalë. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po, është e saktë.

9 PY. A ka pasur dispozita në këto dokumente bazë që keni
10 përdorur juve për mbrojtjen e civilëve që i keni marrë prej
11 këtyre dokumenteve dhe i keni pasqyruar në marrëveshjen e
12 pasqyruar më pas?

13 PË. Nuk më kujtohet tani, më duhet ta shoh me detaje, duhet
14 t'i shoh të gjitha këto dokumente, megjithatë mund t'ju them
15 për momentin që bëhet fjalë për një dokument që ka marrë
16 parasysh shumë dokumente, dhe procesi në vetvete ka qenë shumë
17 kompleks. Në një proces normal do të duheshin muaj të tërë që
18 të hartonim një dokument të tillë ndërkohë që ne e bëmë për
19 çështje javësh, brenda një jave në fakt, për çështje ditësh.

20 PY. E kuptoj. Pra, është një dispozitë e veçantë në këtë
21 marrëveshje, për të cilën do të doja t'ju bëja disa pyetje të
22 tjera. Le ta shohim bashkërisht.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Bëhet fjalë për provën gjyqësore
24 P1444, faqja 078200, paragrafi 10(d). T'i japim një moment
25 kohë Sekretares për të paraqitur dokumentin në ekran.

1 PY. Tek pika 10 thuhet në fillim që:

2 "UÇK-ja merr përsipër dhe pajtohet në veçanti të
3 ndërmarrë veprimet e mëposhtme."

4 Vazhdojmë tek pika d:

5 "Që të mos sulmojë, të ndalojë ose të frikësojë asnjë
6 civil në Kosovë dhe as të sulmojë, konfiskojë ose të dhunojë
7 pronat e civilëve në Kosovë."

8 A mund të na shpjegoni se prej ku e kishte burimin kjo
9 pikë, cila ishte origjina e kësaj pike?

10 PË. Është shumë e vështirë të them sot pas kaq shumë vitesh,
11 se cili ishte burimi i kësaj pike. Mua nuk më kujtohet një
12 formulim i tillë në dokumentin në *Lancaster House*. Ndoshta
13 mund të jetë edhe aty. Nuk e di. Sepse më duhet ta shikoj
14 formulimin e kësaj deklarate këtij dokumenti, kësaj
15 marrëveshjeje. Por mund të jetë edhe aty, nuk e përjashtoj.
16 Dhe gjithashtu ekzistonte sulmi i civilëve, domethënë, rreziku
17 i sulmimit të civilëve. Nga ana tjetër do kishte një tjetër
18 problem që do vihej në dukje dhe, në fakt, vu në dukje sikurse
19 e pamë gjatë bisedave të mëhershme të ditës së sotme që
20 situata do ishte shumë e pasigurt, pra, ekzistonte ky si
21 rrezik. Situata do ishte e pasigurt për civilët, për
22 kompetencat e UNMIK-ut që nuk do ishin aq shumë të
23 konsoliduara në mënyrë të tillë që të parandalonin llojet e
24 incidenteve të cilat ne i diskutuam dhe më herët sot. Kështu
25 që, ishte afër mëndësh, që ne të siguroheshim prej UÇK-së që

1 UÇK-ja nuk do ishte pjesë e këtyre akteve dhe veprimtarive ose
2 do të tërhiqeshin nuk do të përfshiheshin në veprimtari të
3 tilla.

4 Sikurse e kam thënë dhe më herët, si shtetas francez, unë
5 e dija shumë mirë se çfarë ndodhte pas çlirimit. Kështu që unë
6 kisha parasysh rreziqet që mund të ndodhnin sulme të tilla
7 hakmarrëse. Nuk ju jap dot një përgjigje të thjeshtë për
8 pyetjen që më bënë se nga ku e ka burimin kjo pikë, domethënë,
9 nuk dua që të bëj kërkime të tjera për të thënë se nga ku e ka
10 origjinën një formulim i tillë.

11 PY. Nuk dua që t'ju marr më tepër kohë e të shihni dokumente
12 tjera, por në qoftë se unë ju them që formulimi i tillë nuk
13 ishte në Marrëveshjen e Lancaster, atëherë a më besoni mua që
14 kam të drejtë lidhur me këtë pikë?

15 PË. Në qoftë se e keni parë dhe nuk është, nuk është.

16 PY. Tani, Dëshmitar, dëshiroj të kalojmë dhe të flasim lidhur
17 me takimet që keni organizuar. Le të fillojmë fillimisht me
18 takimet e datës 14 dhe 15 qershor 1999. Më ç'kuptoj unë jeni
19 takuar në të dyja ditët me Agim Çekun. A është e saktë kjo,
20 Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. A kishte ndonjë person tjetër nga pala e UÇK-së së bashku
23 me Agim Çekun që merrte pjesë në takime? Nëse ju kujtohet?

24 PË. Ishte dhe një burrë tjetër që quhej Haliti, në mos
25 gabohem.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 151

1 PY. A ju kujtohet si e kishte emrin Haliti?

2 PË. Sabit [Sipas përkthimit].

3 PY. Sabit Haliti [Sipas përkthimit]. Po nga ana e

4 ndërkombëtarëve kush ishte tjetër në takim përveç jush?

5 PË. Nuk ishin të njëjtët persona si ditën e parë dhe ditën e

6 dytë. E keni fjalën për nga komuniteti ndërkombëtar, apo jo,

7 Prokuror? Atëherë ditën e parë ishte një përfaqësues i KDOM-

8 it, ditën e parë, pra, i KDOM-it Amerikan. Ndërkohë që ditën e

9 dytë ishte një përfaqësues i KDOM-it amerikan dhe një

10 përfaqësues i Shtetet e Bashkuara po ashtu.

11 PY. Përveç dëshmimeve që keni dhënë më herët sot dhe përveç

12 bisedave që keni pasur me Agim Çekun, dikur më datë 15 qershor

13 Agim Çeku ju kërkoi që marrëveshja të nënshkruhej në emër të

14 UÇK-së, a është kështu, Dëshmitar?

15 PË. Besoj se kështu është sepse versioni fillestar i

16 marrëveshjes lexonte "forcat e armatosura" dhe titulli u

17 ndryshua dhe ky formulim u ndryshua. Mund t'i referohem

18 shënimeve që kam mbajtur në atë kohë, por nuk i kam këtu me

19 vete dhe këto janë elementët që më kujtohen pak a shumë.

20 PY. Do t'i kthehem prapë kësaj çështje, ndoshta pas pak kohe

21 ndoshta dhe nesër. Le të vijojmë më tej më datën 17 qershor.

22 Mesa kam kuptuar dëshminë tuaj më herët sot, më 17 qershor

23 është organizuat takimi me komandantët e zonave, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Po ju gjithashtu folët për krahun politik që ishte po

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 152

1 ashtu i pranishëm në takim, a është kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Ju thatë që Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në takim,
4 apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. A ju kujtohet se ku ka qenë se ju thatë që ju tha z. Çeku
7 që nuk ishte i disponueshëm z. Thaçi, apo jo?

8 PË. Më date 18, jam i sigurtë që ka qenë në Lubjanë. Mendoj
9 që edhe më 17 ka qenë po ashtu në Lubjanë.

10 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretares të paraqesë në
11 ekran dokumentin 1D339-ET.

12 PY. Dëshmitar, ky është një artikull i medias që do të
13 transmetohet në ekran, domethënë, është një video në shqip por
14 unë do ju tregoj transkriptin e përkthyer në anglisht. Besoj
15 që mund ta shikoni, apo jo?

16 PË. Datë 17.

17 PY. Pra, është Hashim Thaçi, Pandeli Majko në Maqedoni.

18 Pra, e shikoni që ky është një artikull ose një raportim
19 i Radio Televizionit Shqiptar.

20 Fillon kështu:

21 "Moderatori: Pas takimeve të tij me autoritetet më të
22 larta të Maqedonisë, Kryeministri Pandeli Majko udhëtoi në
23 drejtim të Tetovës ku qindra shqiptarë u grumbulluan për t'i
24 uruar atij mirëseardhjen. Së pari vizitoi ambientet e bashkisë
25 së Tetovës ku Kryeministri i Qeverisë Shqiptare, Pandeli Majko

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 153

1 u takua me Presidentin e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës,
2 Hashim Thaçi, me të cilin pati një takim të gjatë tetë a
3 tetë.”

4 A e keni ditur ju që më 17 qershor të vitit 1999 Hashim
5 Thaçi është takuar me autoritete të larta zyrtare të
6 Maqedonisë dhe me Kryeministrin e Shqipërisë, z. Pandeli
7 Majko?

8 PË. E keni fjalën për Maqedoninë, apo jo? Domethënë, më 17.
9 Flisni për Maqedoninë apo jo? Me sa lexoj, po. Unë e dija, e
10 kam ditur me siguri që ka qenë aty. Nuk jam i sigurtë, po këtë
11 e thashë dhe më përpara.

12 PY. A e keni ditur juve në takimin që keni bërë me të më
13 datën 18 që një ditë më përpara ai ishte takuar me një
14 kryeministër?

15 PË. Jo.

16 PY. Tani do t’ju tregoj një libër shënimesh që e kemi të
17 pranuar në prova gjyqësore.

18 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretares të paraqesë në
19 ekran provën P2910, më konkretisht jam i interesuar për faqen
20 SPOE00229442.

21 PY. Për kontekst dua t’ju them që ky është një material që e
22 kemi gjetur në banesën e Jakup Krasniqit, kjo është një fletë
23 me shënime që do të doja t’jua tregoja.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk besoj se na duhet versioni në
25 shqip, versioni origjinal sepse sigurisht që dëshmitari do

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 154

1 lexojë vetëm anglishten, kështu që do ju kërkoja ta zmadhoni
2 fletën në anglisht.

3 PY. Ju lutem lexojeni dokumentin.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Do ishte mirë që të tregojnë të
5 gjithë faqen në ekran për ta lexuar të plotë.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Dëshirojmë që të shfaqet dhe
7 origjinali në shqip në mënyrë të tillë që të bëjmë krahasimin.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Është prova P3910. Nuk e
9 kuptoj arsyen se pse po kërkon Mbrojtja që të paraqitet
10 versioni në shqip, megjithatë s'është problem për neve.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Paraqiteni,
12 Sekretare.

13 Z. HALLING: [Përkthim]

14 PY. Dëshmitar, shikoni dy dokumentet. Do jetë pak më i vogël
15 versioni në anglisht për shkak të faktit që duhet të paraqesim
16 dy dokumente në ekran. Por hidhini një sy faqes në anglisht
17 dhe ju lutem më thoni në qoftë se e dini nëse këto tema janë
18 biseduar gjatë takimit të 17 qershorit 1999?

19 PË. Disa prej tyre.

20 PY. Do përqendrohemi te disa prej tyre.

21 "Unë ende rekomandoj që t'i caktohet nj titull dokumentit
22 ..."

23 E shikoni këtë?

24 PË. Po.

25 PY. " ... 'Marrëveshje për demilitarizimin e UÇK-së'

1 "Kjo tregon ... se këtë po e bëni ju me dëshirën tuaj."

2 Dëshmitar, a është theksuar për UÇK-në do ishte mirë që
3 të bëhej e qartë që kjo marrëveshje e kishte origjinën prej
4 tyre, domethënë, origjinonte ose vinte prej tyre?

5 PË. Po, ishte e qartë që kjo duhet të ishte një marrëveshje e
6 njëanshme.

7 PY. Po kjo që jepet këtu në faqen 4:

8 "Brenda 90 ditësh, të gjitha forcat e UÇK-së do të
9 përfundojnë me demilitarizimin e UÇK-së."

10 A bëhet fjalë për këtë afatin prej 90 ditësh, a e keni
11 diskutuar afatin prej 90 ditësh në takimin e 19 qershorit
12 1999?

13 PË. Po. Kjo ishte kërkesë e jona.

14 PY. Le të shohim pikën 5, lexoni pak pikën 5 që thuhet
15 aspekti ushtarak, politik, a janë këto aspekte dhe temat të
16 cilat janë diskutuar në takimin e 19 qershorit, Dëshmitar?

17 PË. Po. Është një përforcim i asaj çfarë ka thënë Krasniqi në
18 mënyrë publike, që unë nuk e kam parë, po kjo është baza e
19 asaj çfarë më pas u reflektua në marrëveshje.

20 PY. Lidhur me pikën 2, ku thuhet që:

21 "Ne kemi ndryshuar ... kemi ndryshuar fjalën Kosova në
22 UÇK ... dhe e ndryshuam në të gjithë tekstin."

23 Në qoftë se unë them që në versionin e mëparshëm ishte
24 përdorur termi ose shprehja "forcat shqiptare të Kosovës" a ju
25 kujton kjo gjë, Dëshmitar?

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 156

1 PË. Po. Në fakt ky ka qenë formulimi i përdorur në versionin
2 paraprak.

3 PY. Dhe UÇK-ja insistoi që kjo të ndryshohej në UÇK,
4 domethënë, në vend të shprehjes forcat shqiptare të Kosovës të
5 përdorej UÇK-ja?

6 PË. Po. Po. Ata e kërkuan. Ne nuk insistuam, nuk ishte
7 problem për ne për të bërë ndryshimin.

8 PY. Ju thatë që Ramush Haradinaj ka qenë më datën 17 qershor
9 1999 aty?

10 PË. Po.

11 PY. A ka qëndruar gjatë gjithë kohëzgjatjes së negociatave
12 atë ditë Ramush Haradinaj aty?

13 PË. Negociatat në Kosovë kanë ndodhur vetëm më datën 17 në
14 mbrëmje dhe më datën 19 gjatë gjithë ditës. Me sa më kujtohet,
15 ai ka qenë aty gjatë gjithë kohës.

16 PY. Ne kemi një intervistë të Ramush Haradinajt në një libër
17 që do të doja që t'jua tregoja.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë i kërkoj Sekretarisë të
19 paraqesë në ekran dokumentin SPOE00053072 deri në 00053085-ET,
20 faqja konkrete që kërkoj që të paraqitet në ekran është
21 SPOE00053082, kolona në të majtë të faqes.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] E di që është e parregullt, po ju
23 nuk më bëtë pyetjen se çfarë ishte një shembull që nuk ka qenë
24 aty në marrëveshje.

25 Z. HALLING: [Përkthim]

1 PY. Na e shpjegoni.

2 PË. Shtabi i Përgjithshëm dhe struktura e komandës së UÇK-së.
3 Kjo nuk është diskutuar asnjëherë, kjo nuk u ngrit asnjëherë
4 si temë.

5 PY. Po të gjitha temat që ju patë në atë letër, a ishin tema
6 diskutimi më datë 17 qershor?

7 PË. Po, për ato që më pyetët, po.

8 PY. Tani të shohim për intervistën që keni në faqen përpara
9 jush. Intervistuesi e pyet Ramush Haradinaj si më poshtë:

10 "Tani le të flasim lidhur me procedurën për arritjen e
11 një marrëveshjeje për transformimin e UÇK-së."

12 Përgjigje:

13 "Takimi i parë për transformimin e UÇK-së është zhvilluar
14 në Berishë. Mua më kujtohet një takim në të cilin John Riff",
15 sipas tij, "një komandant i lartë i NATO-s erdhi nga Shqipëria
16 në një presion të jashtëzakonshëm, në një trysni të
17 jashtëzakonshme dhe kërkoi që ne të pranonim marrëveshjen për
18 demilitarizimin ..."

19 Dhe Ramush Haradinajt i bëri një tjetër pyetje dhe ai
20 përgjigjet si më poshtë:

21 "Sfida kryesore ishte që diskutimi u përqendrua tek
22 çarmatimi i grupeve të armatosura. Z. Krasniqi, u përgjigj
23 shumë mirë, reagoi shumë mirë. Ai kërkoi që të mos kishte
24 biseda për çarmatimin e grupeve të armatosura shqiptare por në
25 fakt kishte biseda lidhur me UÇK-në ose me Ushtrinë Çlirimtare

1 të Kosovës sepse bëhej fjalë për ushtri. Sigurisht që reagimi
2 i Jakup Krasniqi u mbështet prej të gjithë nesh.”

3 Atëherë ky takim me John Riff, për marrëveshjen e
4 transformimit, a përkon me atë çfarë ju kujtohet juve lidhur
5 me datën 17 qershor, në takimin e 17 qershorit?
6 PË. Është një perceptim nga pala shqiptare, pra, nga pala e
7 shqiptarëve të Kosovës lidhur me atë çfarë po diskutonim ne më
8 datë 17 qershor. Sa i takon afatit 30 ditor, nuk më kujtohet
9 që në versionin paraprak ose në propozimin e parë të
10 marrëveshjes të kem përcaktuar ndonjë afat 30 ditor për
11 çarmatimin e grupeve të armatosura ose çarmatimi i grupeve të
12 armatosura brenda 30 ditëve është shumë i vështirë për t’u
13 arritur.

14 Ndërkohë sa i takon aspektit të grupeve të armatosura
15 shqiptare e kam identifikuar këtë që në fillim të hartimit ose
16 draftimit. Unë fillimisht kam bërë një titull që përfshinte
17 këtë formulimin grupet e armatosura shqiptare dhe më kujtohet
18 që ndërhyrja nga pala tjetër është që duhet që titulli të jetë
19 titull i përshtatshëm, domethënë, që “të jemi preciz në gjuhën
20 ose formulimin e përdorur, për aq kohë sa flitet për UÇK-në
21 duhet që të thuhet shprehimisht Ushtria Çlirimtare e Kosovës,
22 jo grupet e armatosura shqiptare”. Dhe ne i thamë “Okej, në
23 qoftë se ju e quani veten Ushtria Çlirimtare e Kosovë, që
24 ishte fakt, atëherë për ne nuk ka pikë problemi që të përdoret
25 ky formulim”. Pra, gjithsesi në përgjigje të pyetjes tuaj

1 mendoj që ky ishte perceptimi i të intervistuarit lidhur me
2 zhvillimin në fjalë.

3 PY. Këtu në artikull thuhet:

4 "Kush ka qenë i pranishëm në atë takim?

5 Haradinaj përgjigjet:

6 "Të gjithë komandantët e zonave dhe të gjithë drejtorët
7 politikë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Por Hashim
8 Thaçi nuk ishte i pranishëm. Ai nuk ishte në këtë takim. Mesa
9 di unë ka qenë në Shkup, atë ditë ka pasur takime James Rubin
10 në përpjekje për të ecur më përpara me negociatat."

11 Pra, ju këtu sikurse e biseduam më përpara, pra, mund të
12 lexoni që Hashim Thaçi nuk ka qenë më datën 17, po ka qenë me
13 disa përfaqësues të tjerë politik apo s'është kështu,
14 Dëshmitar?

15 PË. Po, është e saktë.

16 PY. Po reagimi i Jakup Krasniqit besoj që e lexuat pjesën,
17 sapo e dëgjuat që unë e lexova pjesën e intervistës. Tani
18 pyetja që kam për juve është: A ju kujtohet që Jakup Krasniqi
19 ka bërë një ndërhyrje të tillë?

20 PË. Po.

21 PY. Ju patë më përpara një video lidhur me këto zhvillime.
22 Videon do jua tregojmë nesër prapë, megjithatë për të filluar
23 më këtë temë, dua të them që juve patë sekuenca të banketit që
24 vijoi pas negociatave. Ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

25 PË. Po.

Dëshmitari: John Duncan (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 160

1 PY. Ju thatë që kjo ishte një pjesë shumë e rëndësishme e
2 negociatave në Ballkan dhe ishin pak a shumë të njëjtët
3 persona. A ju kujtohet juve në qoftë se kanë qenë personat më
4 të rëndësishëm të pranishëm në atë banket të shtruar pas
5 negociatave, Dëshmitar?

6 PË. Mendoj që grupi ka qenë më i vogël, nuk ka qenë i gjithi,
7 po të paktën nga sa pamë nga video kishte shumë veta në grup,
8 por ata që morën pjesë në banket ishin një grup më i vogël.
9 Mendoj që Ramushi ka qenë aty. Remi po ashtu ka qenë i
10 pranishëm. Ka pasur pak a shumë 12 persona në tryezë, mbase
11 pak edhe më tepër 12 deri në 14, por në negociata ka pasur
12 shumë më tepër sesa aq. Sesi janë zgjedhur këta personat që u
13 ulën në banket, pastaj këtë nuk e di.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, vërej kohën.
15 Besoj se është momenti i përshtatshëm për ta mbyllur për sot.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 [Përkthim] Dëshmitar, nuk duhet të flisni me askënd
18 lidhur me dëshminë përpara Trupit Gjykues sot. Do shihemi
19 përsëri nesër në mëngjes në orën 9.00 të mëngjesit.
20 Faleminderit për dëshminë për ditën e sotme.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis,
23 doni të thoni diçka?

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Dua të pyes për nesër që në qoftë se
25 dokumentet në origjinal janë në shqip, do ishte më mirë që të

1 jepet versioni në shqip dhe versioni në anglisht sepse z.

2 Krasniqi as nuk flet dhe as nuk e kupton anglishten.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
4 që na kujtuat. Do bëhet.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Po, patjetër do e bëjmë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do e mbyllim
7 seancën për sot këtu. Do rifillojmë nesër në orën 9.00 të
8 mëngjesit.

9 --- Seanca mbyllet në orën 16.29

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25